



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 MARS 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
26. MARTA 2009.GODINE

MARS– MART
2009

E enjte, 26 mars 2009, ora 10:00

Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar të gjitha kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit së bashku me grupet parlamentare kanë përgatitur dhe Kuvendit i kanë paraqitur rendin e ditës për seancën e sotshme plenare.

Para se t'ia fillojmë me rendin e ditës, kemi të paraqitur katër deputetë dhe po shkojmë sipas radhës. Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Në postën time elektronike mua më ka ardhur një letër nga prindi i Erian Foniqit, Shaban Foniqi, i cili iu drejtohet institucioneve të Kosovës me shqetësim me rastin e humbjes së jetës së fëmijës së tij, më 18 mars të këtij viti, nga qenët endacakë. Është shqetësuese që fëmijët duke shkuar në shkollë pësojnë nga qenët endacakë, prandaj unë do ta lexoj letrën:

“I nderuar Kryetar i Republikës së Kosovës,

I nderuar Kryetar i Parlamentit të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Unë jam Shaban Foniqi, prind i Erion Foniqit, i cili më 18 mars të këtij viti humbi jetën tragjikisht duke shkuar në shkollë nga qenët endacakë. Erioni ishte duke shkuar në shkollë, nuk ishte ndonjë aksident, nuk ishte duke lozur në mal.

Të nderuar qeveritar,

Deri kur ne vendasit e brezit kufitar do të heqim të zinj të ullirit edhe nga xhandarmëria serbe, të cilët bredhin nëpër rrugët tona mu si qenët endacakë, dhe nga qenët endacakë nga të cilët pësojnë fëmijët tanë. Unë, si prind i viktimizuar, po ju shkruaj ndoshta me emocione, por nuk kam çka të bëj. Premtimet e juaja se rrugët tona janë të lira, nuk kanë dalë si të vërteta. Dua t'ju njoftoj se me datën 29 janar, kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Karaçevë, zoti Selver Linjani, ka paralajmëruar organet komunale të Dardanës që të ndalojnë qenët endacakë, ose t'i vrasin, ose t'i fusin në një karantinë diku, por kjo nuk ndodhi. Më 18 mars ndodhi tragjedia në familjen time. Fëmija im u shqye nga qenët endacakë. Prandaj, a thua kush ...”

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia zgjatni edhe një minutë!

GANI GECI: “Unë falënderoj bashkëvendësit e mi të cilët erdhën në ngushëllime, por nuk ua fali institucioneve tona të cilët nuk ishin në gjendje që të më shkruajnë asnjë

telegram ngushëllimi. Pikërisht Presidenti Sejdiu dhe Kryetari Krasniqi. Ju faleminderit për mirëkuptim. Më falni për shqetësimet!” Mbaron letra.

Të nderuar deputetë, edhe në vitin 2003 ka ndodhur një rast i njëjtë në Drenicë. Në Turiçevc, qenët endacakë kanë shqyer fëmijën Valmir Bedri Beqiri, dhe ne duhet të bëjmë diçka në këtë drejtim, sepse në shtetin e Gjermanisë, kur ka ndodhur ndonjë rast i tillë, i gjithë Bundestagu është ngritur në këmbë dhe e kanë ndryshuar ligjin të gjithë ata, sepse në Gjermani nuk ka qenë endacakë dhe të gjithë ata që lëshojnë qenët pa prezencën e mbikëqyrësve, duhet të dënohen me 5 vjet, nëse nuk kanë mbërthesat në hundë. Prandaj, ne duhet të bëjmë diçka në këtë drejtim sepse edhe rreth Parlamentit të Kosovës po shoh qenë endacakë dhe nëse neve na hanë, do të ishte më mirë sesa fëmijët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Sigurisht që edhe mua dhe deputetëve tjerë iu vjen keq për një ngjarje të tillë të dhembshme. Unë, si Kryetar i Parlamentit, atyre ditëve kam qenë në vizitë në Britani të Madhe dhe nuk kam dëgjuar, realisht, dhe më vjen keq, por unë shfrytëzoj rastin që familjes në emrin tim, por edhe në emrin e Kuvendit, t’i shpreh ngushëllime dhe institucionet përkatëse vërtet le të merren me detyrat dhe obligimet që i kanë me ligj.

Radha është e deputetit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të gjithëve,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Do të doja vetëm shkurt t’ju pyes. Konform përfundimit të Kryesisë, të datës 18 shkurt, të Kryesisë së Parlamentit, Komisioni ka mbajtur një mbledhje dhe ka shqyrtuar peticionin kundër ngritjes së tarifës së energjisë elektrike dhe ka dalë me rekomandime. Kur do të jetë në rend dite kjo çështje dhe kur do të ketë mundësi Komisioni, jo vetëm që unë e drejtoj, por edhe Komisioni tjetër t’i thotë rekomandimet rreth kësaj çështjeje, sepse kur kryhet kjo punë edhe do të ngrihet eventalisht energjia, çmimi i energjisë elektrike, atëherë edhe s’do të ketë ndoshta nevojë edhe të bisedohet, prandaj ne kemi vepruar konform procedurave dhe përfundimit të Kryesisë. Kur do të jetë në rend dite çështja që është shqetësim i 10.529 nënshkruesve të peticionit dhe i shumë qytetarëve që nuk kanë pasur mundësi të nënshkruhen ose janë kundër ngritjes së tarifës së energjisë elektrike? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e deputetit, që e ka kërkuar fjalën, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

(Ndërprerje e incizimit)

.... kanë mbetur pa numër të caktuar të gjyqtarëve, qoftë për shkak të vdekjes, qoftë për shkak të shumë gjyqtarëve dhe prokurorëve që ballafaqohen me cilësinë, kanë mbetur shumë masa disiplinore të pa shqiptuara dhe shumë prokurorë dhe gjyqtarë të cilët edhe janë para organeve të drejtësisë, ende marrin pagë në buxhetin e Kosovës, ka gjyqtarë të cilët e kanë lëshuar Kosovën dhe gjenden jashtë vendit dhe ende marrin pagë në buxhetin e Kosovës dhe, mbi të gjitha, natyrisht që mungojnë edhe kushtet e përgjithshme për

funkcionim. Kam bërë përpjekje disa herë edhe me anëtarë të tjerë të Këshillit Gjyqësor për ta funksionalizuar, mirëpo nuk e dimë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka kërkuar deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar! Përshëndetje për Kabinetin qeveritar, për të gjithë deputetët që janë sot në seancë!

Zoti Kryetar,

AKR-ja është shqetësuar lidhur me asetet e ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës, siç janë: “Jateks” i Gjakovës, “Trepçës”, KEK-ut, “Eximkos”-it, “Ramiz Sadikut”, “Agrokosovës” dhe të “Ballkanit”. Shteti serb po i kthen në pronën e vet si pronë private dhe po i privatizon dhe me këtë po përfiton shteti serb. Krijimi i sistemit të reciprocitetit ekonomik, çështja e ndërmarrjeve që ka mbetur në ish-njësitë e Jugosllavisë, me këto duhet urgjentisht të merret qeveria e Kosovës.

Me Ligjin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë u është dhënë e drejtë atyre ndërmarrjeve të ish-Jugosllavisë që ato të kërkojnë të drejtat e tyre si kreditorë në pronat shoqërore të Kosovës dhe kjo paraqet një problem serioz. Asetet që janë në Serbi, juridikisht janë pronë e Kosovës, por duhet të kthehen në rrugë gjyqësore në nivel ndërkombëtar. Ky shqetësim imi është me interes që Qeveria e Kosovës të përgatitë të gjitha dosjet e pronave të Kosovës që ekzistojnë nëpër ish-njësitë e federatës me qëllim që kjo pasuri e qytetarëve të Kosovës t’i kthehet Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče! Pozdrav Kabinetu vlade i svim poslanicima!

Komisija za rad, zdravlstvo i socijalno staranje je imala zahtev od strane kabineta ministra Zdravlja da se 7 tačka odloži i to smo raspravljali na komisiji, koja je održana u utorak...

(Nderhyrje)

...To je Zakon o privatnoj delatnosti, izveštaj koji je pripremila Komisija. Medjutim, ministar je tu, bilo je najava da će oputovati za Albaniju i da neće biti prisutan, pa je komisija donela odluku da se ova tačka odloži za narednu sednicu. U medjuvremenu, ministar je ovde, ali članovi komisije smatraju da se nisu pripremali za ovu tačku zato što su mislili da će biti odložena i traže da se odloži za narednu sednicu. To je 7 tačka. I izvestilac ove komisije takodje nije ovde danas, i ministar se slaže, evo vidimo klima glavom. Predlažemo da se ova tačka odloži za narednu sednicu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Dhe, deputeti i fundit, fjalën e ka kërkuar deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Želim da postavim jedno pitanje koje bi se, smatram, trebalo naći na dnevnom redu a tiče se velikog interesovanja građana i uznemirenosti, moglo bi se reći, u opštinama u kojima žive Bošnjaci, Turci, Egipćani i tako dalje, Istok, Peć i tako dalje – vezano za

nesprovedjenje Zakona o lokalnoj samoupravi, Zakona o unapredjenju prava i interesa zajednica, zatim o kršenju pojedinih članova tih zakona, izbegavanja zakona i mnogih pitanja sa kojima smo se suočavali ovih dana. Već nekoliko mjeseci se suočavamo sa pitanjem upotrebe pečata u Prizrenu koji je donet bez odobrenja ili saglasnosti Turske i Bošnjačke zajednice, potom Zakona o ličnim kartama i ne izrdjivanju ličnih karta onako kako treba u skladu sa zakonom da se uradi, na osnovu čega mogu da kažem da smo potpuno spremni da se dogovorimo u svim ovim sredinama. Zatim u Peći, odnosno u Vitimirici, gde se donose odluke o mjesnoj zajednici bez poštovanja zakona, bez razgovora sa predstavnicima većinske zajednice u Vitimirici a sa ovim se tijesno veže i pitanje, zahtev Vitimirice za opštinu. Mislim da pitanje decentralizacije koje se dugo vreme postavlja od EULEX-a i verovatno i institucija je potpuno zapostavilo pitanje zahteva za opštinu Vitimirice, Rečane i Dragaš i mislim da je vreme da institucije Kosova, Vlada Kosova, Ministarstvo za lokalnu upravu konačno daju odgovora na to pitanje a da taj odgovor bude u suglasju sa zahtevima lokalnih zajednica a ne u suprotnosti sa njima. Dakle, ovo su naša pitanja koja smatram da bi se trebalo donijeti na dnevnom redu i da ta pitanja ne bi trebalo biti ignorisana već možda tri ili četiri godine od strane svih prethodnih vlada koje su bile..., odnosno Ministarstvo za lokalnu upravu moralo je razmotriti ovo pitanje. Mi ćemo kao predstavnici naroda zajedno sa ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Dozvolite da vas pozdravim, predsjedniče, Premijera, zamenike, ministre i kolege!

Kada je u pitanju odluka o logou u opštini Prizren i kada je u pitanju ovaj problem, ja mogu da obavestim ovde Skupštinu ali i javnost da smo na tu temu kolega Mahir Jagcilar i ja razgovarali sa premijerom i zamenikom premijera, tako da smo na putu da dodje do rešenja ovog problema. Takođe, učesnici smo u radu sa ministrom za Lokalnu samoupravu tako da ne stoji to da se niko ne interesuje. Postoji situacija kada se oko nekih stvari kasni, ima opravdanja da neki zakoni vezani za lokalnu samoupravu još uvek nisu usvojeni, ali ja bih predložio da to ne politizujemo nego da zajedno sa svim zainteresovanim kolegama još jednom sednemo sa gospodinom ministrom za Lokalnu samoupravu. A kada je u pitanju logo u Prizrenu, ja bih rekao da jedino odbornik kolege Numana Balića je protiv tog, bio je za onaj logo koji je postojeći, tako da je u kontradiktornosti sa onim što navodi upravo gospodin Balić. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, Numan Baliq! Replikë, një minutë!

NUMAN BALIĆ: Ja, naravno, nisam ni najmanju želju imao da pokrećem bilo kakvu polemiku, tako da je ispod svakog nivoa, niti sam imao namjeru da polemiziram sa bilo kim. Pozao sam na dobronamjernu saradnju institucija Kosova, opština o kojima sam govorio, pitanje koje sam spomenuo, ne samo Prizren, nego i Istok, Peć, Vitimiricu i tako dalje. Dakle, stavljati se u nekoj poziciji da sad neko brani vladu od mene, zaista je neukusno, poltronski, bezprimjerno i da to ne treba ni vladi Kosova, ni narodu Kosova, ni bilo kome. Moj poziv je veoma jasan. Zakon o pravima i interesima zajednica u mnogim slučajevima se ne sprovodi kako treba. Ja pozivam sa najboljim namerama rukovodiocce opština u Peći, u Istoku, u Prizrenu i gde god treba da sa Vladom Kosova razgovaramo

oko toga. Naravno da ne želim da se osvrćem na ove niske, koje su nedostojne ove upadice... Hvala ljepa!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti, i fundit, Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

Söz konusu, diğerleri arasında az önce söz edilenler arasında kimlik belgeleri Yasa Tasarısına da değinildi. Kamu oyuna bir açıklama yapmak zorunluluğu hissetmişimdir. Vatandaşımızın konuyla ilgili aydınlatılması şarttır. 7+ Parlamenter Grubu temsilcileri, başka liderlerimiz, başkanımız, bakanımız Mahir bey olmak üzere, konuyu yakinen takip etmektedirler ve pozitif olan da söz konusu konuyla ilgili var olan komisyonlara ve Hükümetin de desteği sonsuzdur. Ortada bir yasa vardır ve yasanın yürürlüğe girmesi dolu bir şekilde an meselesidir, bu konunun bir daha gündeme bu şekilde getirilmesinin uygun olmadığını düşünmekteyim çünkü 7+ Parlamenter Grubu yasal yollarla var olan Parlamenter Komisyonlarına ve Hükümet düzeyinde ister bakanımızla ister diğer temsilcilerimizle zaten bu konu gündeme gelmiştir ve bu konu en kısa bir zamanda çözüme ulaşacaktır.

Teşellür ederim

KRYETARI: Faleminderit! Unë do të jap një përgjigje të shkurtër për të gjitha kërkesat që i keni bërë.

1. Kërkesa e deputetit Ismet Beqiri, çështja është në procedurë, po ju e dini që Kuvendi e ka miratuar një Ligj për Rregullatorin e energjisë elektrike.
2. Për të gjitha kërkesat tjera, të Bahri Hysenit, të Muzejene Selmanit, të Sadik Idrizit dhe të Numan Baliqit do të konsultohemi me ministrin dhe mund t'i qesim në votim, por ju e dini se cilat janë procedurat për të hyrë çështjet në rend të ditës dhe për të debatuar.

Prandaj, kisha kërkuar që vërtet të mos marrim pjesën e seancës, por t'i ndjekim procedurat përkatëse dhe nëse ato duhet të hyjnë në rend dite, le të bëhen përgatitjet paraprake.

Për pikën e 8-të të rendit të ditës, është kërkesa e Komisionit për ta hequr nga rendi i ditës çështjen:

- Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 2004/50 për veprimtarinë private të shëndetësisë.

Kjo, do të thotë, është për ta shtyrë këtë pikë për seancën e radhës. A pajtohet ministri? Faleminderit, ministër! Atëherë, do të votojmë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash. Konstatoj se me 60 vota “për”, 2 “kundër” dhe 5 abstenime, pika e 8-të e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës. Faleminderit!

Para se të kalojmë në rend të ditës, kemi një njoftim.

Në fakt, përshëndesim deputetin e ri nga PDAK-ja, Danush Ademi. Mirë se erdhët!

Pika e parë e rendit të ditës:

- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 12 mars 2009

Procesverbalin e keni marrë. Pyes deputetët, nëse kanë vërejtje në Procesverbalin e seancës të mbajtur më 12 mars 2009.

Konstatohet se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 12 mars 2009.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Pyetjet parlamentare

Ju njoftoj se mungojnë me arsye, këta ministra:

1. Ahmet Shala,
2. Lutfi Zharku,
3. Valton Beqiri dhe
4. Enver Hoxhaj.

Prandaj, pyetjet e tyre nuk po i lexojmë.

Ministri Limaj ka kërkuar që për shkak të agjendës, t'i bëjmë së pari pyetjet që i drejtohen atij. Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionin, zotin Fatmir Limaj. Deputete, e keni fjalën. Nuk është deputetja!

Vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionin, zotin Fatmir Limaj. Deputet, e keni fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Zotëri ministër Limaj,

Në vendin tonë, operatorët ilegalë aktualisht uzurpojnë përqindje të konsiderueshme të tregut të telefonisë dhe të funksionimit ilegal të tyre. Ndër të tjera, në atë mënyrë iu shkaktojnë humbje operatorëve vendorë, po e zëmë, Vala-s dhe IPKO-s rreth 17 milionë në vit. Gjithsesi, në radhë të parë përgjigja si dhe përgjegjësia në këtë çështje do të duhej të ishte dhe të jepej nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, por në këtë rast, nga ju mirëpresim një koment zyrtar dhe të Ministrisë të cilën e administroni, e cila do të kishte prerogativa apo do të duhej të kishte prerogativa ligjore dhe autorizime respektive për të ndërmarrë masa indirekte apo direkte në favor të evitimit të këtij precedenti të palejuar dhe të dëmshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Smaka, siç thatë ju, kjo është çështje e agjencioneve të pavarura të Republikës së vendit tonë, të cilat duhet të merren me mbikëqyrjen dhe vendosjen e ligjshmërisë në tregun e telekomunikacionit në Kosovë. Është e vërtetë që në Kosovë

ende vazhdojnë operime apo operatorë ilegalë anekënd Kosovës. Ne kemi kërkuar nga agjencitë përkatëse që tani e tutje të fillohet me eliminimin dhe largimin e të gjithë operatorëve ilegalë të cilët veprojnë në tregun e Kosovës dhe që janë në kundërshtim me Ligjin për telekomunikacion.

Besoj se kohëve të fundit kemi parë disa lëvizje të tilla dhe ne shpresojmë që kjo do të intensifikohet. Ndoshta një nga problemet për të cilat ne ende nuk kemi një aksion të fuqishëm, është fakti se ART-së i ka kaluar mandati dhe ne presim shumë shpejt t'i përzgjedhim anëtarët e këtij bordi dhe pastaj ky bord do t'i marrë orientimet e qarta që përfundimisht kjo çështje të hiqet nga rendi i ditës dhe në Kosovë nuk guxon të veprojë asnjë operator ilegal i cili është në kundërshtim me Ligjin për telekomunikacion të Republikës së vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë?

Ju, deputet, e keni bërë edhe një pyetje tjetër. Regjia, fjalën ia jepni deputetit Smaka.

RIZA SMAKA: Zotëri ministër Limaj,

Nga të dhënat disponuese, ndër të tjera edhe nga ato të mediave, këtu e kam edhe fusnotën – të dhëna të verifikuara, Kosova nga viti 1999-2009 për shkak të insuficiencës së kodit telefonik ka humbur 300 milionë euro, një shumë të nevojshme për investime, po e zëmë të një termo apo hidroelektrane prej 250 megavatësh. Tagrën e tillë vendi ynë i vogël dhe i varfër ia ka paguar dhe vazhdon t'ia paguajë Serbisë dhe Monakos dhe atë për derisa nuk do të fitojë kodin telefonik të saj.

Zotëri ministër,

Me konsideratë ju pyes, referuar këtij objektiv programor qeveritar, kur përafërsisht mund të pritni fitimin e kodit telefonik të vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Aktualisht, siç është e njohur, për të gjithë, vendit tonë si shfrytëzues i kodit shtetëror për telefoni, i janë shkaktuar probleme edhe në shumë aspekte, që nga zvogëlimi i aktivitetit për investime në sektorin e telekomunikacionit dhe deri në humbjet financiare, siç e përmendët edhe ju dhe vështirësi të mëdha për të menaxhuar sistemin e enumeracionit nga ana e Rregullatorit dhe operatorëve që ofrojnë shërbimet telekomunikuese në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës mendon se çështja e kodit telefonik është çështje e zhvillimit ekonomik. Pa një kod të tillë ka për të pasur probleme në zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Po ashtu, ne vlerësojmë se mungesa e këtij kodi ka shkaktuar edhe këtë kaos të joligjshmërisë, siç u tha nga pyetja e kaluar, të operatorëve ilegalë në vendin tonë.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës, në këtë rast Ministria e Transportit, ka hulumtuar të gjitha format e bashkëpunimit me Unionin ndërkombëtar të telekomunikacionit. Ky është një proces konsultues që kërkon kohë. Kërkesa jonë, e mbështetur në kërkimin e çfarëdo lloji të kodit shtetëror, lloj ky që parashihet në kuadër të dokumentacionit të ITU-s lidhur me çështjet e kodit shtetëror të telefonisë.

Një gjë duhet ta them që ne sot jemi shumë – shumë më optimistë se që kemi qenë para dy muaj a tre muaj, në bazë të sinjaleve që ne i kemi nga kjo organizatë ndërkombëtare.

Shpresoj, ne nuk mund të kufizohemi me datë as me muaj, por besojmë se shumë shpejt vendi ynë do ta ketë kodin e vet.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputet, ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Pyetja e radhës është nga Driton Tali, i cili nuk është këtu.

Pastaj deputetja Edita Tahiri i ka dy pyetje, nuk është këtu.

Dhe, pyetja e fundit për ministrin Limaj, është nga deputeti Gani Geci. Regjia, ia mundësoni fjalën deputetit Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë kam një shqetësim nga bashkatdhetarët tanë të cilët jetojnë dhe punojnë në shtetet perëndimore. Ata kur vijnë në pushim duhet të paguajnë taksa shtesë për automjetet e tyre edhe pse i kanë kartonat e gjelbër dhe kartonat e tyre vlejnë në gjithë Evropën. Desha ta pyes ministrin, deri kur, zoti ministër, bashkatdhetarët tanë që kanë shtetësinë e Kosovës do ta paguajnë këtë taksë shtesë, taksë e cila për një vit është 530 euro, për 15 ditë është 50 euro dhe për 1 muaj është 70 euro dhe kështu me radhë. Pyetja është konkrete: deri kur do të ndodhë kjo? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar, zoti deputet,

Çështje apo pyetjen të cilën e keni ngritur ju, nuk hyn në kuadër të përgjegjësisë të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit. Megjithatë, jemi shumë të interesuar dhe të përkushtuar që bashkatdhetarët tanë të mos dëmtohen duke paguar taksa shtesë në emër të sigurimit të automjeteve të tyre. Duhet të ju them se, me sa ne kemi marrë informacione, është Shoqata e kompanive të sigurimit dhe Banka Qendrore e vendit tonë që kanë bërë kërkesë për anëtarësimin në Byronë e Kartonit të Gjelbër në Bruksel dhe janë në pritje të përgjigjes. Është fjala për kartonin e gjelbër që iu takon këtyre dy agjencioneve që vendi ynë të jetë pjesë e tyre dhe pastaj edhe qytetarët e vendit tonë që dalin jashtë dhe të tjerët që futen në Kosovë më nuk do të kenë nevojë të paguajnë taksat, të cilat, siç e thatë ju, janë gati thuaja edhe të panevojshme. Mirëpo, kjo çështje u takon, siç thashë, Bankës Qendrore, Ministrisë së Financave dhe kompanive të sigurimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër! Deputet, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetit Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit! Bashkatdhetarët tanë kanë vërejtur edhe një parregullsi tjetër se qytetarët e Republikës së Serbisë që hyjnë në Republikën e Kosovës nuk paguajnë këtë taksë shtesë. Prandaj, ata kanë këtu një vërejtje apo çështje shqetësuese, sepse nuk bën të luajmë me dy kute – për disa qytetarë ndryshe, për disa ndryshe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, a ke koment? Nuk ke! Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministren e Energjetikës dhe të Minierave, zonjën Justina Shiroka-Pula. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në rrethanat në të cilat jetojmë, me 45% të popullatës në varfëri relative dhe 15% në varfëri të skajshme, me shtrenjtimin e rrymës, pikërisht shtresat e varfra do të rrezikohen edhe më shumë. Mbi të gjitha, me këtë shtrenjtim do të ngarkohen të gjithë paguesit e rregullt të energjisë elektrike, ndërsa ata të cilët nuk e paguajnë rrymën, do të vazhdojnë edhe më tutje ta keqpërdorin atë. Shtrenjtimi i rrymës, këto ditë është përkrahur nga Qeveria me arsyetimin për të mbuluar koston e prodhimit.

Zonja ministre, cili faktor ka ndikuar në rritjen e koston së prodhimit të energjisë elektrike kur dihet se faktori kryesor i prodhimit, - thëngjilli, gjendet në Kosovë, i cili nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimi.

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA-PULA: Faleminderit, e nderuara deputete!

Së pari, unë s'e kam marrë këtë pyetje. Unë nuk e di, fakti që nuk jam deputete, e kam një vërejtje kryetar, të lutem. E kam një vërejtje që ne që s'jemi deputet i marrim pyetjet me vonesë ose fare nuk i marrim, sikurse që ndodh edhe me rendin e ditës. Prandaj, besoj se në të ardhmen do të rregulloni këtë çështje.

KRYETARI: Administrata i ka procesuar pyetjet për të gjithë ministrat, pa marrë parasysh a janë deputetë apo s'janë deputetë.

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA-PULA: E nderuara deputete, sa i përket ngritjes së tarifave për energji elektrike, KEK-u, KOSTT-i i drejtohen Zyrës së Rregullatorit. Ata kanë një mekanizëm dhe metodologji të përcaktimit të ngritjes së tarifave. Në kohën e fundit na ka ardhur një version nga Zyra e Rregullatorit, në të cilin ka përcaktuar se sa do të jetë rritja e tarifave. Ndërkohë, janë bërë disa sugjerime dhe vërejtje nga Ministria e Energjisë dhe Minierave në diskutim edhe me ministratë tjera, janë bërë vërejtje gjithashtu plotësuese edhe nga KEK-u e KOSTT-i. Si rezultat përfundimtar se sa do të rritet tarifa e energjisë elektrike, nuk kemi, prandaj nuk mund të ju njoftojmë se sa do të rritet kjo tarifë. Besoj se në ndonjë mbledhje tjetër mund të diskutojmë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Deputete, a keni pyetje shtesë? E keni fjalën.

MYRVETE PANTINA: Zonja ministre, meqë janë ndërmarrë disa masa për të rritur inkasimin e rrymës, a nuk do të ishte më mirë që të punohet edhe më shumë në gjetjen e mënyrave për të rritur inkasimin e rrymës dhe për të ndaluar keqpërdorimin e saj qoftë nga qytetarët, qoftë nga bizneset. Përndryshe, përgjigjen nuk e mora se cili faktor ka shkaktuar ngritjen e çmimit të rrymës.

KRYETARI: Ajo është çështje e Rregullatorit për energji, që është organ që i përgjigjet Parlamentit, andaj i drejtoheni organit përkatës për çmimin e energjisë.

Deputet Tali, edhe pse jeni vonuar, ministri ju priti. Mund ta merrni fjalën për të bërë pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar! I kam dy pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, andaj po i bëj me radhë. Kohë më parë u publikua, zoti

ministër, raporti se objekti me qira i PTK-së, i cili paguhet rreth 25.000 euro në Qafë të Prishtinës, rrezikon shëndetin dhe jetën e qindra punëtorëve të saj. Në dhomat e vogla të saj futen shumë punëtorë, deri në 9 në një zyre, ku nuk ekzistojnë as kushtet minimale për punë, pa ajrosje dhe ndriçim. Madje, ndërtesa, sipas disa burimeve, është ende pa leje të ndërtimit.

Pyetja: Çfarë ka ndërmarrë Ministria që të mos ndodhë ndonjë tragjedi e mundshme dhe të rishikohet kontrata e qirasë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit! I nderuar deputet, meqë besoj se është momenti edhe njëherë ta qartësojmë për satën herë, Ligji për ndërmarrje publike është miratuar nga ky Parlament i Kosovës. Ju ftoj ta shikoni Ligjin për ndërmarrje publike dhe tregon qartë kush menaxhon me ndërmarrjet publike, në këtë rast edhe me postën.

Ministria e Transportit nuk ka asgjë të bëjë me mbikëqyrjen dhe menaxhimin e ndërmarrjeve publike, siç është Posta dhe Aeroporti i Prishtinës. Ne merremi me zhvillimin e politikave dhe ky është obligimi ynë. Të tjerat, për menaxhimin e ndërmarrjeve publike, në këtë rast të Postës dhe të menaxhmentit të saj, mbikëqyrjen e saj, është njësia mbështetëse brenda përbrenda Ministrisë së Financave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër! Deputet, keni pyetje shtesë?

DRITON TALI: Një koment të vogël. Mua më vjen mirë që për të satën herë e konfirmoj zoti ministër se për ndërmarrjet publike përgjegjës është ministri i Ekonomisë dhe Financave, ngase gjithërë pyetjet atij ia bëj, por për të mos dalë që të jetë personale mes meje dhe tij, andaj ia bëra pyetjen ministrit të Transportit. Sidoqoftë, kjo pyetje do t'i përsëritet ministrit të Ekonomisë dhe të Financave.

Pyetja tjetër, nëse më lejohet?

KRYETARI: Vetëm vazhdoni!

DRITON TALI: Krijimi i Bankës, Post-bankës ka qenë iniciativë e hershme e menaxhmentit të PTK-së si iniciativë të cilën edhe ky menaxhment aktual e ka mbështetur, si dhe disa udhëheqës të Qeverisë këtu, si bie fjala udhëheqësit e Ministrisë së Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit. Por, disa deklarata në kohën e fundit disi e mjegullojnë këtë çështje. Zëdhënësi i Qeverisë javën e kaluar deklaroi se Qeveria nuk ka asnjë qëndrim ndaj kësaj iniciative, ndërsa menaxhmenti i PTK-së ka formuar grupin për përgatitjen e punëve fillestare, domethënë është në fazën fillestare të krijimit të kësaj Post-banke.

Zoti ministër, a mund të na tregoni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën. Ndoshta po e di pyetjen për çka është fjala?

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ndërmarrje publike, ne besojmë se janë krijuar kushte, janë hapur rrugë që të gjitha ndërmarrjet publike të zhvillohen sipas praktikave më të mira të qeverisjes dhe sipas modeleve bashkëkohore me qëllim të ofrimit të shërbimit sa më të mirë në interes të qytetarëve të Republikës sonë.

Me këtë ligj, siç dihet, caktohet pronari i këtyre ndërmarrjeve publike. Politikat dhe strategjitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë që Posta e Kosovës, sikurse edhe ndërmarrjet e tjera publike qendrore të rrisin vlerat e tyre dhe të arrijnë standarde më të larta të obligimit të shërbimit për qytetarët e vendit dhe të menaxhimit sipas modeleve të standardeve evropiane. Duhet të ju them që kjo iniciativë ka qenë ide e kamotshme që Posta e Kosovës ta ketë bankën e saj dhe këtë ide ne e kemi zhvilluar më tutje me iniciativat tona dhe ka filluar të punohet në këtë drejtim, konkretisht. Siç e thatë edhe ju, ne kemi kërkuar nga Bordi i Postës së Kosovës që ta bëjë sa më shpejt grupin e ekspertëve për të bërë analiza rreth krijimit ose formimit të Post-Bankës.

Normalisht që ne mendojmë se është në interesin e vendit tonë, është në interesin e qytetarëve të këtij vendi, është në interesin e kësaj korporate që ta ketë bankën e saj, bankë e cila praktikisht do të futet në shërbim të qytetarëve dhe do të rritë asetet e postës së Kosovës.

Unë besoj që ekspertët janë duke analizuar modele të ndryshme. Kemi parë shembuj të praktikës nga shtetet në perëndim dhe në rajon, të cilat janë treguar të suksesshme me këto projekte dhe besoj që shumë shpejt edhe grupi i ekspertëve të Postës së Kosovës, i cili është në bashkëpunim të ngushtë duke punuar edhe me ekspertë ndërkombëtarë, do të na ofrojë njëfarë paketë-projekti se si ata e shohin krijimin e kësaj banke dhe pastaj jam i bindur se Qeveria e Kosovës do të marrë hapa të duhur përmes Bordit të PTK-së.

Duhet të them gjithashtu se ka interesa, ka mekanizma të tjerë të cilët nuk janë të interesuar për të pasur një post-bankë të tillë, por unë ju siguroj se kjo për derisa do të jetë në interesin e qytetarëve të Kosovës, ne do të insistojmë që Kosova ta ketë post-bankën e saj dhe normalisht ne do të bëjmë atë çka është e mundur nga... dhe nga mundësitë tona.

KRYETARI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, deputet? Urdhëroni!

DRITON TALI: Kur mund të presim konkretisht diçka të realizohet, zoti ministër, nga fakti se ne nuk jemi kah e zbulojmë Amerikën, post-bankat ekzistojnë gjithkund në botë dhe paratë ekzistojnë, janë mbi 231 milionë nëpër bankat komerciale që janë para të qytetarëve të Kosovës, domethënë të pronarëve të PTK-së, siç e dini, Qeveria është agjent i qytetarëve të Kosovës, andaj ajo duhet që të jetë sa më efikas apo më efektive në këtë projekt.

A mund të na tregoni se kur mund të presim diçka më konkrete? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Unë duhet të them se Ministria e Transportit e ka kryer punën e saj, thashë, në lidhje me zhvillimin e politikave dhe një nga pjesët e politikave tona ka qenë ideja e krijimit të kësaj post-banke, tani gjërat më nuk varen nga ne, varen

nga mekanizmat tjerë shtetëror. Së pari, menaxhmenti duhet të përgatit sa më shpejt këtë projekt dhe pastaj janë edhe institucionet financiare të cilat kanë një rol të veçantë të jashtëzakonshëm këtu, siç është Banka Qendrore e Kosovës. Kanë filluar takimet në mes menaxhmentit të PTK-së dhe Bankës, shpresoj se të gjithë punojnë dhe shohin se është interes imediat, i veçantë për qytetarët e Kosovës që ta kenë këtë post-bankë. Duhet të them se në këtë projekt nuk është një aktor, por janë shumë aktorë dhe shpresoj se të gjithë do ta kuptojnë se sa është e rëndësishme që Kosova ta Post-Bankën e saj.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetja e radhës. Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

RIZA SMAKA: Në këto ditë është aktualizuar statusi politik kushtetutar i malazezve kosovarë me kërkesë për sigurimin e tyre në dispozitat kushtetutare respektive.

Zoti Kryeministër, si e observoni dhe si e valorizoni ju këtë kërkesë dhe nëse edhe ju e vlerësoni, në parim, se është e bazuar, çfarë do të ndërmerrni në funksion të zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Kryetar i Parlamentit të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti Smaka,

Kosova është vend demokratik, vend ku të gjithë qytetarët e saj, shtetasit e saj do t'i gëzojnë dhe po i gëzojnë të drejtat e tyre të barabarta duke respektuar me përpikëri dokumentin e Presidentit Ahtisari edhe për respektimin afirmativ të minoritarëve dhe, në kuadër të kësaj, edhe çështjen që ju e ngisni. Është një çështje e cila ka pasur vlerësimin shtetëror. Tash edhe pranë zyrës sime, menjëherë pas formimit të Qeverisë së re, ka filluar së funksionuari Zyra për komunitete, gjithashtu kemi ndërmarrë edhe veprime konkrete për të mirën e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Në anën tjetër, edhe Presidenti ka në autoritetin e vet Këshillin konsultativ të komuniteteve, ku janë të integruara të gjitha minoritetet, por ne do të respektojmë në përpikëri Kushtetutën e Republikës së Kosovës që garanton të drejtat e të gjitha komuniteteve, në këtë rast edhe Kushtetuta i përgjigjet pyetjes suaj.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Deputeti Naim Maloku, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. Më falni, paska pyetje shtesë. Urdhëroni!

RIZA SMAKA: Zotëri Kryeministër!

Unë personalisht jam i bindur se malazeztë kosovarë duhet ta kenë pozicionin kushtetutar. Kjo është bindje ime individuale dhe në atë drejtim pyetja ime ishte e apostrofuat se a vlerësoni ju se do të duhej për t'u bërë një modifikim kushtetutar në mënyrë që malazeztë kosovarë të kishin një pozitë kushtetutare, siç e kanë, po e zëmë, edhe grupet etnike tjera, etnicitetet e tjera. Kjo ishte pyetja. Kurse unë do të isha angazhuar që ta kenë statusin kushtetutar. Mali i Zi është një shtet fqinj. Mali i Zi e ka pranuar Kosovën. Ne duhet të kemi reciprocitete korrekte me Malin e Zi, nevoja të ndërsjella dhe do të ishte zgjidhje parimore kjo që do të ishim angazhuar në këtë drejtim. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari, zoti deputet,
Të drejtat e të gjitha komuniteteve, gjithashtu edhe të drejtat e komunitetit malazez do të respektohen në mënyrën më afirmative të mundshme. Unë jam në kontakt të vazhdueshëm me Kryeministrin e Malit të Zi dhe Qeveria e Kosovës është në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha autoritetet përkatëse malazeze. Ne kemi falënderuar dhe e falënderojmë shtetin e Malit të Zi që e ka njohur Kosovën shtet dhe relacionet tona janë relacione të shkëlqyeshme bashkëpunimi. Pra, do të ketë respektim afirmativ, por nuk mund ta ndryshojmë Kushtetutën në kuptimin e kërkesave të njëanshme, por ne do të punojmë konkretisht në zgjidhjen e halleve, të problemeve dhe të shqetësimeve të të gjitha komuniteteve, kësaj radhe edhe të malazezve. Kështu, do të punojmë bashkërisht për të gjetur zgjidhjen më adekuate edhe juridike, por ky proces nuk duhet të politizohet, është mirë që s'ka ndikuar fare në relacionet tona që janë gjithnjë e më tepër më të avancuara ndërshtetërore.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naim Maloku, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër,

Që nga fillimi i prodhimit në objektet e “Ferronikelit”, pra pas luftës, banorët i janë nënshtruar ndotjes. Posaçërisht banorët e dy komunave – Drenas dhe Skenderaj po i nënshtrohen ndotjes së ambientit të përmasave më të mëdha se sa në periudhën e para luftës, kur gjithashtu punonte “Ferronikeli”.

Sipas të gjitha gjasave, zoti ministër, gjatë privatizimit të “Ferronikelit”, “Alferoni” nuk ka qenë i kushtëzuar në marrjen e masave kundër ndotjes së ambientit.

Pyes ministrin: A e bën Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor mbikëqyrjen e ndotjes së ambientit nga objekti në fjalë dhe sa i kalon parametrat e lejuara me ligj, pra ndotja?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuari kryesues,

I nderuari zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Naim Maloku,

Duke falënderuar për pyetjen, unë dëshiroj të informoj se në vitin 2007 pronari i ri i “Ferronikelit”, “Alferoni”, pas riparimit dhe kompletimit tekniko-teknologjik të procesit prodhues, ka rifilluar prodhimin e kapacitetit jo të plotë të prodhimit gjatë vitit 2008, kur arriti kapacitetin e plotë të prodhimit si dhe gjatë vitit 2009, kur kapaciteti i prodhimit ka rënë nën 50%.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Inspektorati i Ministrisë në vazhdimësi ka bërë monitorimin e “Ferronikelit”, duke bërë presion në formë të urdhërësive, të vërejtjeve dhe të konkluzioneve që të ndikohet në zvogëlimin e shkallës së ndotjeve konform standardeve të lejuara.

Sipas ligjeve në fuqi të mjedisit, “Ferronikeli” është pajisur me pëlqimin mjedisor nga Ministria, ku janë parashtruar kushtet që duhet t’i plotësojë “Ferronikeli” për të marrë leje mjedisore nga Ministria. Që atëherë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka formuar një grup punues kompetent prej 7 anëtarëve të veprojë në formë të partneritetit me “Ferronikelin”, duke i mbajtur disa takime pune, në të cilat nuk munguan edhe rezultatet. Kështu, “Ferronikeli” filloi instalimin e sistemit “ventur” në dy furrat elektrike për eliminimin e pluhurit. Tani sistemi i filtrave të “venturit” në njërën furrë është në fazën e përfundimit dhe sipas planifikimit nga “Ferronikeli” menjëherë do të fillohet të instalohet edhe në furrë tjetër. Vlen të theksohet se “Ferronikeli” në objektet ekzistuese më herët fare nuk e ka pasur të instaluar sistemin e filtrave ose “ventur”. Pra, instalimi i filtrave po bëhet pas intervenimit dhe urdhrave të Inspektorit të Ministrisë.

Sa u përket vlerave të ndotjes, imisionet dhe emisionet gjatë funksionimit të “Ferronikelit”, operatori në fjalë ka obligim ligjor që ta bëjë monitorimin vetanak dhe në këtë drejtim ka bërë disa matje në intervale kohore të caktuara, por ndoshta jo edhe në afat të rregullt sipas ligjit përmes një kompanie nga Maqedonia. Rezultatet e këtyre matjeve janë të paraqitura në Ministri dhe disa vlera të imisionit dhe të emisionit janë të tejkaluara, por jo në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Pyetje shtesë, zoti Maloku? Ju lus, zotit Maloku ia jepni fjalën!

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti ministër! Përgjigja juaj ishte e pjesërishme. Pra, e pranoni që “Ferronikeli” ende nuk e ka montuar sistemin “ventur” të pastrimit të gazrave që dalin nga furrat dhe unë ju lus, zoti ministër, që të bëni mbikëqyrjen 24- orëshe të ndotjes së ambientit për shkak se gjatë turnit të tretë pra, shkyçen, sipas të gjitha informacioneve, edhe filtrat e thjeshtë e klasikë dhe lëshohen gazrat dhe pluhuri në mjedis. Zoti ministër, duhet shkencërisht të hulumtoni rrezikshmërinë e ndotjes dhe të bëni monitorimin sa më gjithëpërfshirës të Ferronikelit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Ministër, a dëshironi të merrni fjalën?

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Edhe një herë ju falënderoj. Saktësisht ne ende nuk e kemi një sistem të monitorimit të ndotjeve nga ajri. Për këtë vit e kemi planifikuar të bëjmë studimin dhe besoj se brenda vitit dhe vitit të ardhshëm do të bëjmë instalimin komplet për monitorimin e ajrit për tërë Kosovën. Gjithashtu, do të jemi në vazhdimësi të monitorimit përmes inspeksionit dhe përmes bisedave me zyrtarët nga “Ferronikeli” kështu që në këtë mungesë të rrjetit monitorues dhe besoj se sot do ta aprovojmë edhe Ligjin për... dhe do të kemi sistemin dhe infrastrukturën complete për këto çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar. Deputete Hulaj, e keni fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Së pari dëshiroj të them se e tejkaluat ju pikën 6, që e kam pyetjen, e keni tejkaluar.

KRYESUESI: Më falni, Kryetari ka kapërcye pyetjet që kanë të bëjnë me ministrat që s'janë prezentë këtu, më ka lënë porosinë, më duket se ishte kjo një marrëveshje.

NURISHAHE HULAJ: Ky ministri nuk është cekur se nuk është këtu.

KRYESUESI: Si?

NURISHAHE HULAJ: Nuk është cekur ministri Zenun Pajaziti që nuk është këtu.

KRYESUESI: Mund ta lexoni, nuk prish punë. Atëherë, lexojeni pyetjen. Ministri s'është...

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

Çështja: Ekzistojnë 6 kompani regjionale për menaxhimin e mbeturinave si shoqëri aksionare me menaxhim vetanak, të cilat bëjnë depozitimin e mbeturinave pa plan të veprimit dhe të riciklimit të mbeturinave. Veprimtaritë i zhvillojnë jashtë sistemit qendror, ekskluzivisht Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. Kjo formë e depozitimit të mbeturinave ndikon negativisht në mënyrë direkte dhe indirekte në shëndetin e popullatës.

Pyetja: e para, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor a ka mbikëqyrje mbi këto kompani dhe a ka planin strategjik orientues për administrimin dhe riciklimin e mbeturinave në shkallë vendi, i cili duhet të rishqyrtohet së paku në pesë vjet?

E dyta, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor a ka linjë të veçantë buxhetore, neni 38 pikë 1 i Ligjit për mbeturina, Numër

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! A ka mbetur shumë pa u lexuar? Jepjani fjalën, le ta përfundojë fjalën.

NURISHAHE HULAJ: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor a ka linjë të veçantë buxhetore për të stimuluar administrimin e mbeturinave në Republikën e Kosovës duke inkorporuar edhe këto kompani dhe sa herë keni zhvilluar programe për mbrojtjen e mjedisit gjatë vitit 2008 për të shpallë vendin mjedis ekologjik? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Edhe një herë ju falënderoj dhe dëshiroj t'ju informoj se Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina është e involvuar në aspektin ekonomik të administrimit të mbeturinave, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe e Financave menaxhon me ndërmarrjet publike. Shtatë kompani rajonale për menaxhimin e mbeturinave janë përgjegjësi për grumbullimin e mbeturinave, mbledhjen dhe transportimin e tyre në deponi. Kjo situatë vazhdon prej vitit 1999 dhe deri tash dhe me ndryshimin e disa ligjeve ose rregulloreve nga UNMIK-u, tash, më tutje me ligjet e Republikës së Kosovës.

Dëshiroj gjithashtu t'ju informoj se sa i përket mbikëqyrjes së këtyre kompanive, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor bën mbikëqyrjen administrative, ndërsa

sa i përket inspektimit dhe aktiviteteve për administrimin e mbeturinave, e bën Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit. Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit me Drejtorinë e Monitorimit e bën monitorimin e deponive sanitare lokale dhe regjionale të Kosovës, por edhe të atyre ilegale që ekzistojnë dhe kompanitë për menaxhimin e mbeturinave. Ndërsa, sa i përket planit strategjik orientues për administrimin dhe riciklimin e mbeturinave në shkallë vendi, e vërteta është se ende nuk ekziston, por në këtë drejtim kemi filluar të... që nga data 5 mars të vitit 2009, kur është mbajtur edhe punëtorja e parë për hartimin e planit strategjik të administrimit të mbeturinave në Kosovë, çka deri në fund të vitit pritet të dalë ky dokument i cili do të jetë për dhjetë vitet e ardhshme dhe do të miratohet nga Qeveria e Kosovës.

Për hartimin e planit lokal të administrimit të mbeturinave ende nuk është marrë ndonjë hap pozitiv nga komunat, përpos komunës së Prishtinës.

Edhe pse ISO, sipas Ligjit për mbeturina, neni 38 pikë 1, burimet e financimit për administrimin e mbeturinave Ministria e Mjedisit ende nuk ka ndonjë linjë të veçantë për financim të tyre, por kjo bëhet kryesisht nga burimet dhe pagesat e qytetarëve dhe operatorëve, të prodhuesve tjerë ku ekziston problemi i përqindjes së realizimit të pagesave.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja deputete?

NURISHAHE HULAJ: Vetëm edhe një... Sa herë keni zhvilluar aktivitete, respektivisht zbatim të programeve brenda vitit 2008 në shkallë vendi për të shpall vendin mjedis ekologjik. A keni bërë ndonjë aktivitet gjatë vitit 2008?

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ne i kemi aktivitetet në vazhdimësi, por sa dhe me data, tash nuk mund t'i cek, por Inspeksioni është në monitorimin dhe mbikëqyrjen në vazhdimësi.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Nuk është këtu! Faleminderit!

Deputetja Edita Tahiri, s'është!

Deputetja Kosara Nikoliq, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Idriz Vehapi. Nuk është!

Deputetja Kaqusha Jashari, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ka shumë objekte të ndërtuara pa leje, nuk po hyjmë në vlerësim pse. Por, ato që nuk janë në kundërshtim me planet urbanistike, unë mendoj se duhet të legalizohen. Legalizimi i tyre do të kishte përfitime buxhetore për çdo komunë, sidomos për komunën e Prishtinës.

Ku ka mbërri puna në hartimin e Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Të falënderoj për pyetje, zonja deputete!

Sa i përket Projektligjit ose Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, dëshiroj t'ju rikujtoj, sepse është aprovuar në Kuvendin e Kosovës, por nuk ishte shpallur nga ana e PSSP-së. Pas kësaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor prapë ka marrë në rishqyrtim Projektligjin dhe me disa korrigjime ne javën e kaluar e kemi dërguar në Qeveri dhe besojmë se së shpejti do të jetë edhe në Parlamentin e Kosovës për shqyrtim dhe, më tutje, për aprovim.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

KAQUSHA JASHARI: Jo, nuk kam pyetje shtesë, por ju lus nëse mund të vazhdoj, ani pse zoti ministër Enver Hoxhaj nuk është këtu, sepse e kam edhe një pyetje. Unë kam lutje, nëse mundet zoti Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministri të japë përgjigjen, sepse është lidhur me vendimin e Qeverisë.

KRYESUESI: Rregullorja ju lejon që ta bëni pyetjen, pastaj nëse s'ia keni bërë zotit zëvendëskryeministër, s'ka pse të përgjigjet, besoj. Problemin le ta zgjidh vetë, nëse paraqitet vullnetar. A doni ta lexoni pyetjen?

KAQUSHA JASHARI: Po, me lejen tuaj!

Qeveria e Republikës së Kosovës ka sjellë vendimin për akademikët mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës që kanë mbushur moshën 65 vjeçe, që t'iu vazhdohet kontrata e punës deri në përfundimin e vitit akademik. Gjithashtu, kjo strukturë është në pritje të vazhdohet kontrata deri në moshën 70 vjeçe.

Prandaj, pyetja është: A ekziston propozimi konkret nga Ministria ose Qeveria dhe në qoftë se po, kur do të rregullohet kjo çështje me ligj.

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, i cili po ashtu ka kërkuar që ta lexojë pyetjen për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje të gjithëve!

Pyetja ime për ministrin Ahmet Shala ka të bëjë me privatizimin. Zyrtarët e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në mënyrë të përsëritur janë prononcuar publikisht se është iniciuar procedura për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës – PTK-së.

Pyetja ime është kështu: Ku është bazuar, nga pikëpamja ligjore, fillimi i procedurës së privatizimit të PTK-së, sepse Ligji për ndërmarrje publike qendrore, kjo mund të shihet, domethënë e ndalon këtë, sepse në Ligj, në nenin 9, tekstualisht thuhet se privatizimi mund të ndodhë me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash në Kuvendin e Kosovës. Dhe, kjo nuk ka pasur kurrfarë miratimi në Kuvend për fillimin e këtyre procedurave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu. Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Nuk është. Vazhdoni, deputete Sylja!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë me funksionalizimin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, duke marrë parasysh funksionin që ka në zbulimin, hetimin dhe mbikëqyrjen e kërcënimeve të sigurisë së Republikës së Kosovës.

Sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë. Tanimë drejtori i AKI-së është zgjedhur, por jo edhe zëvendësdrejtori dhe inspektori i përgjithshëm.

Andaj, zoti Kryeministër, pyetja ime është: Pse nuk po emërohen dhe kur do të emërohen zëvendësdrejtori i Agjencisë dhe inspektori i përgjithshëm?

KRYESUESI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara, deputete Sylja!

Në kuadër të krijimit gjithëfunksional të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, me datë 4 shkurt 2009 unë dhe Presidenti kemi emëruar drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Republika e Kosovës e ka Agjencinë e Inteligjencës, e cila është në proces të funksionalizimit të saj në përputhje me ligjin dhe mandatin e saj. Çështja e emërimit të zëvendësdrejtorit dhe të inspektorit të përgjithshëm është pjesë e këtij procesi dhe ne jemi në verifikim përfundimtar të kandidatëve më të mirë për të dy këto pozita shumë të rëndësishme shtetërore.

Në anën tjetër, dua të theksoj se më e rëndësishme se sa shpejtësia kohore e emërimit të njerëzve në këto dy poste, është që të sigurohemi se do të për zgjedhim kandidatët më të mirë të mundshëm në kuadër të mundësive që kemi. Prandaj, nuk ka dhe nuk do të lejojmë punën nën presion kohor, por do të respektojmë cilësinë.

Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë është funksional, është duke punuar në bashkëpunim të ngushtë edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë, po përkujdesemi që Agjencioni i Inteligjencës Kosovare të ofrojë shërbimet e saja dhe të njëjtat në përputhje të vlerave properëndimore dhe të standardeve më të larta profesionale dhe dua të theksoj se sot Kosova është vendi më i sigurt në rajon.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Po! Ju lutem, deputetes Sylja, ia jepni fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Zoti Kryeministër, ju keni përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore të bëni zgjedhjen dhe natyrisht që koha është e rëndësishme. Nuk jeni në presion të kohës, por duhet të vendosni. Keni përgjegjësi. Kjo është e para.

E dyta, unë prapë po e shtroj pyetjen: kur do të zgjedhen, gjegjësisht kur do të emërohen zëvendësdrejtori dhe inspektori i përgjithshëm? Nuk mund të funksionojë një agjencion me një drejtor. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Agjencioini është duke funksionuar shkëlqyeshëm, në baza shumë të larta profesionale, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë. Unë nuk dua të spekuloj se do të ndodhë ky emërim sot, nesër apo pas disa ditësh, por dua t'ju siguroj juve, të nderuar deputetë, të gjithë qytetarët e Kosovës se në këto pozita do të emërohen kandidatë më të mirë – profesionistë për t'i shërbyer vendit tonë.

Në anën tjetër, dua të theksoj gjithashtu se Agjencioni i Inteligjencës Kosovare do të jetë shumë profesional dhe multietnik. Ky proces nuk duhet të lejohet që të politizohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja e fundit është nga deputetja Drita Maliqi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryeministër,

Duke u nisur nga fakti se barazia gjinore për shoqërinë dhe shtetin tonë po ndihen si nevojë e zhvillimit ekonomik, social, kulturor dhe politik, kur do të filloni të bindeni se gratë meritojnë dhe duhet të jenë pjesëmarrëse në të gjitha hallkat e qeverisjes së vendit në mënyrë që t'i përmbushni detyrimet ligjore dhe kushtetuese. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Faleminderit e nderuar deputete për pyetjen!

Në zyrën e Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës funksionon mekanizmi qeveritar për barazi gjinore - Agjencia për barazinë gjinore, e cila është ombrellë e strukturave qendrore dhe lokale të cilat merren me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. Duke pasur parasysh se respektimi i barazisë gjinore është baza e demokracisë dhe e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të shoqërisë sonë dhe duke pasur parasysh se çështjet gjinore janë parakusht për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në strukturat tjera ndërkombëtare, duke respektuar edhe vlerat që prezantojmë mund të themi se Qeveria ka realizuar progres të lakmueshëm institucional të kaluar jo vetëm me vendet e rajonit, por mund të them edhe më gjerë. 30.91% janë përqindje të ulëseve që zënë gratë në Parlamentin e Kosovës, gjegjësisht në asamblетë komunale, shifra këto që tejkalojnë kuotën e paraparë prej 30% me Ligjin mbi zgjedhjet.

Qeveria e Kosovës, më 24 prill 2008 ka miratuar programin e Kosovës për barazi gjinore dhe po ashtu Agjencia për Barazi Gjinore ka hartuar Raportin e parë për Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave për Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Po ashtu, brenda këtij viti, Agjencia për Barazi Gjinore është duke hartuar Strategjinë kundër dhunës në familje, si dhe Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje. Ndërsa, këtë vit, më 7 dhe 8 mars Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar Konferencën Ndërkombëtare – Gjinia dhe identiteti dhe njëra nga konkluzionet e asaj Konference është themelimi i Institutit për Hulumtime dhe Studime Gjinore. Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë zotimin e saj për ngritjen e këtij institucioni me rëndësi të veçantë.

Dhe, në fund, më lejoni të konstatoj se Qeveria e Republikës së Kosovës në vazhden e procesit do të angazhohet për arritje edhe më të mëdha në fuqizimin dhe avancimin e rolit

të gruas në të gjitha sferat e jetës, avancimin e mëtejshëm të drejtësisë gjinore sipas standardeve ndërkombëtare, zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë të grave dhe burrave, përmirësimin e kushteve dhe të pozitës së grave, analizën për rritjen e fuqisë vendimmarrëse dhe aksesin gjinor dhe implementimin e nevojave dhe interesave strategjike gjinore në të gjitha sferat e jetës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeministër! Zonja deputete, a dëshironi fjalën? Po!

DRITA MALIQI: Falënderojmë shumë zotin Kryeministër për këto teori shumë të mira, por unë, sipas mendimit tim, desha t'ua tërheq vëmendjen juve, si Qeveri, që të jeni të përgjegjshëm lidhur me përzgjedhjen e diplomateve dhe të ambasadoreve, në mënyrë që të përfaqësohet gruaja kosovare në këtë proces në mënyrën më të mirë të mundshme, siç ajo e meriton, meqë Kosova ka pasur dhe ka shumë gra të shquara dhe të dëshmuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kryeministër, dëshironi fjalën? Po, ishte koment, ndoshta s'ka nevojë. Zoti Kryeministër e ka fjalën. Regjia, fjalën e ka Kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, po shoh se po të qeshet, por janë këto fakte e jo teori. Ndërsa, në anën tjetër, sa u përket ambasadoreve apo ambasadorëve, unë nuk mund t'i premtoj askujt, asnjë burri, asnjë gruaje se mund të jetë, por aty do të vlerësohet cilësia, prandaj nuk duhet të përcaktohet pozicioni bartës shtetëror në bazë të gjinisë, por në bazë të cilësisë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Kemi një kërkesë nga deputetët, për 10 minuta pauzë. Ju lutem që pas 10 minutash të jeni në sallë dhe jo të vazhdojmë gjysmë ore. Pra, 10 minuta, do të thotë në 11,40 të jemi në sallë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë. Ju faleminderit që s' u vonuat, sipas marrëveshjes. Konstatoj se në sallë janë 65 deputetë, prandaj mund ta vazhdojmë punën. Pra, kemi kuorum për votim.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës-

Shqyrtimi i Programit të punës së Kuvendit për vitin 2009

Propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2009 është hartuar në bazë të strategjisë legjislative të Qeverisë për vitin 2009, planit të punës së komisioneve parlamentare, planit të veprimit të Kuvendit, si dhe Rezolutës për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian.

Me qëllim të planifikimit, organizimit dhe mbarëvajtjes së punës së Kuvendit dhe organeve të tij, Kryesia e Kuvendit i propozon seancës plenare miratimin e Programit të punës së Kuvendit për vitin 2009. Sipas Rregullores, të drejtë për të diskutuar kanë kryetarët e komisioneve parlamentare, përfaqësuesit e Qeverisë, kryetarët e përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe në fund deputetët, sipas paraqitjes.

A është dikush i interesuar që të diskutojë lidhur me programin në fjalë nga kryetarët e komisioneve parlamentare?

Zoti Bahri Hyseni është paraqitur në emër të Komisionit për Legjislacion. Fjalën e ka kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues,
Përhëndetje zëvendëskryeministër,
Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam vetëm një vërejtje, në faqen 7 të ligjet në rishqyrtim të komisionet funksionale që ka të bëjë me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

T'ju them të vërtetën ne si komision e kemi hartuar një raport përfundimtar për këtë ligj dhe e shoh që figuron edhe këtu në plan, edhe në planin legjislativ, mirëpo nuk e dimë ku është ligji. Ia kemi dorëzuar administratës dhe nuk e dimë ç' është bërë me fatin e ligjit. Ne kemi hartuar raportin përfundimtar dhe askush nuk na ka thënë që ky raport nuk është aprovuar. Prandaj, mendoj se edhe administrata edhe Kryesia e Kuvendit duhet ta qartësojë këtë. Nëse duhet edhe një herë ta marrim ta punojmë, le të na e bien në Komision, por ligjin nuk e kemi, nuk e di ku është. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Unë edhe pse s' jam i thirrur që të përgjigjem për këtë. Pra, sipas informacionit që kam është në Ministrinë e Financave duke u analizuar kostoja financiare. Nga kryetarët e komisioneve nuk është lajmëruar askush tjetër, por në emër të grupeve parlamentare, po. Në emër të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Programi i Punës i Kuvendit për vitin 2009 kemi pritur që të jetë një angazhim serioz në kontekst të identifikimit konkret të aktiviteteve të punës së Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht të deputetëve për vitin 2009, mirëpo, fatkeqësisht, ky dokument le shumë për të dëshiruar, sidomos në aspektin e përgjegjësisë të cilat ky Kuvend do të duhej t'i adresonte për këtë vit.

Këtu kemi shumë ligje apo shumë projekte të cilat i adresohen për punë Kuvendit të Kosovës, që janë mbështetur në strategjinë legjislative të Qeverisë të Republikës së Kosovës, për muajin janar, për muajin shkurt dhe për muajin mars e që ne ende nuk i kemi trajtuar. Pra, tash jemi në fund të muajit mars, prandaj kjo çështje duhet të përmirësohet dhe të harmonizohet me periudhën kohore kur Kuvendi i Kosovës ka mundësi t'i trajtojë këto projektligje.

Ajo çka është vërejtje substanciale nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka të bëjë konkretisht me vullnetin politik ... që, të paktën në mënyrë deklarative që është njohur për opinionin për luftë kundër korrupsionit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pra, në këtë rast mungon ligji i cili është përfolur shumë dhe është çështje imediate dhe aq e nevojshme që Kosova ta ketë sa më parë. Është Ligji për prejardhjen dhe deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik. Pra kjo nuk figuron në këtë projekt, në këtë plan të punës- në programin legjislativ të Kuvendit të Kosovës. Prandaj, vërejtje e grupit tonë parlamentar është që kjo çështje të trajtohet shumë seriozisht dhe të përmirësohet, të korrigjohet dhe të mos ta kemi përfundimin final- sot. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Ne këtu kemi një program të punës të Kuvendit për vitin 2009 që ka të bëjë kryesisht ose tërësisht me pjesën e punës legislative që duhet të jetë dhe është pjesa e punës themelore të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Një projekt i cili mbështetet kryekëput në strategjinë legislative që ka ofruar Qeveria e Kosovës si sponsori kryesor për të mos thënë gati ekskluziv deri me tash i ligjeve në Parlamentin e Kosovës, sepse ju e dini që të drejtën për të bërë projektligje e kanë edhe grupet e deputetëve, grupet parlamentare e tjera.

Ajo që bie në sy këtu është një lepezë e gjerë e propozimit të ligjeve nga lëmenjtë e ndryshëm të jetës në Kosovë dhe ajo që bie në sy- plus është që edhe zoti Zeneli, parafolësi im e tha. Ne tash i kemi kaluar tre muaj të këtij viti dhe kemi propozime që u referohen këtyre muajve ose kësaj kohe të kaluar, por vetvetiu analiza e shpejtë tregon që ky ritëm nuk është kapur, domethënë, qoftë në sponsorimin e ligjeve të propozuara, qoftë në kalimin e tyre në Parlament. Mbasandaj ka edhe çështje të tjera. Unë po e jap veç një shembull elementar që tregon që ekziston një mos konkordim i propozimeve të ligjeve dhe të asaj që quhet kohë- tajming e paraqitjes së tyre.

Te faqja 12, ne kemi serinë e ligjeve për energjinë dhe energjinë elektrike, 36-shti është Projektligji për Rregullatorin e Energjisë, 37 Projektligji për energjinë, 38 Projektligji për energjinë elektrike. Është propozuar maji si datë dhe shqyrtimi i parë në qershor, për të tria.

Në të njëjtën kohë, ne kemi në faqen 31, numrin rendor 113, ku thotë: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Është interesante ky anticipim, pse të anticipohet që ky ligj do të ndryshohet në një kohë që nuk precizohet kurrë tek 36 shti ne e ndërtojmë atë ligj. Në anën tjetër, ne qysh sot kemi në renditje një kërkesë të ndryshimit të Projektligjit .

Unë në këtë tip analize po ndalem këtu, por po them, kërkoj megjithatë një deklaram të Qeverisë këtu, para Kuvendit, një deklaram, do të thosha solemn të kërkesës, të përgjegjësisë dhe të punës. Kuvendi mund ta marrë në konsideratë këtë strukturë të kërkesës legislative, veçse Qeveria duhet të tregojë se kjo është tajming i tyre, kërkesë e tyre dhe nuk do të mund të marrë Kuvendi vendim dhe përgjegjësi për përgjegjësitë që mbeten brenda propozuesit, ose duhet të bëhet një kontratë strikte në mes të Kuvendit dhe të Qeverisë për kohën dhe për tipat e ligjeve që propozohen të kalojnë në Kuvend. Ju faleminderit!

Në princip e përkrahim Projektin.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së ka rezervat e tij sa i përket këtij Programi, për të cilin konsiderojmë se është i mangët. Nuk janë të renditura çështjet ose projektligjet sipas prioriteteve që do të duhej t'i kishin sipas kësaj radhe. Po ashtu, programi përmban vetëm çështje që vijnë nga Qeveria dhe jo edhe një agjendë të Kuvendit të Kosovës. Unë këtu vetëm po tërheq vërejtjen, sepse konsideroj se do të duhej të ishte në këtë raport. Kemi një mori institucionesh të pavarura të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ju sikurse e dini, sot e kësaj dite janë të pakompletuara ose që u ka kaluar mandati ligjor kaherë. Konsiderojmë se ky program i punës së Kuvendit duhet të përplotësohet, në mënyrë që të jetë më i thukët dhe më i qartë kur të vijë në seancë.

Ky program nuk do ta ketë mbështetjen e Grupit Parlamentar të AKR-së.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se qasja e hartimit të një programi të punës së Kuvendit është qasje pozitive, si e tillë, por, sidoqoftë, siç thanë edhe parafolësit të cilët nuk po dëshiroj t'i përsëris, është se Parlamenti varet prej planit legjislativ të Qeverisë. Në këtë rast, varësia është e qartë dhe sikur kjo varësi të rezultonte me diçka pozitive, atëherë nuk do të kishte pasur kurrfarë problemi, por ajo që shohim ne në këtë program të punës, është realisht, më shumë një orar se sa një plan për shkak se as plani legjislativ i cili na është sjellë nuk ka qenë plan, ka qenë më tepër një radhitje e disa ligjeve të cilat dikush ka menduar se duhet të aprovohen e ndoshta ligjet të cilat janë mbledhur prej ministrive për të cilat prapëseprapë nuk ka pasur debat politik, por i ka sjellë administrata. Është një përcjellje prej më përpara.

Pra, këtu është fjala për mospërputhje me oraret kohore, për një plan i cili që tani dihet që nuk do të mund të zbatohet për shkak se kanë kaluar disa afate dhe do të përcillen edhe më vonë. Që të jem më i qartë në këtë pikë, edhe nëse ne sot e aprovojmë planin e dimë që nuk do të mund të implementohet për shkak se jemi vonuar.

Çështja tjetër që është tepër e rëndësishme është se plani legjislativ nuk i përcjell prioritetet qeverisëse të vendit. Kur themi plan, atëherë shpjegimi për këtë plan duhet të jetë i formatit që dikush thotë, nëse ekonomia është prioritet numër një, atëherë i kemi këto ligje të cilat vijnë të parat e brenda ligjeve të para të ekonomisë i kemi këto prioritetet të brendshme dhe rrjedhoja në fund cili ligj, cilin ligj e pason është e qartë. Ne nuk kemi absolutisht diçka kësisoj, do të thotë e kemi vetëm një grumbull të ligjeve të nxjerra me data, që nuk kanë asnjë lidhshmëri në mes veti dhe që absolutisht nuk e kanë marrë fare në konsideratë sistemin e qeverisjes ose prioritetet të cilat ne i dëgjojmë në televizor.

Tani, meqenëse është kështu dhe meqenëse Kosova nuk është një vend i cili sapo ka themeluar Kuvend të vetin dhe meqenëse jemi në situatën në të cilën duhet të insistojmë që të kenë sistem më serioz të menduarit e të punës afatgjatë, ne mendojmë se ky plan duhet të kthehet. Pra, duhet të punohet më me kujdes, duhet të ketë një bashkëpunim shumë më të ngushtë mes komisioneve parlamentare dhe Qeverisë, që ato prioritetet të cilat janë vendosur dhe ai plan legjislativ i cili na është sjellë këtu, të harmonizohet në planin e punës të Kuvendit. Dhe në fund të fundit ta kemi një program të punës së

Kuvendit, i cili me të vërtetë do të mund të quhet program. Kjo që e kemi përpara , realisht është humbje kohe dhe ne mendojmë se Kuvendi nuk ka kohë për të humbur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, në emër të grupeve tjera parlamentare nuk është paraqitur askush. Është paraqitja e deputetëve. Zoti Buja, u paraqit në emër të PDK-së.

RAMË BUJA: Të them të drejtën, unë nuk desha të paraqitem për faktin që është një plan, një program i legjislativit që unë mendoj se është i mirë, përmbajtjesor dhe si t'ia bëjmë që të realizohet, sepse në afatin kohor disa gjëra i kemi tejkaluar dhe nuk i kemi realizuar, kështu që ai apel që erdhi nga kolegët e mi që Qeveria të jetë më dinamike në punën e saj për të ofruar projektligjet. Pra, këtu do të bëja si apel, përndryshe është bërë një program i mirë, por si ta realizojmë- ky është halli. Ne si grup parlamentar, natyrisht e mbështesim këtë program të legjislativit të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “ 7+”, deputeti Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit zoti kryesues!

Kosova Cumhuriyeti Meclis'inin 2009 yılı Çalışma Programı, bu dönemdeki Meclis etkinliklerini kanun temsilcisi ve benimseyicisi olarak ele almaktadır. Söz konusu Taslak Program hazırlanırken şu noktalar göz önünde bulundurulmuştur:

Hükümetin 2009 yılı Strateji Programı,
Parlamente komisyonların 2009 yılı Çalışma planları,
Meclis'in 12 Aralık 2008 yılı Yürütme Programı ve
Kosova'nın Rezolüsyon ve beklentileri Stratejisi ile
Avrupa Birliği'ne entegrasyonu, Gelişme stratejisi ve
Avrupa Komisyonu 2009 yılı Gelişme Raporu temel olarak alınmış ve hazırlanmıştır.

Bütün bu çalışmalar 2009 yılı Çalışma Takvimine göre gerçekleşecektir. Bu çerçevede Parlamento Komisyonların, Başkanlık Kurulunun ve oturumların Taslak Takvimine uygun şekilde gerçekleşmesi düşünülmüştür. Programda toplam 115 Yasa Tasarısı, 3 Rapor ve Meclis Çalışma İçtüzüğü'nün bu süreçte bu süreçten geçmesi beklenmektedir. Nisan ayına kadar ise 19 Yasa Tasarısının benimsenmesi düşünülmüştür. Dolayısıyla 7+ Parlamento Grubu adına, Çalışma Programı'nın kabul edilir olduğu görüşünü bilginize arz ederim.

Faleminderit

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatoh që vërejtjet e grupeve parlamentare janë ezauruar. Dua t'ju them grupeve parlamentare të përfaqësuesve në Kryesinë e Kuvendit, ku kanë qenë edhe kryetarët e grupeve parlamentare edhe anëtarët e Kryesisë, nuk e kanë kundërshtuar planin në fjalë dhe tani në seancë po e kundërshtojnë.

Sipas radhës, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Programi i punës së Kuvendit për vitin 2009 është i rëndësishëm, sepse është një dokument bazë mbi të cilin do të zhvillohen aktivitetet e Kuvendit. Prandaj, planifikimi i mirë i tij duhet të sigurojë edhe punën efikase të Kuvendit. Meqenëse, duke e lexuar programin, unë nuk fitova përshtypjen se është i planifikuar mirë, i kam pesë vërejtje të përgjithshme dhe një vërejtje të veçantë.

Vërejtja ime ka të bëjë me vetë procesin e hartimit të programit, për arsye se, në qoftë se është dokument bazë, nga ky dokument bazë është dashur të rrjedhë plani i veprimit dhe jo e kundërta, nga plani i veprimit të rrjedhë pastaj plani i punës bazë.

Tjetra, Programi i punës është një vizion njëvjeçar se çka synon Kuvendi, cilat janë objektivat e Kuvendit si dhe përcaktimi i këtyre objektivave. Kurse, kështu si është, ky program i punës është më tepër një agjendë me një rend dite. Kjo është vërejtja e parë e përgjithshme që kam.

Sa i përket përmbajtjes së Programit të punës, vërejtja im ka të bëjë me aktivitetet legjislative, të cilat kryesisht bazohen në agjendën legjislative të Qeverisë. Ligjet që janë përfshirë, edhe pse shumica nga këto kanë afate kohore, janë edhe ligje shumë të rëndësishme, por të cilat nuk kanë afate kohore. Ndër këto ligje janë:

- Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor,
- Projektligji për Qeverinë,
- Projektligji për shërbimin civil dhe pagat e nëpunësve civil,
- Projektligji për Referendumin lokal dhe
- Projektligji për qytetin e Prishtinës.

Se kur do të procedohen në Kuvend, kur do të jetë shqyrtimi i parë dhe i dytë i tyre, nuk dihet. Sa i përket afatit kohor, menjëherë do ta bëj një vërejtje lidhur Projektligjin për mërgatën.

Sipas Programit, del se shqyrtimi i parë bëhet në muajin shkurt. Ne e kemi kaluar muajin shkurt dhe ende s' e kemi shqyrtuar këtë projektligj, prandaj, propozoj që afati menjëherë të shtyhet ashtu që në muajin prill, të bëhet shqyrtimi i parë, kurse shqyrtimi i dytë në muajin maj ose qershor. Kjo ishte vërejtja ime e dytë.

Sa i përket vërejtjes së tretë, funksioni mbikëqyrës i Kuvendit i cili duhet të fuqizonte Kuvendin në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, pothuaj se nuk është planifikuar fare. Nga i gjithë programi, kemi vetëm tri raporte të komisioneve, një nga Komisioni për Shëndetësi që është Raporti për mbikëqyrjen e Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi, një është nga Raporti i Komisionit për Ekonomi, Tregti, që do ta bëjë mbikëqyrjen e Ligjit për rrugët dhe një nga Komisioni për Integritet Evropian, që ka të bëjë me Raportin për përmbushjen e Planit të veprimit për partneritet evropian. Nuk mendoj se vetëm me mbikëqyrjen e tri ligjeve, Kuvendi mund ta ushtroj funksionin mbikëqyrës për zbatimin e ligjeve.

Propozoj që së paku dy ligje brenda vitit 2009, secili komision t'i shqyrtojë. Kjo është vërejtja ime e tretë.

Sa i përket vërejtjes sime të katërt ka të bëjë me mungesën e raportimit të punës së Kryesisë së Kuvendit, e cila ka një rol të madh në vetë mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Por, kryesia ka përgjegjësi edhe në hartimin e Projektbuxhetit të Kuvendit, pastaj për mjetet financiare dhe vendosjen e rregullave. Prandaj, vërejtja e katërt është që Kryesia duhet t'i raportojë Kuvendit për punën e vet.

Vërejtja e pestë ka të bëjë me vet rolin e funksionit përfaqësues të deputetëve. Nuk është e definuar aspak se ku zhvillohen këto aktivitete dhe cila është mbështetja e Kuvendit.

Një vërejtje të veçantë e kam, se që në fillim të programit thuhet se Programi i punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, paraqet dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit si organ ligjdhënës dhe përfaqësues. Duhet shtuar dhe mbikëqyrës, domethënë është harruar një funksion shumë i rëndësishëm i Kuvendit, ai mbikëqyrës.

Prandaj, në vërejtjet të cilat i paraqita, mendoj se Programi i punës duhet të plotësohet dhe se si i tillë është i mangët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit,
Sipas renditjes, fjalën e ka deputeti Hyseni- Kaloshi.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zonja e zotërinj deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që duke ju përshëndetur të gjithëve, të përshëndes praktikën që kjo legjislaturë po e instalon- prezantimin e programit të punës, kalendarit të punës e kështu me radhë. Është diçka e re për të cilën mendoj që duhet lavdëruar edhe Kryesinë. Si rrallë po na ndodh kjo.

Zonja e zotërinj,

Unë pajtohem edhe me vërejtjet që u thanë, do të mund programi i punës të kishte më shumë kujdes për prioritetet, do të mund të mbështetej më shumë ndoshta në nevojën e nxjerrjes fillimisht ë ligjeve bazike, themelore dhe mbi këtë bazë pastaj ligjeve tjera, por , megjithatë, fakti se ka një kthesë pozitive, mendoj duhet përshëndetur dhe mbi këtë bazë besoj mund të rregullohen edhe këto kërkesa tjera.

Unë kësaj radhe desha të ngre një çështje dhe këtë duhet ta bëjë që në fillim të qartë. Është një çështje që na intereson besoj të gjithëve që kemi pasur edhe një qasje që në fillim inkluzive gjithëpërfshirëse, prandaj e shtrojmë për ta riaktualizuar, por jo për të fajësuar askënd, jo për të drejtuar as romuze as shigjeta kundër askujt.

Në Programin e punës, por edhe në kalendarin e ligjvënies mungon Projektligji për të drejtat e ish - burgosurve politikë. Kërkesa ime që në fillim edhe në emër të deputetëve nënshkrues, kanë qenë 44, tash janë 66, është se kjo nismë ligjdhënëse të zë vendin në programin e punës edhe në kalendarin ligjdhënës dhe të procedohet sa më parë që është e mundshme.

Si arsyetim, më lejoni vetëm të them shkurtimisht se çështja e rregullimit me ligj të kësaj padrejtësie të madhe të së kaluarës, ka qenë që në nismë të funksionimit të institucioneve të reja në Kosovë. Kaq qenë pjesë e programit ligjdhënës të Qeverisë së

parë. Është përfshirë edhe në punën që është bërë për kategoritë e dala nga lufta. Në marrëveshje ka qenë lënë që të rregullohet kjo çështje me ligj të veçantë. Ka një nen në atë ligj që thotë se çështja e të burgosurve politikë rregullohet me ligj të veçantë dhe Qeveria ka qenë e obliguar ta bëjë këtë ligj. Nuk e ka bërë, por në kalendarin ligjdhënës ka qenë e përfshirë.

Shoqata e të Burgosurve Politikë, në bashkëpunim me Shoqatën e Juristëve kanë punuar në një draftligj, janë bërë disa të tillë dhe grupi i deputetëve iniciues, me grupin e deputetëve nënshkrues e kanë proceduar muaj më parë Projektligjin në përputhje me procedurën. Ju e dini se procedurat thonë se 6 deputetë mjaftojnë që të nisin një ligj dhe në rast të tillë Kryesia e vë në rend dite në procedurë, do të thotë Rregullorja nuk lë mundësi për procedime të ndryshme. Nuk do mend që të janë respektuar të gjitha kërkesat e procedurës. Ka pasur një keqkuptim që mendoj ka qenë pasojë e mos leximit të ligjit - çështja e implikimeve buxhetore.

Në përputhje me përvojat e vendeve të tjera, sidomos të: Kroacisë, Sllovenisë, Shqipërisë dhe vendeve tjera përreth, është dizajnuar një strategji e zgjidhjes në faza. Në fazën e parë ka pasur kujdes shumë që të mos ketë implikime financiare dhe kjo është bërë në memorandumin shpjegues. Është bërë madje edhe një shkresë plotësuese për të hequr çdo dilemë. Edhe Zyra për Standardizim ka konstatuar se kjo është në përputhje me standardet dhe me praktikën demokratike. Duhet ta sqaroj që gjatë hartimit të Projektligjit është pasur kujdes që çështja të rregullohet në parim dhe gjithmonë ku ka implikime financiare është kërkuar prej Qeverisë që atë ta rregullojë me akte të veçanta siç është vepruar në Kroaci dhe në vendet të tjera. Dhe është punë e Qeverisë pastaj aty që aty ta mbrojë edhe kalkulimin dhe koston financiare. Nuk di a ka nevojë të nënvizoj se si pasojë e zvarritjes së kësaj çështjeje po na ndodh çdo ditë pothuajse të vdesin veteranë, njerëz që kanë kaluar gjysmën e jetës nëpër burgje, pa pasur mundësinë edhe të shohin qoftë një satisfaksion moral për atë vuajtje, për atë investim që e kanë bërë. Ata herë vdesin të stigmatizuar si armiq, nacionalistë, kundërrevolucionarë e tjera- tjera. Shoqëria kosovare i ka borxh shumë kësaj kategorie, ata janë treguar vetëmohues, por nuk kuptim që edhe shoqëria si familje t'i mohojë, t'i injorojë. Kemi parasysh sidomos atë gjeneratën e veteranëve të pasluftës së Dytë Botërore që i jetojnë ditët e fundit. Prandaj, zonja dhe zotërinj, është një çështje që na ka bashkuar të gjithëve. Grupi vlerësues përbëhet prej të gjitha grupeve parlamentare. Të gjithë shefat e grupeve parlamentare i kanë nënshkruar. Janë 66, më shumë se sa gjysma e deputetëve, praktikisht do të thotë është diçka që është miratuar me vetë faktin e nënshkrimit nga ana e një numri të tillë të deputetëve. Kërkojmë nga Kryesia që pa vonesë ta rikthejë në kalendarin e punës, programin e punës. Besoj se Qeveria do ta kryejë atë formalitet, objektivist të panevojshëm... dhe ne të mos jemi delja e zezë. Kosova ka pasur më së shumti arsye që ta shtrojë e ta zgjidhë këtë çështje drejt për arsyet që dihen. Kosova është i vetmi vend që ende nuk ka bërë asgjë. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni! Fjalën e ka deputeti Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e shqyrtojmë sot Programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009. Ky është një dokument i rëndësishëm dhe i orienton kahet e punës sonë për këtë

...

Hartimi i këtij programi të punës së Kuvendit është bazuar në këto dokumente. Po citoj: Dokumenti i Qeverisë për strategjinë legjislative për vitin 2009, plani i punës së komisioneve parlamentare, plani i veprimit të Kuvendit, si dhe Rezoluta për prioritetet dhe strategjitë e Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian dhe plani i veprimit për sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009, kur si institucione dhe si shtet kemi marrë vërejtje serioze pikërisht edhe në mos hartimin adekuat të strategjisë legjislative dhe unë këtu shoh shumë të meta.” Mbarëvajtjen, po citoj e të gjitha aktiviteteve sipas dinamikës të përcaktuar me këtë program do ta mbikëqyrë Kryetari apo Kryesia e Kuvendit”

Po citoj prapë: Realizimi i Programit të punës së Kuvendit, kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Qeverinë e cila duhet t’i përmbahet Planit legjislativ për vitin 2009.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne tani po hyjmë në përmbylljen e tremujorit të parë të vitit 2009, po vërtet ka diskrepanca dhe mos përputhje serioze dhe anashkalim të strategjisë legjislative që i ka dërguar vetë kjo Qeveri organit më të lartë legjislativ të vendit. Dhe në qoftë se Qeveria bie në mos pajtueshmëri me një strategji legjislative që e ka hartuar vetë, atëherë as punës së Kuvendit nuk i këndohet mirë.

Unë i kam edhe disa vërejtje substanciale për sektorët caktuar që janë shumë të rëndësishëm për rregullimin e atyre fushave në përgjithësi me ligjet që thjesht janë obligime të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Projektligji i punës i radhitur nën numrin rendor 23, shqyrtimi i parë, prill 2009, disa herë është tërhequr ky ligj, ka ardhur këtu në Parlament, por për disa vjet që po plotësohet, po hartojmë e tjera dhe unë jam skeptik dhe është skeptike edhe vetë Qeveria dhe ne duhet t’i precizojmë konform prioritetëve dhe obligimeve që i kemi edhe ndaj mekanizmave të tjerë, që vërtet në prill të vitit 2009 të fillojë të procedohet në Kuvend një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm për një korpus- grup të madh të shoqërisë kosovare. Këtu është Projektligji për pensionet. U është premtuar njerëzve konkretisht nga partia më e madhe, u është premtuar edhe përmes bisedave zyrtare në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nuk është askund në strategjinë legjislative. Është, por shumë vonë dhe kjo do të shkoj, e por të gjithë jemi skeptik në këtë çështje, sepse po bëhen vite e vite. Vërejtje tjera shumë substanciale kemi edhe te Projektligji për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve më të lartë publik. Shqyrtimi i parë thotë korrik 2009. Ju lutem, kjo është një kërkesë decitive që del nga sfidat e Raportit të fundit të progresit të Komisionit Evropian dhe duke ditur që ky raport publikohet më 5 nëntor të këtij viti, kur do të vjen leximi i dytë, kur do të nënshkruhet. Do të thotë, gjithsesi, është bërë një caktim i prioritetëve, jo konform kërkesave dhe vërtet rëndësinë që e kanë projektligjet e caktuara.

Kemi pastaj Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, thotë: Shqyrtimi i parë - korrik 2009. Duke e ditur tani edhe tendencën e Qeverisë që pas 14 muajsh tentoi t’i ketë që të hartojë një strategji për nxjerrjen e sistemit shëndetësor të Kosovës nga kolapsi, bie ndesh edhe deklarimi i Qeverisë edhe me strategjinë e vet legjislative.

Janë këto vërejtje dhe në mungesë e kreativitetin në caktimin e prioritetëve për ligje themelore bazike që janë kërkesë edhe të mekanizmave ndërkombëtar. Pastaj, ligj,

Projektligji i radhitur nën numrin rendor 53 për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Edhe kjo është një kërkesë imediate. Ju lutem, shqyrtimi i parë thotë korrik 2009. Është këtu zëvendëskryeministri që e mbulon një sektor të rëndësishëm të procesit të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Pse në korrik, kur bëhet leximi i dytë dhe duke e ditur rëndësinë e këtij projektligji edhe në luftë kundër korrupsionit se ka qenë një nga kritikët dhe vërejtjet serioze nga mekanizmat e Bashkimit Evropian, atëherë po bien në kolizion me vetveten dhe po bie rëndësia e punës së këtij Parlamenti, sepse edhe në atë strategji për luftë kundër korrupsionit që në një farë forme ka qenë de facto edhe në forumet e larta institucionale, edhe politike edhe në shoqërinë civile.

Zoti zëvendëskryeministër, nën tri ose katër ligje pas ... do të thotë keni dështuar në dhënien e përgjigjeve adekuate të sfidave që dalin nga raporti i fundit i progresit të Komisionit Evropian.

Pastaj, Projektligji për financimin e partive politike. Edhe ky diku është caktuar në pjesën e dytë të vitit 2009, duke e ditur që edhe ajo është një kërkesë edhe e mekanizmave që e monitorojnë në njëfarë forme edhe luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar, larjes së parave e tjera. Ne do të kemi zgjedhje në këtë vit, pa marrë parasysh në çfarë niveli dhe unë kisha kërkuar nga Kryetari dhe Kryesia, po edhe shefat e grupeve parlamentare që të rishqyrtojnë edhe një herë prioritetet për ligjet e caktuara që thjesht ky legjislativ si organ më i lartë legjislativ i vendit, të ketë një obligim që të na japë përgjigje adekuate institucionale dhe të qëndrueshme para mekanizmave ndërkombëtar. Unë kam vërejtje edhe tjera që janë vërtet substanciale, por është gabim... pastaj i takon caktimit dhe rëndësisë së prioritetëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë dua t'ju sqaroj që përshtypjen e kam përshtypjen që disa deputetë nuk e kanë lexuar në tërësi programin. Së dyti, shumë fjalë që po i thoni këtu, keni pasur mundësi t'i thoni në komisionet parlamentare dhe nuk i keni thënë dhe tani po i thoni që mendoj, ose nuk keni marrë pjesë në komisione, ose as s' keni marrë marr pjesë në komisione, ose s' e keni lexuar materialin, dhe se treti, ky material mendoj që i plotëson kushtet për të ecur më tej, por shumë detyra që po kërkojnë nga Kryesia, janë të komisioneve parlamentare. Keni parasysh këtë, është mirë që komisionet parlamentare t'i dinë detyrat e tyre dhe anëtarët që po diskutojnë, duhet të diskutojnë në komisionet parlamentare. Fjala është për deputetin Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë nuk do të ndalem në ndryshimin e agjendës, sepse definitivisht shihet se ne kemi ngecur pak në aktivitetet e parapara në këtë program të punës, domethënë të Kuvendit, sipas datave të shënuara.

E thanë edhe kolegët e mi deputetë se Programi i punës është bazuar kryesisht në dokumentin e Qeverisë për strategjinë legjislativë për vitin 2009. Unë do ta them një vërejtje konkrete e cila më shumë shkon për Qeverinë dhe konkretisht për Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, sepse në fund të vitit të kaluar kemi votuar këtu propozim ndryshimin e Rregullores, domethënë paketën fiskale e cila ka qenë dhe në atë kohë kemi marrë zotimin e ministrit se në vitin 2009 do të vijë e njëjta, por do të vijë të gjitha këto ndryshime në mënyrë të përnjëhershme, sepse janë shumë të lidhura njëra me tjetrën dhe nuk bën të vijë, njëra për shembull Projektligji për tatimin e vlerës së

shtuar t'i paraprijë Projektligjit për tatimin e të ardhurave të korporatave apo të ardhurave individuale. Dhe mendoj që të gjitha këto ndryshime që ne i kemi votuar, si ligje të vijnë të gjitha përnjëherë dhe të hyjnë në agjendën e punës së Kuvendit në të njëjtin muaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Për hir të opinionit, agjenda e Qeverisë ka qenë në shqyrtim në të gjitha komisionet e Parlamentit dhe komisionet e Parlamentit i kanë pru raportet me rekomandime dhe mbi bazën e raporteve të rekomandimeve të komisioneve parlamentare, është hartuar programi i punës. Vazhdojmë debatin. Deputeti Shkumbin Demaliaj e ka kërkuar fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me gjithë respektin dhe atë që ju po drejtoni ndaj deputetëve, atëherë s'është dashur të futet në rendin e ditës shqyrtimi i këtij programi, por të miratohet në paketë, pikërisht në këto ditë, meqenëse është si pikë shqyrtimi Plan-programit të punës së Kuvendit për vitin 2009, edhe po e shqyrtojmë atë. Edhe në kuadër të komisioneve parlamentare ku marrin pjesë deputetët e të gjitha grupeve parlamentare, nuk do të thotë se askush nuk ka qenë kundër. Edhe sot edhe ato vërejtje mund t'i thoni pikërisht në Kuvend, kështu që për të mos përsëritur gjithë atë çka u fol edhe nga parafolësit e mi, unë isha ndalur në radhë të parë të Projekt rregullorja e Punës së Kuvendit, gjë që ka kaluar ky mandat. Ne tani pikërisht jemi te fundi i muajit mars, do të thotë- thuhet afati i dërgimit 15 mars është shqyrtimi i dytë, java e fundit e marsit 2009. Në javën e marsit ne nuk do të kemi mundësi të jemi në seancë edhe dihet se me mos implementimin e Rregullores të Punës së Kuvendit, Projekt rregullores, ne kemi mbetur shumë mbrapa në mundësinë e mbikëqyrjes parlamentare ndaj shumë institucioneve të Republikës së Kosovës. Me theks të veçantë e përmend këtu Agjencinë për Inteligjencë, sepse duhet të formohen edhe dy komisione parlamentare me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që vetë e kemi miratuar në këtë Kuvend. Në këtë rast kisha pasur dëshirë të them se në kuadër të këtij plan- programi të punës së Kuvendit, shihet se është thjesht agjendë e Qeverisë dhe ka ardhur me mundësi të implementimit sot edhe të miratimit nga Kuvendi i Kosovës, mirëpo ligjet bazike, që u përmendën shumë ligje bazike, por ne kemi ligjet më bazike që sot i mungojnë Kosovës. Me theks të veçantë po përmend numrin 115, faqja 31 Projektligji për Qeverinë. Qeveria e Kosovës edhe sot e kësaj dite edhe një vit e më shumë nga shpallja e pavarësisë së vendit punon me Rregullore të UNMIK-ut. Është nr. 111, faqe 30 Projektligji për shërbimin civil që punon me Rregullore të UNMIK-ut. Nr. 112, faqe 31 Projektligji për pagat e nëpunësve civil që punon me Rregullore të UNMIK-ut, kështu që edhe disa projektligje u pa edhe në këtë rast që është edhe Projektligji për qytetin e Prishtinës që nuk kanë as kohë të shqyrtimit as afat të miratimit as kur vijnë në Kuvend, mirëpo vetëm janë futur në kuadër të kësaj agjende. Nuk kisha pasur dëshirë të lëshohem më tutje, mirëpo e tha edhe shefi i grupit tonë parlamentar, ne dhe jemi kundër këtij programi dhe kështu do të vazhdojmë. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI: Në mungesë të këtyre rregulloreve komisionet kanë të drejtë ta kenë edhe planin e tyre të hartimit të projektligjeve. Mendoj që edhe këtë pjesë të Rregullores ta lexoni ju dhe do të duhej që komisioni ta kishte bërë programin e punës për ligjin.

Vazhdojmë, fjalën e ka deputeti, ju kisha lutur ta lexoni mirë Rregulloren e Punës edhe të vjetrën edhe të renë.

Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje zëvendëskryeministër, ministra dhe kolegë deputetë.

Unë e mbështes Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2009 dhe do ta votoj. Mendoj se ka nevojë për një plotësim për të cilin me një kujdes më të madh, jam shumë i bindur që vetë Kryesia do t'i plotësonte këto që i ka dashur t'i thosha. Ky program i punës është bërë në bazë të agjendës së Qeverisë, ndërkaq këtu nga ana e deputetëve nuk ka ndodhur, domethënë këto dy mandate që jam unë, së paku, mos gabofsha, që nga Kuvendi i Kosovës të ofrohet një ligj i caktuar. Për fat të mirë është i ofruar nga deputetët, kësaj radhe Ligji për të burgosurit politikë edhe mendoj se Kryesia e anashkaluar, ndoshta, s' ka pasur mjaft vëmendje, përndryshe kjo i ka nënshkrimet e nevojshme edhe duhet të përfshihet, sipas mendimit tim në Programin e punës për vitin 2009.

I bashkohem gjithë asaj që tha deputeti Hydajet Hyseni lidhur me këtë dhe nuk do ta përsëris. Një diçka që mendoj se duhet ta kishte pasur në vëmendje Kryesia gjatë hartimit të programit të punës, është çështja e Ligjit për dëshmorët, invalidët dhe veteranët. Është ende e pa sqaruar deri në fund çështja e këtij ligji.

Është thënë se ligjet, të cilat nuk i ka nënshkruar PSSP-ja do t'i rikthehen edhe një herë Kuvendit të Kosovës. Ky ligj, për të cilin unë po flas nuk është i nënshkruar nga PSSP-së dhe tash nuk është e qartë se si do të procedohet. Mendoj se duhet të gjendet një formë të jetë në Programin e punës. Përndryshe, unë e kam shfletuar ueb faqen e Kuvendit të Kosovës, ka qenë ky ligj dhe është tërhequr prej ueb faqes. Tash ekziston si projektligj në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe në bazë të saj punohet. Ky projektligj ka nevojë gjithashtu edhe për një plotësim të nevojshëm rreth kategorive të dëshmorëve nga vitet e mëhershme dhe së paku nga koha e demonstratave të vitit 1981 e këtej, por edhe më herët. Gjithashtu, ka nevojë, është Kryetar, te numri 61, e kemi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Ne e dimë se ky ligj nuk ka dhënë ndonjë rezultat në shëndetësi, ndërkaq nuk është, edhe nuk pritet që prej këtij ligji të dalë diçka... E dimë mirë se ky është një ligj pak a shumë i tejkaluar që s' e ka kurrkush në rajon, duhet të sillet Ligji për sigurimet private shëndetësore edhe nuk e di pse nuk është në agjendën e këtij viti.

Unë i kisha këto vërejtje, përkatësisht plotësime dhe besoj se do të merren parasysh.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar Kryetar,

Të nderuar qeveritarë deputetë dhe nëpunës civil të Kuvendit që e kryeni punën me korrekti.

Unë e përshëndes punën e Qeverisë që na ka ofruar programin e punës edhe kalendarin e punës, ashtu siç tha edhe zoti Hyseni, se është një dokument që është i nevojshëm. Natyrisht, nuk është i përkryer dhe do t'i kisha dhënë disa sugjerime. Një, po e zëmë do të isha angazhuar që të inkorporohet në këtë program Ligji për origjinën e pasurisë që e apostrofoi edhe zotëri Zeneli, do të ishte një dokument tepër i rëndësishëm, i dobishëm, i nevojshëm. Do të isha angazhuar që çdo 6 muaj Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ketë një pikë të rendit të ditës- Raport për analizën e implementimit të akteve ligjore që po miratojmë. Mos të bëhet që ne miratojmë, fabrikojmë akte ligjore dhe pastaj s' dimë

a i përfill kush apo nuk i përfill kush, prandaj kjo do të ishte punë e mirë që ne të dimë se çfarë bëhet me këto dokumente që po i miratojmë, a kjo fundi i fundit është intenca themelore- zbatimi i ligjit e jo miratimi, madje, miratimi është më tepër teknik.

Do të isha angazhuar që të inkorporoj Ligjin për Universitetin e Prishtinës. Aty ka shumë anomali, ndër të tjera, po e zëmë profesori universitar trajtohet si nëpunës civil. Kjo, ndër të tjera ... atë që edhe zonja Jashari me vend, e theksoj më parë në pyetjet parlamentare. Po e zëmë profesori universitar, sipas standardeve të Unionit Evropian, pensionohej nga mosha 70-vjeçare. Ne kemi shumë nevojë për profesorë, ne kemi pak profesorë. Universitet shumë të zhvilluara nuk i pensionojnë profesorët, madje- madje kurrë nuk i pensionojnë e ne kemi nevoja të mëdha e i pensionojmë nga mosha 65-vjeçare.

Ju lutem, zotëri Kryetar. Do të duhej ne ta fusim në program Kodin Administrativ dhe Kodin civil. Ne sot kemi shumë akte ligjore që janë miratuar nga... të ndryshme, janë nga kultura juridike të ndryshme, nga rregullore dhe dokumente të caktuara dhe kanë shumë kolizione reciproke me Kodin Civil, po e zëmë me Kodin Administrativ do ta bënim një punë të madhe. Unë do t'i përmend vetëm shkarazi. Njihen katër kodifikime të mëdha në historinë e shtetit dhe të së drejtës. Janë i Hamorabit, i Likurgut, i Justinianit, i Napoleonit. Tash kemi infrastrukturë, kemi kushte dhe kemi nevojë imediate për këto dy dokumente dhe ne e kemi më lehtë për shkak se ne po e ndërtojmë një rend juridik të ri. Është shumë vështirë, më vështirë kur rendin juridik e amendon, e modifikon, ndërsa Kodin e ndërton nga fillimi ambicinicio është më lehtë. Pra, kemi modele, domethënë, nuk është kurrfarë problemi vetëm duhet punë.

Unë e përshëndes, ndër të tjera, inkorporimin e këtyre akteve ligjore për t'i miratuar për gjykata që kemi shumë, sidomos Ministria e Drejtësisë që nuk ka autorizime do të duhej të kishte autorizime edhe po e zëmë Këshilli Gjyqësor, që praktikisht është jashtë kontrollit të Kuvendit. Nuk është e vërtetë ajo se dikush angazhohet në ndarje të tri pushteteve. Nuk është ndarje mekanike dhe automatike, ajo është ndarje e kushtëzuar... domethënë edhe ndarje edhe reciprokisht të kontrolluara a Kuvendi nuk e kontrollon gjyqësorin, që është absurd i dorës së vet, e do të duhej të kishte, sikundër që veprojnë shtetet moderne, të kishte edhe ingerenca edhe prerogative të kontrollimit.

Ligji për Muzeun, Ligji për Institutin Albanologjik, ligji për Institutin Pedagogjik këto do t'i miratojmë dhe është bërë fort mirë që në kuadrin e akteve tjera që janë propozuar që janë edhe këto akte ligjore. Në parim ky është një dokument i mirë edhe do të ishim shumë më të lumtur sikur të kishim garanci se do t'i miratojmë dhe aq më tepër do t'i implementojmë, sepse është një konkluzion më tepër empirik se kemi shumë dispozita rreth akteve ligjore të cilat nuk përfillen dhe nuk implementohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Sa i përket planit të punës së Kuvendit për vitin 2009, unë do të përqendrohem më shumë në planin e punës së Komisionit Parlamentar. Plani i Punës së Komisionit Parlamentar për vitin 2009, ne e kemi bërë në bazë të legjislacionit të cilën e ka sjell Qeveria, mirëpo duke ditur se Komisioni Parlamentar ka edhe shumë agjenci të pavarura të cilat i raportojnë Komisionit Parlamentar, kisha për të cekur se duhet të shtohen edhe ato. Këto i kam parasysh gjatë planit të punës së Kuvendit që arsyet tjera, unë po flas në

emër të Komisionit këtu se do t'i kem raportim çdo herë ato në Zyre të Rregullatorit Bankar në raportim brenda Komisionit, për këtë arsye shoh këtu një mangësi që duhet të plotësohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Është mirë që e kemi një program pune para vetes dhe është mirë që diskutojmë për këtë. Kjo e lehtëson shumë punën tonë si deputetë e si Kuvend i Republikës së Kosovës.

Megjithatë mendoj se ky program pune do të duhej të kishte ardhur më herët, jo tre muaj pas fillimit të këtij viti kalendarik, por 3 muaj para fillimi, do të thotë diku në tre muajt e fundit të vitit të kaluar, në mënyrë që drejt ta planifikojmë më mirë punën tonë. Tash me këtë program pune ne 3 muaj i kemi kaluar dhe puna jonë nuk është në përputhje me këtë program. Shumë projektligje që figurojnë këtu që do të duhej të ishin shqyrtuar në shkurt ose në mars, nuk janë shqyrtuar dhe nuk janë hequr nga muajt në muajt tjetër të këtij viti, kështu që ne duhet të shohim se çka duhet bërë me këto projektligje që nuk janë shqyrtuar gjatë muajve të kaluar dhe nuk kanë hyrë në muaj tjerë të vitit, a do t'i lejmë për vitin 2010 apo si do të veprohet me ta?

Përveç kësaj dëshiroj të lidhem pak me vërejtjet e Kryetarit të Kuvendit se i kemi lexuar apo si kemi lexuar, a janë shqyrtuar këto në mbledhjen e komisioneve. Këtu u theksua se, zoti Kryetar, materialet për seancat e Kuvendit u jepen me vonesë deputetëve, ju jepen të martën ose të mërkurën për seancën e të enjtes, që nuk na jep mundësi që t'i lexojmë dhe të përgatitemi për seancë. Mendoj se duhet të ndryshohet kjo praktikë dhe të veprohet në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Një çështje tjetër ose një vërejtje që mund t'i bëhet këtij programi është së shumë projektligje të njëjtit komision janë koncentruar brenda një ose dy muajve. Po e zëmë 9 projektligje që duhet t'i procedojë në Kuvend Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi janë në muajin korrik, që është e pamundur që Komisioni ta kryejë këtë punë në këtë formë. Mendoj se ka koncentrim të tilla dhe te komisionet tjera dhe duhet të ri programohen këto projektligje të shpërndahen në mënyrë proporcionale në muaj të ndryshëm të vitit, në mënyrë që komisionet ta kryejnë me sukses punën e tyre. Përndryshe, komisionet tona dihet që s'kanë kapacitete, as mbështetje të mjaftueshme profesionale dhe po thuaj se do ta kenë të pamundur ta kryejnë punën e tyre me sukses.

Këtu u përmend edhe nga kolegët tjerë Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve. Nuk është e saktë se është në rishqyrtim në Komision edhe pak bëhet një vit që Komisioni ia ka dorëzuar me rekomandime Kryesisë së Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit nuk e ka proceduar në Kuvend në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Tash këtu jepet një arsyetim se qenka dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave për çështjet buxhetore. Mendoj se ky projektligj e ka pasur me kohë deklaratën e implikimeve buxhetore, sepse një herë ka kaluar nëpër Kuvend dhe implikimet buxhetore janë zvogëluar, nuk janë rritur kështu që nuk është sot e arsyeshme që është edhe një herë. Më shumë e konsideroj si një formë për të mos e sjell në Kuvend, ose për ta zvarritur këtë projektligj dhe mendoj se nuk janë arsyet financiare, por, ndoshta, më tepër arsyet politike që ai nuk sillet në Kuvend.

U përmend këtu edhe çështja e Projektligjit për ish të burgosurit politikë. Po ashtu është e çuditshme që nuk sillet në Kuvend, pasi që i ka plotësuar të gjitha kushtet. Nuk ka implikime buxhetore si projektligj as si ligj dhe nuk ka pasur arsye të dërgohet në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave. Siç dihet janë të nevojshme vetëm 6 nënshkrime që të sillen- të procedohet në Kuvend, kurse ky projektligj i ka 66 dhe përsëri nuk sillet këtu. Nuk e dimë arsyen e vërtetë, është mirë nëse ka arsye politike të thuhet ato të mos ndodh që një burokraci e bllokoi procedimin e projektligjit kur 66 deputetë të Kuvendit e kërkojnë atë.

Duhet të dihet se ish të burgosurit politikë edhe sot, jo që s'kanë satisfaksion moral, por janë në një farë mënyre të injoruar, të diskriminuar dhe nuk kanë të drejtë të konkurrojnë në disa vende pune ku me ligj nuk u lejohej atyre që kanë qenë të dënuar ose të burgosur, që nuk është në rregull dhe mendoj se kjo duhet të ndryshohet si praktikë në Kosovë.

Zoti Kryetar, kjo është e saktë dhe mund të vërtetohet, ka raste, po e zëmë kur kanë konkurruar për prokurorë publikë dhe s'mund të jenë, sepse ligji ia ndalon që një i burgosuri i dënuar të jetë prokuror publik. Pra, nuk është diçka që po e trillojmë, por është diçka shumë më e rëndë që po ndodh në praktikën tonë dhe këta njerëz që kanë sakrifikuar për Kosovë, jo vetëm që s'kanë asnjë favor, por në një farë mënyre edhe janë të diskriminuar.

Një aspekt tjetër i këtij programi do të duhej të ishte që dinamikën e punës së Kuvendit po jo vetëm të Kuvendit, por edhe të Qeverisë do të duhej ta përcaktonte Kuvendi, jo Qeveria dinamikën e punës së Kuvendit. Nga strategjia legjislative e Qeverisë del se ne jemi përshtatur strategjisë së punës së Qeverisë. Do të duhej që Kuvendi ta përcaktonte edhe dinamikën e punës së Qeverisë dhe kjo dinamikë e punës së Qeverisë t'i përshtatej punës së Kuvendit dhe jo e kundërta siç po ndodh këtu.

Në fund mendoj se do të ishte mirë që ky program të rishikohej dhe t'i përshtatet periudhës kohore që ka mbetur në dispozicion. Pra, këtyre 9 muajve që i kemi në dispozicion, sepse kanë kaluar 3 muaj dhe ne nuk i kemi shqyrtuar disa projektligje që kanë hyrë në këtë program pune.

Mendoj se kjo do të ishte më e dobishme për Kuvendin dhe propozoj që ne edhe një herë ta rishikojmë dhe ta aprovojmë dhe ai të jetë i zbatueshëm për vitin që e kemi para nesh. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë po lexoj një paragraf hyrës në Programin e punës.

Programi i punës së Kuvendit për vitin 2009 do të pasurohet dhe plotësohet edhe me propozime të organeve të Kuvendit për zhvillimin e debateve nga të gjitha fushat, me propozime për interpelanca me kohë për pyetje dhe përgjigje parlamentare, në shqyrtimin e raportit të punës së Qeverisë, raportit për punën e organeve të themeluara nga Kuvendi, shqyrtimi i strategjive zhvillimore e të tjera. Pra, programi jep mundësi edhe për plotësime dhe riformulimeve për shtesa të ndryshme që do të ndodhin gjatë vitit 2009.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj. Sala Berisha – Shala, me kartelën e Safete Hadërgjonaj.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për të gjithë.

Nuk e pata në plan ta marrë fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo më nxitën disa diskutime të kolegëve të mi deputetë.

Por atë çka pata në plan ta them e përmendi edhe kryetari i Parlamentit, zoti Krasniqi, pra që t'ia përkujtoj po lexoj faqen 3, në faqen numër 2 të këtij programi se çka thuhet. Unë desha t'i përgjigjem edhe një parafolësi tim, s'po përmend me emër, për shkak të kursimit të minutave. Tha se në këtë program parashihihen tri monitorime të projektligjeve. Është shumë interesant se nuk e kanë lexuar mirë Rregulloren e Punës të Kuvendit apo edhe nuk kanë qenë aktiv gjatë miratimit të programit të punës nëpër komisione parlamentare. Ne, të gjithë deputetët jemi anëtarë diku nëpër komisione funksionale parlamentare, andaj para se të vijë ky program këtu në Kuvend, i cili është i bazuar edhe në programet e punës për vitin 2009 të komisioneve parlamentare, ne i kemi miratuar të programet nëpër komisione dhe është e paraparë që secili komision brenda një viti kalendarik, së paku, ta monitorojë ndonjë ligj. Domethënë, llogaritni sa komisione i ka Kuvendi, cili komision është i obliguar që ta monitorojë ligjin dhe bie ndesh me ata që e komentojnë që programi i punës së Kuvendit e ka paraparë në këtë monitorim vetëm tri projektligje.

Po, sigurisht edhe Komisioni për Ekonomi dhe Energjetikë, ku unë jam, ka paraparë që t'i monitorojë, së paku 2 ligje, por nuk janë cekur afatet kohore. Tjetër çka dua të them se u përmend këtu shpesh në replikë se në bazë të afateve kohore nuk i është dhënë, sipas kësaj ligjet që janë më prioritare. Ky program nuk domethënë se duhet të respektojmë strikt afatet kohore, por, varësisht nga agjenda edhe e komisioneve edhe nga volumi i punëve mund të ndërrohen ato afate të shqyrtimit të projektligjeve.

Tjetër, është me rëndësi të dihet, ta dinë ata deputetë të cilët nuk e kanë përpunuar mirë Rregulloren e Punës së Kuvendit mungesa e disa projektligjeve, ligjeve që janë në këtë program të punës nuk domethënë që të mos futen në shqyrtim nga ana e komisioneve, sepse Rregullorja e Punës së Kuvendit thotë se më tepër se 5 deputetë kanë të drejtë të iniciojnë edhe hartimin- draftimin e ligjeve të ndryshme të cilat i shohin që janë të nevojshme.

Kështu që nuk është kjo shumë shqetësuese, mirëpo unë më tepër këtë debat e marr si tendencë të paraqitjes të disa deputetëve për hir të opinionit- qytetarëve që edhe ata i manipulojnë pak a shumë se sa ajo çka është e vërtetë. Ju ftoj që ta miratoni këtë program i cili është i bazuar edhe në programet e punës së komisioneve parlamentare. Po e ritheksoj, po edhe në agjendën legjislative të Qeverisë të gjithë deputetë i kanë miratuar programet nëpër komisione, andaj është e pakuptueshme pse sot hezitojnë edhe paraqiten edhe grupe parlamentare thonë se ne jemi kundër këtij programi. Faleminderit!

KRYETARI: Gjylnaze Syla, një minutë - replikë.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

E para, zoti Kryetar, sipas rregullave unë kam të drejtë të replikoj meqë iu referua fjalimit tim. Unë e kam lexuar me shumë kujdes Programin e punës dhe në Programin e punës janë cekur tri raporte. Personalisht, në komision kam kërkuar që Komisioni për Shëndetësi të bëjë, së paku, monitorimin e dy ligjeve, një në sesionin pranveror dhe një në sesionin dimëror, ndërsa sa i përket kohës, natyrisht që përcaktimi i kohës është shumë i rëndësishëm se ajo tregon se a është i zbatueshëm ligji në praktikë dhe a duhet

ndryshuar. Kjo, natyrisht, rritë efektivitetin e vet Kuvendit të Kosovës. Nuk mund ta kryeni një punë nëse nuk e dini se si dhe kur do ta kryeni. Faleminderit.

KRYETARI: Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj që duhet të merren me qetësi gjërat dhe të shohim se çka mund të nxjerrim rreth kësaj që t'i zbatojmë.

Realisht disa nga gjërat që desha t'ia diskutoj këtu është që shumë nga parafolësit veç i thanë dhe unë për shkak të ekonomizimit të kohës nuk do t'i kthehesha të flas se sa është i rëndësishëm ky program i punës e kështu me radhë.

Ajo që mund të them është se programi i punës është i vonuar dhe arsytet janë të shumta në proces e sipër gjithkund nga pak ka ngecur puna dhe programi vjen me vonesë.

E dyta, programi i punës është i pasaktë në kuptimin e afatit kohor të realizimit ose të trajtimit, shqyrtimit të projektligjeve.

Do të ndalesha në këtë rast te Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media. Në faqen 30 kemi Projektligjin për shërbimin civil, në të cilën nuk parashihet fare as afati i dërgimit nga propozuesi as shqyrtimi i parë as shqyrtimi i dytë, domethënë nuk dihet orientimisht afati kohor i projektligjit. Njësoj kemi të bëjmë edhe me Projektligjin për pagat e nëpunësve civil, Projektligjin për referendumin lokal, që të gjithë janë... Komisioni për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale dhe Projektligji për qytetin e Prishtinës.

Do t'i bashkëngjitesha në këtë rast edhe fjalës së zotit Hydajet Hyseni për Projektligjin për ish të burgosurit politikë, sinqerisht është e pakuptueshme pse heshtet në këtë rast dhe nuk ka asnjë gjë të re rreth kësaj, zoti Kryetar. Së paku duhet të deklarohen pse nuk ka ndodhur që të vijë në këtë program të punës.

U fol se komisionet e kanë pasur paraprakisht dhe e kanë trajtuar këtë plan dhe unë them se e kemi trajtuar si Komision, por shqetësuese është se asgjë në këtë program të punës nuk është përfshirë nga rekomandimet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Si përfundim do të thosha se dyshoj shumë në realizimin e këtij programi të punës, sepse është shumë i stërngarkuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Programi pasurohet, shkruan në program.

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, me kartelën e Gani Kocit.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim sot na është ofruar një projekt, një program i punës për këtë vit dhe unë si deputet e përshëndes dhe mund t'ju them se është mjaft pretencioz. Uroj që Qeveria dhe Kuvendi të dalin faqebardhë me këtë punë, mirëpo ngre disa shqetësime për kapacitetet

edhe të Kuvendit edhe të Qeverisë që kjo strategji legislative të realizohet gjatë këtij viti. Pa dyshim, kur e them këtë, kam parasysh kushtet në të cilat punojnë deputetë e Kosovës këtu në Kuvendin e Kosovës dhe njëkohësisht gjendjen çfarë e kemi në zyrat ligjore nëpër ministri, gjykuar nga ato ligje që na kanë ardhur më herët.

Unë kisha apeluar që Qeveria vërtet të marrë masa për dinamizmin e punës të këtyre zyrave dhe njëkohësisht edhe Kryesia e Kuvendit ... të marrë masa për krijimin e kushteve më të mira të deputetëve që t'i hartojnë ligjet sa më të mira, jo vetëm në sasi, por edhe në cilësi. Kurse për mua një shqetësim paraqet fakti se të Ligji për sigurime shëndetësore, Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor, Ligji për ish të burgosurit politik, Ligji për Qeverinë nuk planifikohet fare një datë të caktuar dhe me siguri këto ligje, sipas traditës dhe praktikave tona, do të shtyhen për vitin e ardhshëm ose për një kohë më të mirë.

Unë e ngre si problem shumë serioz një strategji legislative e cila nuk bazohet në komponentët sociale ose një strategji të Qeverisë së Kosovës e cila e anashkalon në një farë mënyre komponentin social të programit të vetë qeverisës. Ligji për sigurime shëndetësore është më si i domosdoshëm. Nuk mund të kemi ne shërbime shëndetësore në Kosovë pa i rregulluar çështjet e sigurimeve shëndetësore, nuk kemi shërbime të mira falas kurrkund në botë nuk ka shërbime shëndetësore falas dhe ne duhet të sigurojmë sa më shpejt dhe ta aprovojmë Ligjin për sigurime shëndetësore.

E dyta, Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor duhet të aprovohet sa më shpejt. Ligji për Trustin Pensional të Kosovës duhet të vijë një ditë dhe të rregullojë statusin e këtij Trusti dhe paratë të cilat na i derdhim aty dhe për fatin e të cilave nuk kemi, as Qeveria as ai që derdhi paratë veta në atë Trust, nuk ka kurrfarë garancie që ato para do t'i kthehen ose do të kenë ndonjë leverdi prej tyre. Duhet të ndërrojë statusi i Trustit Pensional të Kosovës për një ligj të veçantë dhe ky status do të ndryshojë atëherë kur të aprovohet Ligji për sigurime pensionale dhe invalide të Kosovës.

Unë e përshëndes këtë projekt programin dhe ju lus që të miratohet, kurse për iniciativat... ma merr mendja se ka hapësira edhe me Rregulloren e Kuvendit për të gjithë ata deputetë, për të gjitha grupet parlamentare të cilët dëshirojnë të hartojnë ligje besoj se askush nuk i ndalon dhe ka mundësi që çdokush t'i realizojë ato pretendimet e veta ligjvënëse në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala e deputetes Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Unë i kam disa propozime lidhur me programin e punës së Kuvendit të vitit 2009, në faqen 16, pika 53, 54 dhe 55, Projektligji për deklaratimet dhe prejardhjen e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër korrupsionit, Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit. Propozoj që për shkak të rëndësisë që kanë këto tri projektligje, të njëjta të shqyrtohen të miratohen në pako në mënyrë të përshpejtuar, sepse muaji korrik për shqyrtimin e parë më duket është vonë.

Gjithashtu mendoj që në strategjinë legislative të Kuvendit dhe të Qeverisë duhet të futet edhe Projektligji për konfiskimin e pasurisë. Mendoj që pasuria e fituar, prejardhja e të

cilës nuk mund të arsyetohet, duhet të ketë bazë ligjore që e njëjta të konfiskohet. Shqyrtimi, miratimi sa më të shpejtë i këtij ligji është i rëndësishë së posaçme, sidomos duke marrë parasysh periudhën tranzitore nëpër të cilën kalon Kosova dhe institucionet e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjala është për deputetin Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Kolegë deputetë,

Me qenë se plani i veprimit të Kuvendit është aprovuar më 12 dhjetor, unë mendoj që të pasurojmë me disa vërejte këtë punë ose këtë program që i është sjell Kryesisë së Parlamentit.

Mendoj që me kjo vonesë nuk mund të arsyetohet për arsye se shumë punë të bëhen brenda një viti. Drejtuesit e Parlamentit kanë pasur kohë dhe mundësi që këtë program mendoj që në fund të janarit ta kishim në Parlament dhe ta kem aprovuar dhe të startojmë me kohë, mos të vonohemi, sepse s' mund ta kompensojmë ose ta programojmë aktivitetin apo agjendën që i takon punës së Parlamentit.

Mendoj që Kryesia e Parlamentit, krahasuar me vendet e tjera si nuk e kanë këtë Kryesi asnjë Parlament kaq shumë njerëz kaq shumë kuadër që nuk e arsyeton dhe nuk e justifikon. Mendoj që pas një përvoje edhe këtë viti- në fund të vitit duhet ta kryej për vitin tjetër me kohë.

Në këtë dokument që e ka afruar mungojnë pra, duhet të plotësohet edhe me disa çështje të tjera. Në radhë të parë me atë që u përmendën nga disa deputetë këtu, qoftë me një analizë mbi zbatimin e ligjeve që u tha nga kolegët më herët që mungon në këtë projekt, apo me projektligje të tjera siç u tha pak më herët se vonesat, aprovimi i Rregullores së Kuvendit po ashtu nuk do t'u ofrojë mundësi për një punë më të mirë të deputetëve në Parlament. Bashkë me këtë edhe për kushtet dhe mandatin që e kanë deputetët për të cilin kemi folur shumë herë e këtu nuk i është kushtuar kurrfarë rëndësie. Po të kishte ardhur ajo me kohë ne do të kishim pasur mundësi që ta debatojmë edhe të ndryshojmë këtë punë edhe këtë mundësi që duhet të krijohet për deputetët në Parlament. Apo siç u tha rasti tjetër lidhur me vërejtjet se përderisa është paraparë ndoshta Projektligji për Qeverinë që është në rregull, ajo që mungon që disa kohë për Projektligjin për deputetët, pra nuk jepen informata dhe nuk kthehet në ndryshim apo plotësim, në mënyrë që të dihet statusi dhe mandati i deputetit dhe ashtu qysh i kanë praktikuar vendet e tjera ne nuk kemi nevojë të zbulojmë kurrgjë, por duke u mbështetur me mundësitë buxhetore që i ka vendi me ato çka mund të planifikohen, duhet pra të standardizohet dhe në ligj të kodifikohet edhe mandati i deputetit, detyrimet dhe ato çka dalin pas pushimit të mandatit të tij.

Unë mendoj që në këto katër dokumente që është mbështetur ky program i punës duhet të ketë pasur vende edhe për temat dhe debatet që u tha edhe këtu, por unë mendoj që ato duhet të jenë të koordinuara me Qeverinë së paku të ndahen nëpër faza ... nëpër fazën e parë, tremujorin e parë, të dytin apo të tretin sipas prioritetëve dhe a do të kemi debate e orientuara çështjet ekonomike siç është privatizimi apo fondet e ndryshme apo çështje të energjetikës, investimet e mëdha, çështjen e sigurisë apo të rendit dhe ligjit në Kosovë. Pastaj në çështjet e integritetit, procesit dhe kushtet diplomatike të Kosovës, pastaj në

çështjet e ambientit apo shfrytëzimit të resurseve dhe ndërtimeve në Kosovë e kështu me radhë. Mendoj që kjo do ta kishte bërë punën më të mirë dhe do të kishte plotësuar aktivitetin e Parlamentit me tema e debate që realisht, janë disa procedura të cilat e pengojnë, e unë mendoj që kjo më mirë do të ishte bërë në një formë sikur këto të ishin paraparë në punën dhe aktivitetet apo në këtë program të punës së Parlamentit të Kosovës. Kjo vetëm do ta kthente seriozitetin në Parlament në këtë foltore që deputetët dhe Qeveria në koordinim së bashku pra për aktivitetin e caktuar me interes për vendin, jo të shtyhen lidhur me procedurat dhe realisht ato t'i vënë në agjendën e punës së tyre.

Mendoj që me këto plotësime do të ishte më mirë për këtë Parlament dhe për ne si deputetë që të na krijohet një mundësi dhe një hapësirë e cila nuk është shfrytëzuar deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Unë kërkoj falje para juve edhe para opinionit që duhet ta lexoj paragrafin e parë në faqen e tretë. Po them po kërkoj falje, por në një mënyrë po më imponohet. Bartës të zbatimit të këtij programi në radhë të parë janë komisionet parlamentare, të cilat për punën dhe aktivitetet e tyre i raportojnë në takimet e rregullta, Kryetarit të Kuvendit.

Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotërinj ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Integritet Evropian në bazë të planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e raportit të progresit të Komisionit Evropian duhet të raportojë çdo tre muaj në seancë plenare. Kështu është paraparë këtu në këtë program, është paraparë vetëm dy herë- një herë në korrik e një herë në dhjetor kur është veç vonë se raporti i progresit shpallet në muajin nëntor. Edhe me këtë mendoj që është keqkuptuar krejt qëllimi i këtij plani të veprimit për arsye se qëllimi i këtij është që ne të arrijmë një mendim pozitiv, që fizibiliteti për Kosovën të jetë pozitiv, ndërsa hapet një rrugë që Kosova të nënshkruajë marrëveshjen e stabilizim -asocimit. Edhe titulli i këtij plani të veprimit është i gabueshëm. Në program është dashur të jetë Plan i veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e raportit të Komisionit Evropian për Kosovë e jo plani i veprimit për partneritet evropian. Planin e veprimit për partneritet evropian e bën Qeveria edhe nëse keni në plan që Qeveria të raportojë në Kuvend, ajo është shumë mirë po këtu, po i referohet mandej ... Komisionit për Integritet Evropian. Ne nuk e raportojmë planin e veprimit për partneritet evropian. Kështu që pika 119 është shkruar gabimisht dhe kjo duhet të përmirësohet, përndryshe është në kontradiktë me vendimet e seancës plenare të 11 nëntorit kur është obliguar Komisioni për Integritet Evropian që ta hartojë një plan veprimi dhe të raportojë çdo tre muaj për përmbushjen e tij.

Gjithashtu edhe një vërejtje, e pashë që në këtë program nuk ish paraparë raportimi i agjencive të pavarura që duhet patjetër të përfshihet dhe të futet në program të punës së këtij Kuvendi, përndryshe këto agjenci do të bëjnë çka të donë. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj që Komisioni sa të përgatit raport me rekomandime Kuvendit do t'i debatojë, kështu që mendoj që nuk është ndonjë problem, përndryshe shihet, po ne nuk kem thënë që pasurohet programi në raportet e agjencive të pavarura që i raportojnë Kuvendit.

Fjalën e ka deputetja Njomza Emini, më kartelën e Shkumbin Demaliaj dhe deputeti i fundit për diskutim është Ismet Beqiri.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Unë në fakt nuk e kisha ndërmend të flas, por po them që nga disa deputetë nuk e lexojnë me rregull dhe nuk dinë se çka ka në program, unë mendoj që edhe me këto vërejtje dhe sugjerime ne pasurojmë këtë program që ka ardhur në Kuvend të Kosovës. Sa për fillim unë mendoj siç thanë edhe disa kolegë tjerë që është i vonuar programi dhe që në këto dokumente që është mbështetur, do të thotë, programi i punës së Kuvendit për vitin 2009, janë disa vërejtje që duhet të, sa i përket afateve kohore të projektligjeve, renditjen e tyre, duhet të shqyrtohen këtu, janë me vonesë.

Por edhe tjetra çka e gjithë do të thotë plan programi i punës, unë mund të them që duke ditur rëndësinë e Projektligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, nga këto të gjitha vërejtje që janë një e mirë është këtu është paraparë që të shqyrtohet në muajin prill ku kjo do të thotë që është e mirë e gjithë këtij programi që më në fund të diskutohet për Projektligjin e punësimit dhe pjesëmarrjen e rinisë që është më se i rëndësishme.

Nga shefi i grupit parlamentar u tha që nuk e përkrahim dhe nuk do të bëhet përsëritja apo vërejtjet që i thanë edhe kolegët, por, unë mendoj që ky program dhe në fund çka do të doja të pyesja është që në faqen e parë të programit të punës së Kuvendit për vitin 2009 thotë që është propozim nga Kryesia e Kuvendit, por unë do të doja të pyesja a është ky propozim nga Kryesia apo nga Qeveria e Republikës së Kosovës?

KRYETARI: Dokumenti qashtu është i Kryesisë. Kryesia, do të thotë, e ka prurë në Parlament, pas shqyrtimit në komisionet parlamentare. Nuk është mirë që të na shtohen diskutuesit. Unë thash diskutuesi i fundit është Ismet Beqiri.

Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministra,

Sigurisht që çdo material i ofruar edhe nëse ka të meta është më mirë se mos ta kemi fare. Është shumë e qartë që është një dokument i mirë në bazë të cilit mund të procedohet më tutje në hartimin që s'është në miratimin e këtyre projektligjeve.

Si do që të jetë, shumë shkurt më lejoni t'ju them vetëm 2 – 3 vërejtje dhe konkretisht 2 – 3 ligje, gjegjësisht projektligje që janë të parapara, ndoshta, nuk i është kushtuar një rëndësi e veçantë karshi asaj që janë të rëndësishme së veçantë për mendimin tim.

E para, Projektligji për të pagjeturit, e kemi thënë edhe me herët, zoti Kryetar, i kemi dhënë edhe me shkrim vërejtjet edhe sot po e them para kolegëve edhe opinionit është e një natyre dhe i një rëndësie jashtëzakonisht të madhe dhe ajo që e kemi kërkuar ka një vit për arsye që të bëhet në tetor të këtij viti dhe procedura, thënë realisht mund të themi që është rast debati nëse shkohet sipas dinamikës. A mendoni që ka mundësi edhe nga përvojat e vendeve fqinje ka mund të bëhet dhe mund të bëhet më shpejt ky projektligj. Ka qenë kërkesë imja me shkrim, e kam adresuar atje ku duhet dhe në Zyrën e Kryeministrit edhe në Ministrinë e Drejtësisë që të bëhet edhe më shpejt edhe me herët

dhe ka mundësi që të dyja, por edhe të dalë projektligj i mirë. E kuptoni rëndësinë, pse kjo do të duhej edhe pse ky ligj është shumë i nevojshëm.

Pastaj edhe Projektligji për Avokatin e Popullit, pavarësisht që ne s'po arrijmë që ta zgjedhim Avokatin e Popullit si institucion ekziston edhe ky është shumë i vonuar.

Po ashtu, Projektligji për Prishtinën, në bazë të informacioneve që i kemi ky projektligj është i gatshëm. Unë nuk di pse sot s'ka datë dhe as afat për miratimin e tij. Lëre që do të duhej të kishte datë dhe afat, por duhet t'ua rikujtoj edhe gjithë e dinë që është ligj që derivon dhe parashihet në Kushtetutë. Ligji për Prishtinën është ligj i cili jashtëzakonisht i duhet kryeqytetit, që të gjithë dëshirojnë dhe është e drejtë e çdo qytetari të Prishtinës të pretendojë edhe të jetojë në Prishtinë edhe të veprojë, por mendoj që e kemi borxh ndaj kryeqytetit që ta trajtojmë si kryeqytet ligjërisht, domethënë në aspektin financiar dhe ligjor dhe mos hartimi i këtij ligji gjer më tani mendoj që nuk do të duhej të gjenim arsytim, dhe as s'është i proceduar, domethënë Unë e kamë thanë edhe më herët edhe në raste të tjera kjo është dashur edhe shumë më herët të bëhet, por jo që s'është arritur, por së paku këtë vit të bëhet dhe të mos humbim kohë, sepse Prishtinës i duhet ky projektligj, në mënyrë që të përballlet më lehtë me sfidat me të cilat përballlet realisht...

Po ashtu, për të mos e zgjatur, unë ju kisha lutur që materialet kur të na vijnë duhet bërë..... mirëpo dikush... nëse projektligje tremujore të këtij viti për arsyen ato që s'janë proceduar, ne jemi në fund të muajit mars, pse na vijnë këto projektligje kur thuhet që është dashur në janar iks projektligji ose në shkurt. Pra, këto është dashur t'i heqim fare, më mirë të thuhet se njeri-tjetrin e shtyn. Këto që nuk janë realizuar në tremujorin e parë, domosdo do t'i shtynë të tjerat ... në prill – maj e tutje. Prandaj, ka mundësi të bëhen disa spastrime brenda, sepse teksti del jo adekuat në diçka që ne po e shqyrtojmë ajo s'herret, nëse flitet për janar për cilindo ligj që është paraparë dhe nuk është deri në mars, domethënë këto gjëra mund të përmirësohet dhe me një kujdes më të madh.

Thjesht edhe një herë apeloj që sa më shpejtë që është e mundur, veçmas po e përsëris këto tri ligje që i përmenda, për mendimin tim, janë të rëndësishë së veçantë. Pra, do të duhej të procedohen sa më shpejtë që është e mundur edhe para afatit që janë paraparë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sa i përket Projektligjit për të zhdukurit, mendoj që Komisioni mund ta formojë një nën komision që të merret me hartimin e projektligjit. Diskutuesja e fundit është deputetja Nurisha Hula.

NURISHA HULA: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Unë i vlerësova disa çështje të rëndësishme dhe kjo më shtyri që ta marrë fjalën dhe t'ia paraqes Kuvendit.

E para, është se një program i hartuar mirë, i strukturuar, por ka edhe gabime, ka edhe vende që duhet të përmirësohen.

Kisha për t'i cekur dy çështje të rëndësishme. Unë e vlerësova këtu se janë 8 projektligje në radhë: 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117 dhe 118 janë projektligje të paraqitura në

program, të cilat nuk kanë afate dhe nuk kanë data të caktuara se kur do të shqyrtohen, që do të thotë që mund të shqyrtohen, por dhe mund të mos shqyrtohen.

E dyta, është se në këtë program, ndoshta, është dashur të paraqitet implikimi financiar që do të thotë sa do të kushtojnë këto projektligje në shqyrtim dhe pastaj në zbatueshmëri. Do të thotë është dashur të paraqitet një vlerësim i financimit të këtyre projektligjeve. Dhe a janë përfshirë këto projektligje në kornizën afatmesme të Buxhetit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës?

Edhe një çështje tjetër, dy ligje të rëndësishme, gjegjësisht projektligje për qytetin e Prishtinës domethënë ky është shumë i rëndësishëm, siç e ceku edhe kolegu Beqiri, është një ligj shumë i rëndësishëmdhe do të kalojë ky projektligj dhe e dyta është Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor që është projektuar gjatë fushatës elektorale, gjegjësisht vetë Kryeministri ka premtuar që kjo do të realizohet dhe do të përkrahet. Megjithatë ka shumë kohë është lënë pa datë, pa afat dhe besoj që, ndoshta, do ta paguajmë më tepër që kjo do të jetë më përpara dhe të realizohet më përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, që çdo ligj e ka koston e vetë. Një sqarim po kërkoj nga zëvendëskryeministri zoti Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ne me vëmendje dëgjuam planin e punës dhe vërejtjet dhe sugjerimet që i dhatë ju. Ajo që dua të them është se Qeveria do t'i respektojë në tërësi planet e punës, por kërkon një mirëkuptim nga ju, dhe besoj në mirëkuptimin nga të gjithë për arsye objektive e jo për të tjera. Ju keni mund ta vëreni se në agjendën e procedimit të ligjeve në Kuvend mund të ketë zhvendosje të datave, por unë po premtoj se sikurse ka pasur zhvendosje në kuptimin e vonesës, do të ketë zhvendosje në kuptimin pozitiv për vendosjen e disa ligjeve para afatit të paraparë. Por jam i bindur që këtë agjendë legjislative në këtë strategji që e kemi propozuar ne dhe faleminderit për mirëkuptimin që ka propozuar edhe Kryesia në Kuvendin e Kosovës dhe do ta respektojmë bashkërisht. Unë ju them që plani i punës së Kuvendit do të jetë obligativ për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Të nderuar deputetë debat nuk ka. Ajo që mund të them është që administrata do t'i ketë parasysh vërejtjet që janë dhënë dhe ne në bashkëpunim edhe me administratën e Qeverisë, sigurisht që do të bëhet një rikomponim i programit të punës. Besoj që administrata duhet ta marrë parasysh kërkesën e deputetit Hydajet Hyseni që Ligji për ish të burgosurit politikë të hyjë në procedurë, të planifikohet për t'u futur në procedurën e miratimit në Kuvend.

Dhe e hedhim në votim propozimin e Hydajetit, për futjen në procedurën e miratimit të Ligjit për të burgosurit politikë. Ligji për Prishtinë është në procedurë, Ligji për deputetë mendoj se edhe ai do të vjen.....Ju lutem debati është kryer. Ligji për deputetët as s'po kërkon, se ai do të ishte në procedurë dhe Ligji për ish të burgosurit politikë do të hyjë në procedurë në këtë plan deri në vitin 2009.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash- Ligjin për të burgosurit politikë.

Konstatoj se më 36 vota “për”, 3 “kundër”, 3 abstenim, është miratuar.

Vazhdojmë Ligjin për deputetët që të hyjë në procedurë.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatitet dhe votojmë tash.

Konstatoj se më 57 vota “për” 4 vota “kundër”, 5 abstenime, miratohet kërkesa.

Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar, këndej ka edhe ashtu shumë zhurma përmbropa qysh po flasin secili me vetveten ose me tjetrin, megjithatë të bëhemi më racional. Me që ju zoti Kryetar edhe e filluat këtë formë të votimeve të preferencave ose të kërkesave të deputetëve, unë po nënvizoj që duhet t’i japim përparësi të domosdoshme Ligjit për Prishtinën, një se është obligativ- obligim kushtetues dhe dy, sepse unë besoj që do të mbahen zgjedhjet sivjet. Nëse ato zgjedhje duhet të mbahen, ky ligj duhet të kalojë me kohë dhe të kallëzohet koha. Pra, të votohet këtu nëse dom preferenca që ky ligj të kalojë me kohë që të kemi zgjedhje sipas Ligjit për kryeqytetin. Faleminderit! Ta hidhni në votim.

KRYETARI: Faleminderit! Jo nuk e kemi pse e hedhim në votim se Ligji për kryeqytetin as që është në program në punës, varet kur vjen prej Qeverisë, kështu ai do të miratohet sipas procedurës.... Urdhëro, zoti Kuçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit! Por te kjo çështje e Ligjit për Prishtinën ka nevojë të jap një sqarim. Dua të them se Qeveria e mirëpret edhe votimin që u bë edhe për Ligjin për ish të burgosurit politikë, po ashtu edhe për të drejtat e deputetëve. Ligji për Prishtinën është hartuar, besoj këtë e dinë të gjithë ata që kanë marrë pjesë, është draftuar ka qenë edhe në Zyrën e Kryeministrit, ka qenë edhe në zyrën e kryetarit të komunës dhe në Zyrën e Presidentit të Republikës dhe ka pasur nevojë për një harmonizim në kuptimin buxhetor. Dhe unë besoj që tash jemi të përcaktuar publikisht që do të mbahen zgjedhje jam i bindur që do të mbahen dhe këtu nuk ka asnjë dilemë për zgjedhjet lokale në këtë vit dhe Ligji për Prishtinën, unë jam i bindur që para pushimit të verës ky Kuvend do ta ketë edhe miratimin e ligjit.

KRYETARI: Ju lutem, pa program... i hidhem, votuam për ligjet që nuk janë në program. Prandaj, duhet të kemi mirëkuptim.

Vazhdojmë për ta votuar programin e punës të Kuvendit për vitin 2009 me pëlqimet e propozuara.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Pa kartelë kush është “për” 7 vota “për”, 2 “kundër”.

Konstatoj se më 54 vota “për”, 22 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet programi i punës së Kuvendit për vitin 2009 me ndryshime. Ju falënderoj! Pra, tani kemi pauzë për drekë. Në orën 15,00- vazhdon seanca.

Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij Projektligji.

Ftoj ministren e Energjisë dhe Minierave, zonjën Justina Shirokra Pula, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRIJA JUSTINA SHIROKA PULA: I nderuar, zoti Kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave po i paraqes për aprovim, në parim, Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorët të cilët i mbulon kjo Ministri.

Fuqizimi i këtij Projektligji është i një rëndësie të veçantë sepse do të mbështetet në zhvillimet e gjithëmbarshme ekonomike të vendit.

Ky projektligj përcakton procedurën e autorizimeve dhe atë të tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të reja të bartjes dhe të shpërndarjes së gazit, si dhe të linjave të reja direkte të energjisë elektrike.

Qëllimet themelore të këtij projektligji janë:

1) Themelimi i kornizës ligjore për procedurën e autorizimit dhe atë të tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të reja të bartjes dhe të shpërndarjes së gazit, si dhe të linjave të reja direkte të energjisë elektrike.

2) Themelimi i Komitetit tenderues të projektit të energjisë me mandat për të zbatuar dhe përmbyllur procedurën e tenderimit, ku Komiteti tenderues të projektit të energjisë do të ndërmarrë procedura të tenderimit në pajtim me kriteret objektive, transparente dhe...

Vlen të theksohet se anëtarët e këtij komiteti janë: Ministria e Energjisë dhe Minierave, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, pasi që secili prej tyre ka përgjegjësinë në zhvillimin e këtij sektori.

Nga kjo përbërje shihet qartazi që interesi kryesor është që të kemi një vendimmarrje të përgjithshme dhe efikase si mënyrë e vetme për thithje të investimeve të cilat në sektorin e energjisë deri më tani kanë munguar, si pasojë e mos rregullimit të duhur me ligjin ekzistues.

Ky amendament i ligjit është në frymë të njëjtë sikurse Ligji për ndërmarrjet publike dhe Ligji për partneritet publik primar, i cili ende nuk është aprovuar. Po ashtu, e njëjta formë e vendimmarrjes ekziston në të gjitha vendet e rajonit. Vlen të theksohet se ky amendament është në përputhje me direktivat e BE-së për energji 2003/54EZ, ku secili shtet anëtarë ka të drejtë të përcaktojë autoritetin kompetent për udhëheqjen e procedurës për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

Kjo vendimmarrje përmes Komitetit, e jo vetëm nga Rregullatori ofron siguri jo vetëm për investitorët potencialë, por edhe për Qeverinë, pasi që Qeveria do të jetë ajo e cila do të jetë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik.

KRYETARI: Prezentë janë 67 deputetë.

MINISTRIJA JUSTINA SHIROKA PULA: ... që Ministria e Energjisë dhe e Minierave është e përkushtuar për thithjen e investimeve të reja, e sidomos të hidrocentraleve të vogla. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ministria do të ketë bazë të mjaftueshme për vazhdim të mëtutjeshëm të punës dhe shumë shpejtë Kosova do të ketë investime të cilat do të garantojnë siguri të furnizimit me energji.

I nderuar, zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Përmbajtja normative e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Rregullatorit të Energjisë është e sistemuar në 8 nene, duke respektuar parimet themelore të metodologjisë legislative dhe të teknikës juridike për hartimin e ligjit.

Andaj, propozoj që ky Projektligj të miratohet, në parim, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe t'i jepet mundësia për analizim të mëtutjeshëm të tij pranë komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Radha është e kryetares së komisionit, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me gjithë respektin për shpjegimin të ministres për këtë projektligj, mirëpo brenda komisionit parlamentar nuk është shqyrtuar ky projektligj, kështu që do të mbetet të vendosin grupet parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Paraprakisht e kanë obligim, do të thotë, ekspertët. Atëherë, vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Safete Hadergjonaj, me kartelë të Safetes, Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje Kabinet qeveritar,

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po shqyrtojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Tanimë me avancimin e rrethanave politike dhe ekonomike të Kosovës, imponohet nevoja për ndryshim dhe plotësim të ligjeve në sfera të ndryshme. Në vazhden e kësaj, edhe ky Projektligj duhet të pësojë plotësime dhe ndryshime.

Nevoja për ndryshim dhe plotësim të këtij ligji bazohet, po ashtu, edhe në pengesat aktuale për tërheqjen e investimeve private. Këto ndryshime janë të nevojshme edhe për faktin se, në kohën e hartimit të miratimit të këtij ligji, do me thënë më 2004, nuk ka ekzistuar Ministria e Energjisë dhe e Minierave. Në atë kohë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka pasur autoritet ligjor për rregullimin e të gjitha çështjeve në sferën energjetike. Momentalisht, Zyra e Rregullatorit të Energjisë i plotëson ndërmarrjet për kryerjen e një mori aktiviteteve. Andaj, mendojmë se do të ishte konflikt interesi nëse i njëjti autoritet do të vendoste edhe për investitor potencial në këtë sektor.

Këtë e kanë treguar edhe zhvillimet e fundit se është shumë me rëndësi të dallohen autoritetet që caktojnë, ekzekutojnë politika investive zhvillimore dhe autoritetet rregullative. Me këto ndryshime dhe plotësime synohet krijimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, siç është e paraparë në Draftligjin themelimi i Komitetit Tenderues për projekte energjetike.

Këto ndryshime gjithashtu janë në përputhje të plotë me dispozita ligjore të legjislacionit të BE-së.

Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim në parim, kurse vërejtjet dhe sugjerimet tona të mëtejme do t'i japim në komisionin funksional. Faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra prezentë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe lidhur me këtë seancës i propozon, kërkojmë nga propozuesi që Ligji të tërhiqet nga procedura me arsyetim se në disa dispozita të propozuara në këtë projektligj, pra disa dispozita që janë propozuar në këtë projektligj nuk e kanë vendin në këtë ligj, por në ligjet të cilat janë në program edhe të hartuesit, edhe të propozuesit për muajin maj të këtij viti. Në Programin e punës së Kuvendit, që e miratuar më herët, janë paraparë dhe mendojmë që formimi i Komisionit Tenderues vendin e ka në njërin nga ligjet ose pjesërisht në të dy ligjet tjera të cilat si Grup Parlamentar propozojmë që të vinë në paketë dhe të shqyrtohen e të miratohen paralelisht.

Nuk jemi kundër materies, as kundër trupës së propozuar për Komitetin Tenderues për Energji, por jemi që kjo materie mendojmë që vendin dhe natyrshëm duhet të gjendet dhe të rregullohet në materien e njërit nga ligjet tjera, pra të Ligjit për energji ose të Ligjit për energjinë elektrike dhe paralelisht të miratohen të tri ligjet në paketë.

Pra, jemi që kjo materie të shkojë, por në ato ligje tjera, jo në këtë ligj, sepse esenca e kundërshtimit tonë qëndron në dilemën se formimi i një trupe tenderuese pranë

Rregullatorit të Energjisë mund ta vejë në shprehje autonominë ose pavarësinë e punës së Rregullatorit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i Grupit, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së konsideron se Ligji duhet t'i kthehet anës... Do t'i jap disa prej arsyeve pse ne e konsiderojmë që ky ligj nuk është kompatibil me ligjet tjera dhe rrezikon seriozisht Zyrën e Rregullatorit për Energji, si organ i pavarur, sepse me këtë po shkyçet ky institucion, ky organ nga një e drejtë ose kompetencë shumë me rëndësi, e që pastaj gjithsesi do të reflektonte edhe në rrezikun që të largohen investitorët e interesuar për të investuar në kapacitetet e reja.

Sikur që e thashë, ky ligj nuk është kompatibil me ligjet e tjera, duhet të harmonizohet. Po ashtu, në disa pjesë të tij është në kundërshtim me ligjet për partneritetin publiko-privat, prandaj sugjerimi ynë është që të kthehet prapa ky ligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shefi i Grupit, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën, Ethem Çeku, me kartelën e Ardian Gjinit.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mua më gëzon fakti që ministria është shumë aktive për të pasuruar spektrin ligjor edhe pse, të them të vërtetat, edhe në Komisionin Parlamentar e kemi diskutuar disa herë. A është koha që të gjitha ligjet sot t'i diskutojmë, kur ende ndoshta nuk kemi filluar një fazë të implementimit të ligjeve, e ne jemi duke u sjellë në një rreth të mbyllur se sa janë aprovuar, disa ligje menjëherë fillojmë procesin e ndryshimit të atyre ligjeve, e ndër ta e kemi edhe ligjin që ka të bëjë me rregullimin e njërës nga sferat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, siç është ai mbi Rregullatorin e Energjisë.

Në radhë të parë, dua të them edhe një herë se ky ligj është i vlefshëm me Ligjin për partneritetin publik dhe privat, i cili i takon atij sektori, siç është Ministria e Ekonomisë dhe e Financave përmes institucioneve të saj për të rregulluar investime në Kosovë, sepse e kemi një njësi atje që lidhet me partneritetin publik dhe privat.

Çështja e dytë, atë që e përmendën edhe kolegët më herët, është sepse janë, kemi futur në ndryshim strategjinë e energjisë, kemi futur në ndryshim ligjet bazike dhe tani po e ndryshojmë edhe një ligj tillë.

Mesazhet që kanë të bëjnë me investitorin, me investime në Kosovë në këtë kohë, për të ndryshuar gjithë këtë pako të ligjeve, janë mesazhet jo të mira që u bëhen investitorëve të jashtëm për investime në Kosovë.

Prandaj, supozoj që ... përkundër angazhimeve që është duke bërë, është konceptualisht e gabuar edhe Qeveria në këtë rast nuk i fut ndryshimet në pakon e ligjeve të cilat kanë të bëjnë me investimet në sektorin më të rëndësishëm mbi ta.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar nuk e mbështesim. Kërkoj që të rikthehet te sponzoruesi dhe të përshtatet, të mbetet dhe përshtatet në rrethana të cilat i Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së deputeti Berim Ramosaj, e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe ne si Grup Parlamentar i LDD-së nuk do të mbështesim këtë ligj. Këtë e arsyetojmë me disa fakte të natyrës së... midis këtij ligji që do të pësojë ndryshme dhe ligjeve të tjera, një.

Dhe, së dyti, në arsyeshmërinë e funksionimit të këtij komiteti tenderues në projektin energjetik. Duke marrë parasysh se një ligj e ka kuptimin e rregullimit të një çështje, atëherë kur e rritë efikasitetin e funksionimit, respektivisht në zbatim, në qoftë se e krahasojmë ligjin e kaluar dhe këtë ligj, ma merr mendja se efikasiteti vjen në qoftë se... një komitet tenderues të projektit energjetik, duke marrë parasysh atëherë se Qeveria, respektivisht Ministria përkatëse merret me politikat energjetike. Do me thënë, vetë kahet e zhvillimit, ndërsa atë çka ia kanë vesh, respektivisht mbështet këtij komiteti, janë të natyrës ekzekutive operacionale, që janë të natyrës së tenderimit, të udhëheqjes së procedurave të energjisë dhe gazit në kuptimin e ndërtimit të mjeteve potenciale të distribuimit dhe të formave të tjera që janë krejtësisht të natyrës operacionale.

Në qoftë se një trup në të njëjtën kohë ndërton politikat dhe të njëjtën kohë merret me problemet e operacioneve, që një gjë e tillë iu ka garantua përpara Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, atëherë kjo bien ndesh në kuptimin e asaj që ka konflikt interesash në kuptimin e zhvillimeve të ekonomisë së tregut. Në qoftë se ka ekzistuar edhe më përpara Zyra e projektit në kuadrin, qoftë që ka komunikuar me Zyrën e Rregullatorit, qoftë që ka komunikuar me Ministrinë e Energjetikës, atëherë krejt ato punë që sot po i amputohen këtij komiteti, ka mund t'i kryej në aspektin profesional Zyra e projekteve, se tek e fundit ajo është përgjegjëse për aspektet profesionale në aspektin e procedurave, të tenderimeve dhe të formave të tjera.

Andaj, ndërtimi i një komiteti tjetër, i cili, këtu sipas ndryshimit të ligjit thotë, themelohet nën autoritetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe funksionon vetëm kur nevojitet. Faktikisht, me këtë ka mundësi të dekurajohet komuniteti i biznesit privat duke marrë parasysh raportin, respektivisht mundësimi i influencimit të politikës në proceset normale ekonomike të realizimit të kompeticionit, respektivisht të konkurrencës.

Duke u mbështetur në këtë dhe në çështje të natyrës që kanë konsekuenca edhe buxhetore, që del edhe nga propozimi i Departamentit të Buxhetit, që nuk janë të vogla ato konsekuenca buxhetore, faktikisht del se ndërtimi i këtij komiteti që nuk është vetëm një vend i një ministrie, por i shumë ministrive, edhe një herë t'i japë shansin Qeverisë së Kosovës të influencojë në proceset ekzekutive të cilat kanë qenë të garantuara përpara me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Tek e fundit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka statusin e pavarur të një agjencie e cila duhet t'i rregullojë këto çështje.

Andaj, duke u mbështetur në këto argumente shtesë dhe në argumentet tjera... që i pata rreth konfliktit të këtij ligji me ligje tjera, qoftë të energjisë, qoftë të prokurimit të tjera, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë jemi që ta kthejmë në rishqyrtim edhe njëherë, respektivisht t'iu mundësohet akterëve përkatës që kanë interes për këtë çështje të diskutojnë dhe të nxjerrin një konkluzë, respektivisht një ndryshim i cili ka kuptim edhe ekonomik, jo vetëm politik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputetja Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit zoti kryetar:

Enerji Düzenleme Yasa Tasarısı çok güncel konuları kapsamaktadır. Bu Yasa Tasarısında Enerji projeleri Kurulu birkaç bakandan oluşmaktadır. Bunlardan, kendi alanında bütün bakanlarımız görevlerini yapacağına mutlaka inanmaktayız, şimdiye kadar konuşan diğer milletvekili arkadaşlarımız, zaten birçok konuyu vurguladı. Ancak enerji veren mineralleri doğadan alabilmek için kazınan kazıların doğanın güzelliğini bozduğunu da göz önünde bulundurulması gerekmektedir. Bu konuda da çevreyi koruma açısından ek bir maddenin eklenmesi gerekliliğine inanmaktayız. Bunun dışında Enerji Düzenleme Yasa Tasarısına eklenmesi gereken konuları, fonksiyonel komisyonlara sunacağız, bununla birlikte 7+ Parlamente Grubu olarak bu Yasa Tasarısını kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALILI: Dobar dan, gospodine predsjedniče!

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna Grupa SLS u načelu će podržati ovaj zakon. Naravno, svoj doprinos ćemo dati kroz rad u funkcionalnim komisijama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Vezira Emruš e ka kërkuar fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa, pozdravljam sve prisutne, kolege i Predsedništvo, Pred nama je izmena i dopuna Zakona o električnoj energiji i ovde možemo da kažemo da ova izmena praktično za nas nema logiku zato što opterećuje budžet za 98 -100 hiljada eura, stvara još jedan, da kažem, dvojni organ pored Kancelarije za regulatora energije, imamo ponovo formiranje odbora za tenderisanje. Pošto su u pitanju jako važni predmeti za kosovsko društvo, kao što je proizvodnja i prenos energije i gasa, smatram da ovakvi odbori samo će imati paralelni institucijalni oblik u kosovskom društvu, da neće biti funkcionalan i kao grupa predloge za dopunu i u daljem radu daćemo konstruktivno naša mišljenja za ... Hvala lepo!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e deputetëve. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sektori i energjisë ka një rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës, prandaj edhe rregullimi i këtij sektori është shumë i rëndësishëm dhe kjo duhet të sigurohet me ligjin përkatës.

Andaj, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë duhet të sigurojë zgjidhje për rregullimin e tregut të energjisë me qëllim të ngritjes së konkurrencës, ashtu që tregu i Kosovës të jetë joshës për investitorë dhe në këtë mënyrë të sigurohet edhe perspektiva ekonomike.

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji, kështu si e ka propozuar Qeveria nuk e arrin qëllimin e përmendur. Kjo për faktin se cenohet autoriteti i Autoritetit Rregullativ, meqenëse proceset e tenderimit dhe të autorizimit ndryshojnë, çka do të thotë se proceset e autorizimit i mbesin ende Zyrës së Rregullatorit, por proceset e tenderimit kalojnë ekskluzivisht në duar të Qeverisë, gjegjësisht Komitetit Tenderues të projektit të energjisë. Kjo do të thotë se një pjesë e përgjegjëse të Zyrës së Rregullatorit që ka të bëjë me procesin e tenderimit, me zbatimin e tij, por edhe me monitorimin e procesit të tenderimit i kalojnë Qeverisë, më saktë Komitetit Tenderues. Ky komitete përbëhet nga katër ministra dhe nga kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit. Ministrat janë: ministri i Ekonomisë dhe Financave, i Energjisë dhe Minierave, i Industrisë dhe Tregtisë dhe ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Një mekanizëm mbështetës që është paraparë për realizimin e këtij procesi dhe funksionimin e Komitetit Tenderues që funksion brenda Ministrisë së Energjisë, është Zyra e projekteve brenda Ministrisë së Energjisë.

Megjithatë, me buxhet nuk është paraparë shuma e shpenzimeve për këtë zyrë, që supozohet se mund të jetë diku prej 49.000 deri 98.000 euro dhe është paraparë që kjo të ndahet nga buxheti i Kosovës ose nga donacionet. Me qenë se nuk sigurohet ose nuk dihet se a do të ketë donacione, atëherë në rast se donacionet mungojnë, përsëri do të ngarkohet buxheti i Kosovës.

Po ashtu janë paraparë 4 të punësuar, e që në të vërtetë kjo nuk lejohet ose nuk është paraparë gjithashtu në buxhet.

Sa i përket harmonizimit me direktivat evropiane, duhet theksuar se direktivat evropiane përcaktojnë mandatin e autoritetit në sektorin e energjisë, ashtu që kërkohet që autoriteti të jetë i pavarur nga interesat e industrisë së energjisë dhe të sigurojë funksionimin efektiv pa diskriminim të tregut të energjisë.

Po ashtu, sipas direktivës së Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, mars 2004, përcaktohen kriteret që duhet të merren parasysh gjatë tenderimit, si çmimi më i ulët apo kualiteti, karakteristikat funksionale e të tjerë. Të gjitha këto nuk i kemi në ndryshimet e propozuara të ligjit.

Në fund, dëshiroj të theksoj edhe një gabim teknik, por që e shoh shumë të keq dhe të papërshtatshëm për ligjin. Në Memorandumin shpjegues, zonja ministre, thuhet po citoj: “Projektligji për Mjekësinë Ligjore është hartuar me Rregulloren e Punës së Qeverisë”. Ne po flasim për Rregullatorin e Qeverisë dhe jo për Mjekësinë Ligjore. Mbase mund të jetë përvjedhje teknike, por nuk duhet të përzihen ligjet. Për shkak të të gjitha argumenteve të cilat i dhashë, nuk mund të kalojë ky ligj dhe unë nuk e përkrahi derisa

nuk shoh politika të qarta të cilat do ta rregullojnë tregun e brendshëm të energjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tani nuk e di se kush e ka fjalën, Safete Hadergjonaj apo Sala. Mirë, Sala ka folur sot një herë. Mirë, merre fjalën, Sala Berisha Shala, me kartelën e Safete Hadergjonaj.

SALA BERISHA SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Tani po flas si deputete, megjithëse nuk e pata në plan, por po e shoh të nevojshme. Po ndërlihem me diskutimet e kolegëve të mi deputetë. U përmend se zhvishet shumë Zyra e Rregullatorit nga kompetencat. Unë po ju them këtu se Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk do me thënë të ketë kompetenca të pakufizuara, nën një. Nën dy, ky Projektligj, që të vijë ky Projektligj me pako të ligjeve tjera të energjisë, nuk është ndonjë arsytim i fortë që sot të hiqet prej procedimit ngase ne nuk kemi dhe nuk jemi aq komod në kohë që të luajmë e të bëjmë kesi lojërash, të vijë me pako, të vijë me pako, sot është e udhës që ta kalojmë në procedim, në lexim të parë.

Nën tre, Komisioni për Ekonomi, Tregti dhe Industri, e ka mundësinë që gjatë fazës së amendamentimit t'i heqë edhe dispozitat e veçanta që e konsiderojnë që janë më të nevojshme të jenë të përfshira nëpër ligje, që është një argument tjetër që ne mos ta heqim prej procedimit të mëtutjeshëm. Mua më shkon mendja se qëllimisht, ndoshta, nuk është shqyrtuar në komision parlamentar paraprakisht ky ligj, me qëllim që të vijë deri te kjo situatë, që kjo duhet të jetë një vërejtje për kryetarët e komisioneve, para së gjithash, dhe e kam një pyetje për zotin Çeku, sa ka qenë ministër Energjisë dhe i Minierave, në qoftë se nuk ka harruar, le të thërret kujtesën dhe të na tregojë këtu në Parlament se çfarë ndryshimesh pati kërkuar ai atëherë pikërisht për këtë ligj. Tjetër, sa i përket të punësuarve, që dikush po mundohet të paraqesë se ka implikime buxhetore, prapë po ua kujtoj kolegëve deputetë se ne kemi miratuar ligje të cilat konsideroj që vuajnë nga agjencionmani, të cilat kanë më tepër implikime buxhetore dhe kanë paraparë më tepër të punësuar nëpër ato agjencione. Është e drejtë e grupeve parlamentare që të shprehin mendimin e vet dhe gjithsesi këtu do të jenë, e kanë frymën politike, por jo të arsyeshmërisë dhe të racionalitetit në mënyrë që mos të humbim kohë dhe të shkojmë më tutje.

Është e drejtë e secilit deputetë, fundja, të deklarohej me votën e lirë. Unë jam prapë që ky ligj të mos hiqet nga rendi i ditës, të vazhdojmë më tutje dhe të gjitha ndryshimet t'i bëjmë gjatë fazës së amendamentimit në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë do të shkoj me rend, sepse i kemi tri replika. E para për replikë është lajmëruar deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, Kryetar!

Me gjithë respektin për Projektligjin, të cilin e ka sjellë ministrja sot në Parlament, i drejtohem deputetes suaj e cila është në komision parlamentar, është e njoftuar mjaftë mirë se gjatë gjithë kohës është potencuar se Ligji do të tërhiqet nga leximi, për këtë arsye komisioni nuk e ka shqyrtuar në seancën e vet. Kush i ka thënë, ju e dini më mirë se ju jeni deputetë të Qeverisë, jo unë deputete e Qeverisë, dhe mos të luhet me këto lojna se kryetarja gjëja nuk e ka qitur në komision parlamentar për ta shqyrtuar për

arsye se nuk ka dashur t'ia miratojë ministres ligjin, gjë që nuk është e vërtetë, ju thatë me një sinqeritet më të madh. Ndoshta këto janë lojërat e këtyre që mendojnë t'i bëjnë edhe t'ia hedhin kryetares. Kërkoj falje, nuk është në frymën time, e as në mendjen time që t'i bllokoj ligjet e ministres. Kërkoj falje shumë që kanë kesi mendimi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të gjithë jemi deputetë. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Me të vërtetë tash jemi në rrugë që të ndikohemi prej fjalëve të njëri-tjetrit, por vetëm po i them koleges, e cila tha që..., ose nuk e përkrahi, e kritikoi mendimin tim që ky agjencion, ky organ dëmtohet nëse i merren kompetencat. Po ju përkujtoj, në kreun e dytë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë thotë kështu: Zyra e Rregullatorit për Energji themelohet me kërkesë si një organ i pavarur, në bazë të nenit 12.2 të Kornizës Kushtetuese dhe, nëse i merren këto kompetenca, atëherë absolutisht nuk ka as pse të ekzistojë ky Rregullator dhe pse nuk po e bëni më mirë, po ia lëmë këtë kompetencë komplet Qeverisë dhe që të shkojë. Por, përderisa është organ i pavarur me ligj, natyrisht se nuk guxon që të ketë intervenime nga ana e Qeverisë, sepse atëherë nuk është organ i pavarur i Kuvendit. Do me thënë, kjo është... Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit për replikë!

Deputeti Hetem Çeku e ka fjalën!

ETHEM ÇEKU: Realisht, unë nuk dua të polemizoj, sepse kam respekt për deputeten, për opinionin e saj dhe konceptet e mia nuk janë politizuese. Në radhë të parë kur duhet të sjell para jush dhe para opinionit këtë gjë, sepse është diskutuar roli i Zyrës së Rregullatorit me zhvillimet e ardhshme, jo vetëm tash, por edhe më herët është diskutuar dhe kemi pasur shumë debate se si duhet të funksionojë Zyra e Rregullatorit si një institucion i pavarur dhe nga të gjitha debatet që janë bërë, edhe jo në debatet e brendshme, por edhe debatet nga institucionet ndërkombëtare kanë rezultuar se Zyra e Rregullatorit për momentin për Kosovën paraqet një aspekt të favorshëm për investitorin dhe për investimet në Kosovë. Prandaj, e kemi shtuar dhe e shtrojmë njëherë si hap, në koncept, a duhet në këto momente, kur priten investime, që të fillojmë të ndryshojmë strategjinë e energjisë, që të ndryshojmë ligjet e energjisë, që të ndryshojmë përmbajtjen dhe kompetencat e Zyrës së Rregullatorit. Prandaj, ne po e themi edhe njëherë që në këto drejtime duhet të shohim të gjitha zhvillimet e këtij koncepti se si ne do të marrim investime, kur Zyra e Rregullatorit është një nga mekanizmat që respektohet dhe që është me peshojë specifike tek investitori i jashtëm.

Prandaj, unë edhe më herët, edhe në Qeverinë e kaluar e kemi diskutuar se cili është roli i kësaj zyre dhe e kemi parë se ka peshë specifike. Në të kaluarën, kur UNMIK-u ka qeverisur, kjo zyrë ka pasur një ingerencë shumë më të madhe. Tani, ne nuk e mendojmë se kjo zyrë ka atë kompetencë çfarë e ka pasur në një periudhë të kaluar kohore. Prandaj, kërkojmë që Ministria ta analizojë në mënyrë të përpiktë, në qoftë se ne bëjmë ndryshime të kësaj zyre në aspektin ligjor se si do të reflektohen investimet e jashtme, se si do të... investitorët, sepse rregullimi ... përmes institucioneve që bëhet në sektorin e energjisë vjen nga Zyra e Rregullatorit e jo nga institucionet... Prandaj, ne kemi kërkuar që të rikthehet dhe të rishqyrtohet edhe një herë pa asnjë koncept tjetër që kemi në plan...

KRYETARI: Atëherë, fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ministër, Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se kur çështjet janë me peshë, që të mos konfrontohen deputetët mes veti, edhe kjo është arsyeja pse edhe dola këtu.

Dikujt mundet t'i duket që është një ndryshim i Projektligjit se nuk duhet të marrë shumë kohë, po mendoj dhe do të tentoj ta argumentoj që ndryshimi i këtij ligji, ky projektligj e ka peshën tepër të madhe, është me rëndësi që ne ta dimë se çka po bëjmë si Kuvend i Kosovës.

Nëse ky ligj kalon kështu si është, pika e parë e rëndësishme është se dëshmon që lufta kundër korrupsionit është retorikë dhe në Kosovë lufta kundër korrupsionit si e tillë është vetëm retorikë dhe asnjë gjë tjetër.

Nuk do të kisha marrë shumë kohë për t'ua dëshmuar këtë që po them, mirëpo mendoj se cilido deputet që është i ulur në këtë ulësë dhe e sheh se çka po ndryshojmë, e kupton minimumin e asaj çka po ndryshojmë, e kupton që ne jemi duke folur për korrupsionin vetëm me fjalë. E kam përmendur disa herë, i nderuar zoti Kryetar, këtu, në këtë foltore, para deputetëve të Kuvendit, që lufta kundër korrupsionit është strukturore, nuk luftohen njerëzit, nëse luftohet korrupsioni nuk luftohet thjeshtë Qeveria. Për t'ua luftuar korrupsioni, duhet të kuptohet se çka prodhojmë ne si legjislacion dhe po ju them që e keni një mostër. Mostra është ky ligj, i cili tregon se realisht asnjë njeri deri më tani nuk e ka pasur seriozisht kur ka folur për luftën kundër korrupsionit. Ky ligj i ... jo vetëm që i hapë dyert, po ka për të bërë të pamundshme të luftohet korrupsioni në të ardhmen.

Çështja tjetër është se ka të bëjë me demokracinë, me esencën e demokracisë. Demokracia nuk është vetëm në Kuvend, në Qeveri, në Presidencë edhe në legjislativ. Janë institucionet e pavarura, rregullatorët e pavarur, janë të domosdoshëm, janë absolutisht të domosdoshëm dhe me këtë ligj, realisht, sakatoset një institucion i pavarur, që është Rregullatori.

Funksioni i Rregullatorit, nëse ky ligj aprovetur kështu, ka për të qenë realisht vetëm simbolik, nuk ka për të ekzistuar, ka për t'ua mbytur një institucion i pavarur që funksionon në Kosovë që një kohë dhe i cili realisht duhet vetëm sa të fuqizohet në të ardhmen e jo të mbytet. Çështja e tretë është se, ne e dimë që një kohë të gjatë kemi punë me investitorë të huaj, kemi punë me njerëz të cilët vijnë në Kosovë dhe janë të interesuar që të investoj, investime serioze shumë afatgjata, në investime afatshkurtra. Përmes këtij ligji mbytet edhe vullneti i investitorëve. Unë po i them këto të gjitha para jush me përgjegjësi të plotë dhe e di se do të mbesin këtu. E di se cilido prej jush një ditë do t'i lexojë transkriptet, një ditë do ta sheh dhe e di se cilido që është ulur sot këtu, ka për ta marrë një përgjegjësi pas disa viteve dhe ka për ta parë peshën e vendimit të vet, peshën e votës së vet.

Tani do t'ua jap disa elemente shumë konkrete se çka ka në këtë Projektligj e që ka të bëjë me pjesën e fundit të shpjegimit që është realisht një torturë që i bëhet legjislacionit në Kosovë. Shikoni, shembull ta marrim nenin 1, fillimin, e keni pika 1 e

nenit 1, thotë kështu: “Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të reja bartëse dhe të shpërndarjes së gazit dhe të lidhjeve të reja direkte të energjisë elektrike, të vetë sistemeve të gypave direkte për tranzitin e gazit natyror të bazohen”. Çka vazhdon më tutje, nuk ka absolutisht të bëjë me pjesën e parë, kushdo që ka durim edhe guxim, ju lutem, lexojeni se çka thotë. Nëse dikush mundet këtu, në këtë kuvend të shpjegojë se çka do me thënë ky nen, unë do të isha shumë mirënjohës dhe ma merr mendja që krejt populli i Kosovës kishte për të qenë mirënjohës, të kuptohet të paktën çka po do të rregullojë, cila është tema, për çka po flet neni 1.

Një çështje tjetër, shkoni te neni 2, paragrafi 14, nënparagrafi 1, e keni një çështje shumë interesante që ka nevojë ta lexojë edhe njëherë secili prej jush, thotë kështu: Nëse këtë KTPE që po e dini çka është KTPE, përcakton që kryerja e suksesshme e procedurës së tenderimit kërkon edhe vazhdon më tutje, dhe këqyrni çka thotë: atëherë në bazë të krejt kësaj, Rregullatori do t’i aprovojë të gjitha ato për të cilat vendos Komiteti Tenderues. Kjo është, do të thotë, ajo për çka po flasim. Nëse ky Komitet Tenderues e merr një vendim, Rregullatori duhet t’i mëshojë vullë. Rregullatori, do të thotë, Komiteti duhet t’i mëshojë vullë, e realisht po e mbysim një institucion, nuk ka nevojë të ekzistojë më. Pse të ekzistojë ai institucion nëse duhet vetëm formalisht ta vërtetojë atë që e ka rregulluar komiteti.

Tani, fjala Komitet Tenderues, është shumë interesant. Shikoni, ne e dimë se në Kosovë ka komitete tenderuese, por janë këto joformale. Nuk e dimë ne, nuk shkruan kërkund që ekzistojnë, po ato ekzistojnë. Tani, çka po ndodhë? Dikush po do t’i formatizojë komitetet tenderuese. Unë mendoj se këto janë çështje të cilat janë tepër serioze për deputetë të Kuvendit të Kosovës. Ju duhet të mendoni mirë para se të votoni për komitetet tenderuese. E fundit, që do ta përmend në këtë rast, është edhe fjalori sportiv i cili përdoret në këtë projektligj. Çka është fjalori sportiv? Shikoni gjuhëtarë, që e keni në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, çka do me thënë fjala parash. Në këtë Projektligj përdoret fjala parash edhe thotë kur ka parash, kryetari i Komitetit tenderues që duhet me qenë eventualisht ministria e Energjisë dhe e Minierave, ka për ta pasur votën e kualifikuar, do me thënë është fjalor sportiv. E fundit për t’i përmbyllur, do t’ju them kështu: unë nuk besoj që ky projektligj është ide e ministres së Energjisë dhe Minierave për kapacitetin intelektual të së cilës kam absolutisht shumë konsideratë, me sinqeritetin më të madh po ju them, edhe nëse nuk është e tillë, le të dalë, le të na thotë. Por, nëse është e tillë, nëse ky projektligj është ide e ministres, unë kam për të qenë seriozisht, seriozisht, seriozisht i dëshpëruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk e mora fjalën me qëllim që ta mbroj shumë ligjin, sepse po shihet këtu nuk është duke u diskutuar pikërisht për ligjin, por është duke u diskutuar për qëndrime politike dhe për qëndrime politike është krejt në rregull, nëse ka qëndrim politik për ligjin, a duhet të kalojë projektligji në fjalë apo nuk duhet të kalojë. Por, duhet ta kemi të qartë që ekziston një ligj që është bazik dhe për shkak të mos efikasitetit, për shkak të problemeve që janë paraqitur, duhet gjithsesi ky ligj të plotësohet me këtë propozim që e ka dhe nuk po flasim tani për qëndrimin politik, dhe ta kuptojmë drejt, ajo që po diskutohet këtu sot, kjo do të ndikojë që të shtohet korrupsioni dhe këtë duhet ta keni të qartë dhe t’ia bëjmë të njohur opinionit.

Ne para disa javëve e kemi pasur një projektstrategji për korrupsion, për ta luftuar korrupsionin dhe pikërisht këta njerëz nuk e kanë votuar atë strategji. Korrupsioni nuk luftohet me fjalë, nuk kemi nevojë ... Ne e kemi pasur një dokument, të cilin nuk e kemi kaluar para disa javëve dhe askush nuk na garanton që kjo projekt-strategji nuk do të vijë edhe

Ne i kemi krijuar rrugët. Nëse ka korrupsion, i kemi krijuar rrugë për të vazhduar ky korrupsion, pikërisht nga ky Kuvend s'e kemi votuar. Edhe një çështje tjetër. Nuk e di si po e lexojmë Projektligjin. Ne secili lexojmë, nëse e marrim dhe e lexojmë Projektligjin dhe e kanalizojmë nga aspekte politike, secili mund të gjejë gjithçka. Projektligji i ka gjithsej 8 nene, 8 nene të qarta dhe, përveç qëndrimit politik, është mirë të dilet dhe të jepen sqarime për çka nuk bën neni përkatës, ku është në kundërshtim, cilat politika i prek, cili vizion politik nuk po e zbaton, ku është pengesa që dikush po e konsideron pengesë dhe mandej le të na bindë, nuk ka problem, edhe unë do të jem njëri nga deputetët që nuk do ta votojë, por nëse na bind, por jo me qëndrime politike dhe duke aluduar se ligji është bërë për një grup të caktuar, e në këtë rast po përjashtohet edhe sponzorizuesi që e ka prurë Ligjin. Prandaj, ju kisha lutur, këto 7 nene, nëse nuk dalim me qëndrime politike që dolën, mendoj që duhet të aprovohet, sepse është pengesë për t'u zbatuar në praktikë Ligji i parë që ekziston dhe e kisha lutur kryetarin e komisionit, që nuk qenka brenda, por ka qenë dashtë, sepse e kemi një letër obligative, ku ligjet jemi duke i shqyrtuar para se të vijnë në lexim të parë dhe të jeni të bindur, po që se komisioni e kishte prurë një dokumentacion, ku do të kërkonte që ky projektligj nuk duhet të aprovohet, e kishim respektuar, sepse është trupë profesionale e Kuvendit të Kosovës. Pavarësisht si është marrë vendimi me shumicë apo pakicë votash, por ne nuk patëm asnjë qëndrim të Komisionit, patëm fjalë individuale këtu, të një anëtarit të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj!

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Sot disa herë m'u thirr emri, por më në fund, po e marr fjalën edhe pse mendova që nuk do të shkojë debati deri në këtë pikë dhe të politizohet një çështje e tillë. Unë desha të them vetëm një gjë për hir të korrektësisë, meqenëse jam anëtare e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Energjetikë, Telekomunikacion, unë nuk e di prej kujt ka dëgjuar kryetarja e komisionit se ky ligj duhet të tërhiqet, apo se ky ligj ka për t'u tërhequr, apo ku ta di unë se çfarë fjalësh. Ne nuk diskutojmë në bazë të fjalëve të cilat i dëgjojmë në rrugë apo diku tjetër. Vendi për t'u diskutuar ligjet është komisioni. Ky projektligj nuk është shqyrtuar në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Energjetikë, Telekomunikacion. Pse nuk është shqyrtuar dhe pse nuk ka kaluar në komision, unë nuk e di, është pikëpyetje.

Nëse nisemi nga çështja tjetër se po bëhen ndryshime të strategjisë, ndryshime të ligjeve, ndryshime e ndryshime. Këto ndryshime duhet bërë. Ne kemi qenë në një periudhë tjetër të zhvillimit, kurse tani jemi në pozicione krejt tjera. Kosova është shtet i pavarur, është shtet dhe duhet të ndryshohet edhe strategjia, duhet të ndryshohen edhe ligjet. Prandaj, nuk është asgjë këtu për t'u debatuar apo për t'u zmadhuar gjërat të cilat nuk janë për t'u zmadhuar. Ndoshta opozita, që me pompozitet këtu po deklaron tash, ka vepruar me ide të tjerëve dhe me urdhra të tjerëve nuk do të thotë tash se gjithmonë kemi aluzione se të tjerët veprojnë me ide apo me qëndrime të të tjerëve...

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Ju lutem, mos u merreni me diskutime të tjerëve.

... po, po merrem, zoti Kryetar, se shumë u politizua kjo çështje. Nëse thuhet se ky ligj po i hap rrugë korrupsionit, unë them që ky ligj nuk i hap rrugë korrupsionit. Nëse janë hequr disa elemente të cilat më përpara kanë qenë në ligj dhe këta që po debatojnë kanë menduar që duhet të jenë prapë në ligj, atëherë kjo është diçka tjetër, sepse me këtë variant të ofruar zvogëlohen tendencat për korrupsion. Këta që sot po diskutojnë dikur kanë qenë mbrojtës të këtij Komiteti tenderues, unë nuk e kuptoj sot pse po e kundërshtojnë pikërisht këtë çështje. Ky komitet është rregulluar në bazë të propozimeve të reja që janë bërë, kurse Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk përjashtohet nga ky Komitet Tenderues, sepse kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është pjesë e këtij komiteti, prandaj mendoj që ligji duhet të miratohet, ashtu siç ka ardhur. Ne pak më parë diskutuam që po vonohemi me ligje e ku ta di unë, mundësitë janë për t'u bërë më i mirë ligji, dhe gjithë çka është e nevojshme për t'u plotësuar ligji, mund të plotësohet në komisionin funksional, prandaj nuk ka kurrgjë të keqe nëse ligji shkon dhe nëse komisioni angazhohet pak më tepër për të punuar dhe ndoshta të gjitha shqetësimet e deputetëve të futen dhe ligji të dalë i mirë dhe ashtu siç e kërkojnë rrethanat e reja. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca. Po i lus deputetët, i kanë 7 – 8 nene dhe le të merren me nene të ligjit dhe jo me diskutimet e tjerëve.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Mos u nevrikos, se nuk ta nguci opozitën hiq, mos u tut...

Dëgjoni, ju përshëndes të gjithëve. Unë nuk jam ithtarë i asaj që ligjet mos të ndryshohen edhe sidomos ligjet që i kemi aprovuar në periudhën e kaluar, që i kemi aprovuar në rrethana krejt tjera politike. Mirëpo, mos harroni se ... ku synojmë ne të shkojmë, ... në integritet evropiane, duhet t'i aprovojmë 11 mijë ligje, ky parlament duhet t'i aprovojë 11 mijë ligje për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

Edhe tash desha t'ju them se unë e shtroj dilemën kështu, se duhet ndryshuar ligjet, duhet, se duhet kufizuar disa kompetenca të agjencioneve të pavarura, duhet, se janë mbi, nuk mund të ketë një agjencion të pavarur më shumë kompetenca se një ministri. Se ne që i kemi bërë institucionet e pavarura, jo vetëm për agjencione për të cilat folëm, por të gjitha që kanë shumë më shumë kompetenca ekzekutive dhe të marrin vendime strategjike për Kosovën më shumë se një ministri ose se Qeveria vetë, dhe shtrohet pyetja, çfarë ekspertize ka në këto agjencione për të marrë këso vendimesh të cilat kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve të Kosovës.

Ju lutem, rrugën korrupsionit nuk ia hap ky ligj, se rrugën korrupsionit në Kosovë ia kanë hapur dikush tjetër pra se të vijë ky ligj këtu. Dhe jo se ka hapur rrugë, por ia ka bërë edhe autostradë dhe pikërisht ata që ia kanë hapur rrugën korrupsionit më herët në Kosovë, nuk aprovonë strategjinë për ta luftuar korrupsionin në Kosovë. Këtu është thelbi i problemit dhe unë pajtohem dhe më vjen keq, zoti kryetar, që po ta ngacmoj pak opozitën, mirëpo po më vjen keq pse individë të caktuar këtu e politizojnë këtë çështje kaq shumë. Unë kam dilema për përmbajtjen e ligjit. Ligji nuk është shumë i qartë, por ma merr mendja se ky ligj mund të saktësohet, mund të rregullohet në leximin e dytë dhe mendoj se ligji duhet të aprovohet. Nuk po i merr këto kompetenca Qeveria, se kjo Qeveri nuk ka për të qenë e përjetshme në Kosovë, kanë për të ardhur edhe qeveri tjera, mirëpo për këso lloj vendimesh ma merr mendja se nuk mund të marrë Rregullatori i

Energjisë Elektrike, nuk mund të marrë vendime kaq të rëndësishme pasi janë një ekspertizë më e madhe. Këtu, siç po e shoh, janë përfshirë disa ministra, të cilët megjithatë kanë përgjegjësi më të madhe edhe politike, por edhe e kanë një përgjegjësi edhe më të madhe profesionale. Kështu që unë e përkrah në parim, por kjo nuk do të thotë që edhe vërejtjet e të gjithë këtyre kolegëve, nga të dy krahët e mi, mos të merren parasysh gjatë procedimit deri te leximi i dytë i këtij ligji. Kështu, ju kisha lutur të votojmë dhe të ecim përpara ...

KRYETARI: Ju faleminderit, e ke kursyer opozitën!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi. Më fal Fatmir, replikë Ardian Gjini. Një minutë.

ARDIAN GJINI: Krejt çka dua të them është kështu: Duhet mos me ditë ama kurrigjë hiq, duhet mos me e pas as idenë se ku është ulur dikush kur e përdorë fjalën “mos politizoni në Parlament”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjala e ka deputeti Fatmir Rexhepi. Regjia, fjalën ia jepni deputetit Fatmir Rexhepi!

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë i bashkëngjitëm këtij debati nga arsyeja se arsyetimi që u dha për projektligjin, së paku për mua si deputet m'u duk pak jo bindës, jo i mjaftueshëm për qëllimin e këtij projektligji, prandaj lidhur me propozimet rreth ndryshimit të këtij projektligji për energjinë, ani pse projektligji ka 8 nene, i shkurtër, shumë i vogël, por për kah rëndësia është tepër i madh. Pra, drejtpërdrejt kjo tangon shumë çështje që kanë të bëjnë me çështjet ekonomike, me çështjet juridike ose me legjislacionin në fuqi, me transparencën dhe ligjet tjera që, po ashtu, i kemi nxjerrë më herët në Parlament, por edhe me investimet e besimin që duhet ndërtuar lidhur me atë çka e presim ne, që nesër të investohet në këtë sektor të energjetikës. Prandaj, unë po e lexoj këtë çka shkruan këtu, në këto 8 nene, se nuk është shpjeguar mirë qëllimi i këtij projektligji. Përmbajtja e Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë është i përbërë gjithsej prej 8 neneve, që trajton çështje si në vijim:

Procedura e autorizimit dhe e tenderimit, procedura e tenderimit, shpallja, shpërndarja dhe kërkesa e përgjithshme për tender, shqyrtimi i ofertave tenderuese, shqyrtimi për rishpallje të tenderit e deri te licenca, pra, për hyrje në fuqi.

Çka nënkupton kjo? Tash unë isha i mangët, mbeta i mangët nga sqarimi i ministres. Unë kujtoj që qëllimi i këtij është, pra, thjeshtë vetëm të bëhet themelimi, dhe deri të bëhet themelimi i një komiteti pra për tender, lidhur me krejt këto pasuri në këtë sektor që ka rëndësi të veçantë dhe jo të qëllimet e tjera që u thanë këtu dhe, unë po e them, pse, pse bash ndodhë kjo në këtë kohë dhe pse duhet të jenë ministrat.

Në këtë komitet tenderues për këto projekte kaq të mëdha të Kosovës. Unë e shtroj dilemën time si deputetë. A thua, a kanë punë tjetër ministrat, pos të hyjnë edhe në këtë valle të madhe. Cilido qoftë ai ministër, nuk paska punë ministri i Financave, apo ministri i Ambientit, apo ministri tjetër, pos të merret edhe me tenderët për pasuritë nacionale që kanë bëjnë me fushën e energjetikës. Kjo është dilema ime si deputet. Nëse në kuadër të projektit ekzistues ose të ligjit ekzistues, e kemi Ligjin për energji ose Rregullatori i Energjisë, ne dje kemi përcaktuar se kush duhet të jetë ai komitet. Nëse duhet të ndryshohet diçka, ka efektin e saj ndoshta, por bash që duhet të jenë ministrat,

kjo është dilema ime më e madhe dhe nuk pajtohem me te. Ose, pse këta ministra, ky numër i këtillë të shkojë t'ia marrë të drejtën atij që ka të bëjë me prokurimin, i cili është i licencuar të përgatitë për cilindo nivel të atij projekti, për cilindo natyrë të projektit që ekziston, apo t'ia marrë kompetencat Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, apo t'ia marrë kompetencat, që shkruan në Projektligj në nenin 7 apo 6 atje, t'ia marrë edhe Komisionit për Miniera dhe Minerale në qoftë se duhet, e në krye të saj të vendosen, pra, ministria e energjetikës dhe ministri, në këtë rasti, dhe t'i marrë të gjitha këto kompetenca që nuk janë detyra të ministrave.

Pra, këto janë dilema të mëdha tek unë si deputet, kanë punë të tjera ministrat. Në qoftë se ministri i energjetikës e ka politikën, sektorin, zhvillimin, menaxhimin dhe shumë çështje të tjera, unë mendoj se nuk i ka mbetur puna të hyjë këtu. Prandaj, për të plotësuar atë çka e thashë..., unë do të kërkoj nga ministrja, që gjendet këtu, sqarime plotësuese dhe opinionin e saj lidhur me ndryshimin, ndryshimet e ofruara këtu të këtij projektligji, se sa ato bien ndesh dhe sa ato nuk pajtohen, absolutisht a po ndërhyjnë në Ligjin e prokurimit, në Ligjin për investime të huaja, në Ligjin për koncesionet, në Ligjin për minierat dhe mineralet. Dhe, krejt në fund, le të na tregojë, unë e kisha lutur ministren, pa keqkuptime, a ka ndonjë praktikë të tillë në ndonjë vend tjetër që ndërtohen këto relacione, pra praktika ligjore të ndërtohen këto relacione: Qeveri, tender, transparencë dhe investime të huaja. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! E kemi edhe një deputet që është për diskutim dhe, nëse ju pastaj i harxhoni diskutimet, fjalën do të jetë e ministres. Por, tani për fjalë është lajmëruar deputeti Emrush Xhemajli dhe tash së voni Driton Tali. Të tjerë nuk kam të lajmëruar për fjalë.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Unë jam që ligji, ky projektligj të tërhiqet për shkak se ne jemi deklaruar se jemi për forcimin e institucioneve të pavarura, siç janë agjencionet, jemi deklaruar se jemi për ndarje pushtetesh, dihet cilat janë ato, kështu që unë e kuptoj Ministrinë, e ka bërë propozimin, mirëpo është Kuvendi që duhet t'i ndalojë këto praktika. Është mirë që përveç këtij Agjencioni të Rregullatorit të Energjisë, të forcohen edhe agjencionet e tjera. Ka pasur kërkesa për forcimin e këtij Agjencioni Antikorrupsion, ne e dimë, dhe buxhetin nuk ia kemi shtuar, kështu që ju kisha lutur që në këto drejtime të punohet më korrekt. Nuk është tash vetëm t'i bëjmë votat dhe ta dëmtojmë vetveten, ajo nuk është zgjidhje. Unë, besoj se Et'hemi nuk do ta marrë fjalën, unë i besoj Et'hemit, ai e ka ditur ku ka dashtë të dalë kur e ka propozuar përafërsisht të njëjtën gjë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Jo, jo, veç edhe Driton Tali e ka fjalën. Krejt lajmërohuni, nuk e keni më fjalën. Ministrja e ka fjalën. E kemi kryer. Diskutuesi i fundit është deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti ministër, më falni zoti Kryetar! Shumë shkurt, se duke e lexuar këtë projektligj, i cili është stërngarkuar me fjalën "ministër - ministra" u ngatërrova, pa ndonjë qëllim të keq. Sidoqoftë, ajo që më ra në sy në këtë projektligj, është se secili nen fillon me fjalët tender. Duke e lexuar këtë projektligj, më ra ndërmend ajo që kjo qeveri me plotë gojë e thotë, të paktën ministri i Ekonomisë dhe Financave, se qeveria aktuale nuk është etatiste.

Ky projektligj pikërisht e bën këtë qeveri etatiste, do me thënë edhe tenderët i merr në kontrollim të drejtpërdrejtë. Pra nga mënyra indirekte e kontrollit që ushtron qeveria deri më tani, me këtë projektligj qeveria e merr edhe në mënyrë direkte kontrollin mbi tenderët. Andaj unë nuk e përkrahi në parim këtë projektligj.. Ju faleminderit!

KRYETARI: Radha është e ministres që ta arsyetojë edhe një herë Projektligjin.

JUSTINA PULA-SHIROKA: Të nderuar deputetë,
Kjo çështje apo më mirë të them ky ligj ka më shumë kahe politike se sa një arsyetim. Unë kërkoja që ky ligj të aprovohet, në parim, dhe ndërkohë të gjitha këto sugjerime tuaja mund të inkorporohen në kuadër të ligjit kur kalon apo kur arrin deri te komisioni të cilit i përket kjo çështje.

Një gjë tjetër. Ishin tema të ndryshme, do të ketë korrupsion, do të merret pavarësia e Zyrës së Rregullatorit dhe shumë e shumë çështje të tjera, për të cilat nuk është e vërtetë. Pavarësia Zyrës së Rregullatorit nuk i merret kurrësesi.

Një gjë duhet vetëm ta cek, apo ta theksoj, se me direktivat e BE-së për energji 2003/54EC, parashikohet që secili shtet anëtar ka të drejtë të përcaktojë autoritetin kompetent për udhëheqjen e procedurës për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Kjo është një.

E dyta, u përmend se kjo është në kundërshtim me Ligjin për partneritet publik privat. Ligji mbi partneritetin publik privat parasheh themelimin e komisionit ndërministror. Amendamenti i Ligjit për Rregullatorin apo ndryshimet e energjisë, parasheh themelimin e komisionit ndërministror dhe kemi shkuar edhe më larg ku si pjesë të këtij komiteti apo komisioni është edhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Domethënë, automatikisht nuk jemi duke e eliminuar, por jemi duke e bërë pjesë të këtij komiteti. Ndërsa, Ligji për partneritet publik privat nuk e parasheh Rregullatorin fare. Investimet në energji kërkojnë procedura të veçanta dhe BE-ja parasheh ligje dhe procedura të veçanta në sektorin e energjisë. Sektori i energjisë nuk është si sektorët tjerë, apo më mirë të themi sikurse privatizimi i ndonjë kompanie ku ka të bëjë me ligje e rregulla të cilat duhet t'i plotësojë në kuadër të Komitetit të Energjisë.

Unë mendoj se do t'i kemi parasysh të gjitha këto propozime të cilat i keni dhënë dhe nëse ky ligj aprovohet në parim, sigurisht se do t'i inkorporojmë në këtë ligj. Por, ju jeni deputetë dhe e juaja është të vendosni.

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 26 vota “për”, 40 “kundër”, 2 abstenime, nuk miratohet në parim Projektligji.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

Pika e pestë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara.

A do kryetari i komisionit funksional të thotë diçka lidhur me këtë? Nuk dëshiron. Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Atëherë, të nderuar deputetë, fillojmë votimin.

Amendamenti 1.

Regjia, le të përgatitet për votim.

Votojmë tani:

A ka kush pa kartelë? Pesë.

Do të thotë, me 54 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

52 me kartelë dhe 6 pa kartelë - 58 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

52 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 58 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

56 vota me kartelë plus 6 pa kartelë – 62 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

53 vota me kartelë plus 6 pa kartelë – 59 vota “për”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

51 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 57 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Zoti Luzha e ka fjalën lidhur me amendamentin 7.

BERAT LUZHA: Zoti kryesues, te amendamenti 7, do të thotë ka qenë dashur të jetë edhe një amendament te neni 11 pika 1. Këtu është: “të gjitha impiantet ekzistuese duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji jo më larg se 31 dhjetor 2017” kurse në Komision jemi marrë vesh të jetë: “jo më larg se dhjetë vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.

KRYESUESI: Unë kërkoj sqarim shtesë nga kryetari i komisionit lidhur me këtë dhe pastaj ta qesim në votim. Fjalën e ka kryetari i komisionit, deputeti Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, kryesues!

Ka qenë pjesë e diskutimit edhe kjo çka tha kolegu Berat Luzha, por duke pasur konsideratë se Ministria e Energjetikës është nënshkruese e marrëveshjes për... në nivel rajonal, atëherë të gjitha impiantet ekzistuese duhet të harmonizohen me këtë ligj jo më larg se 1 janar 2017, prandaj është periudha dhjetëvjeçare dhe 1 janar 2017 duhet t'i plotësojë të gjitha konditat, standardet për të cilat është zotuar Qeveria e Republikës së Kosovës në marrëveshje ndërkombëtare. Prandaj, kjo është e qartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Do të thotë, kemi sipas propozimit të zotit Luzha. Atëherë, e nxjerrim në propozim variantin sipas Rregullores – variantin ekzistues dhe keni të drejtë të votoni kundër, pastaj e votojmë propozimin e deputetit Berat Luzha.

Unë e qes në votim këtë sipas propozimit që e kam në letër këtu, pastaj e votojmë dhe nëse nuk miratohet kështu, e votojmë propozimin e Komisionit.

(Ndërhyrje)

Zoti Zeneli ka një sqarim, në emër të komisionit.

LULZIM ZENELI: Vetëm dua të sqaroj atë që e ceku zoti Luzha.

Nuk është amendament i Komisionit, prandaj Komisioni nuk ka vërejtje në nenin 11 pika 1. Ka pasur amendament te neni 11 pika 2, ku është edhe propozuar amendamenti. Ndërsa, për pikën 1 për ne është okej dhe mbetet njëjtë ashtu qysh ka qenë, sepse ka qenë edhe propozim i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! E qesim në votim atëherë amendamentin 7 sipas propozimit të Komisionit. Jo, nuk ka diskutim! Deputetja Hetemi do të sqarojë, pra ka sqarim shtesë. Urdhëroni!

ELHEME HETEMI: Jo! Kësaj radhe po flas për të qenë më e qartë. Prej dy propozimeve, që unë mendoj se të dyja kanë qenë të komisionit, por në formë të amendamentuar ka ardhur propozimi kështu si ka ardhur nga komisioni, ndërsa propozimin që e qiti sot në seancë zoti Luzha e ka kuptimin e vet. Për t'u sqaruar me deputetë, në mënyrë që të kemi një ndërtim më të qartë rreth asaj se çka nënkupton kjo, unë do ta kisha sqaruar.

Propozimi për një afat dhjetëvjeçar për përmbushjen e kritereve për mbrojtjen e mjedisit ka qenë propozim edhe i OSBE-s në mënyrë që a do të mundet Kosova, sepse ka qenë dilema a do të mundet Kosova t'i përmbush këto kritere dhe nëse e qet me ligj që në një afat deri më 2017 i plotëson, do të lindnin dilemat. Atëherë, çfarë sanksione do të ketë për Kosovën nëse nuk i përmbush këto kritere.

Kështu që, Berati dhe unë po mendojmë që ky propozim të ... këtu, është që të jetë në një afat dhjetëvjeçar në mënyrë që të mos ta sanksionojmë me 2017-shin në mënyrë që të ketë një fleksibilitet për përmbushjen e kritereve - të standardeve mjedisore. Prandaj, ky ishte sqarimi dhe mendoj se është më konkret nga dy propozimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Luzha, a e keni kërkuar prapë fjalën? E ka fjalën zoti Luzha.

BERAT LUZHA: Sipas të gjitha gjasave, ka një ngatërresë në komision, nuk jemi marrë vesh sa duhet. Ky propozim që e thashë unë ka qenë propozim edhe i ministrit, edhe i një eksperti të USAID-it dhe jemi marrë vesh që të jetë ashtu. Mirëpo, tash nuk është kështu në...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Urdhëroni, zoti Maloku!

NAIM MALOKU: Zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,

Ne para veti kemi amendamentin numër 7 që e ka propozuar komisioni parlamentar, ndërsa këto që folën deputeti Luzha dhe zonja Hetemi, janë amendamente të cilat nuk i kanë propozuar në komision dhe tani nuk është koha e propozimeve të amendamenteve të reja. Pra, paragrafi 1 i këtij neni mbetet siç është në ligj dhe ju lusim ta qitni në votim amendamentin numër 7 të komisionit funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk mund t'ua marr fjalën deputetëve që paraqiten për sqarime në debat, për të diskutuar. E vë në votim amendamentin numër 7. Regjia, bëhemi gati për votim.

Votojmë tani:

52 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 58 “për”, 9 “kundër”, 8 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

56 vota me kartelë plus 6 pa kartelë – 62 “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

43 vota me kartelë plus 6 pa kartelë – 49 “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Të nderuar deputetë, tani votojmë tekstin e Ligjit në tërësi.

Votojmë tani:

61 vota “për” me kartelë. Pa kartelë kush është, le ta ngrit dorën. 3 pa kartelë. Pra, 64 vota “për” dhe 3 abstenime, “kundër” nuk ka.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 3 abstenime Kuvendi miratoi Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Rishqyrtimi i Ligjit për shpronësim

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës, të datës 30 korrik 2008 dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedim me ligjet e pa shpallura,

komisioni përgjegjës raportues e ka shqyrtuar tekstin e Ligjit për shpronësim dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Muzejene Selmani, që para deputetëve të prezantojë raportin.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit zoti kryesues!

Përshëndetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrat që kemi këtu dhe të gjithë deputetët që janë brenda kësaj seance.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në bazë të Rregullës 41 pika 2 dhe 37 pikë 2 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me vendimet e Kuvendit numër 03, 08, 59, 49, 84 të datës 30.07.2008 dhe Vendimit 054 me datë 03. 10. 2008, njëkohësisht me datën 23.02.2009 shqyrtoi dhe miratoi Draftligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe vendosi në Kuvend që t'i paraqesë këto rekomandime.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që janë prezentë t'i përkrahin këto rekomandime të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe të miratohet Ligji në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë amendamentet veç e veç.

Fillojmë me votimin e amendamentit 1.
Votojmë tani:

(Ndërhyrje)

Për cilin nen? Nuk e di a janë paraqitur për të diskutuar. Më falni, atëherë është bërë një lapsus, sepse ka të paraqitur për diskutim. Deputeti Çeku e ka fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, kryesues!

Kryetarja e përmendi qëndrimet e komisionit. Ne në komisionin funksional e kemi punuar një kohë këtë ligj dhe kemi marrë pjesë aktive në hartimin e këtij ligji, do të thotë ligjit të ri, sepse ndryshon shumëçka ndaj ligjit..., dhe mendoj se të gjithë deputetët dhe ne tani si opozitë e mbështesim këtë projektligj, sepse është rregullimi që ka të bëjë me konceptet e investimeve dhe me konceptin e zhvillimit ekonomik në mënyrë shumë më të mirë, sepse ligjet e kaluara të cilat janë bërë kanë ngritur një pjesë të punës në shumë fusha, posaçërisht në fushat e caktuara të energjisë dhe në fusha të tjera nuk i kemi pasur të rregulluara me ligjet e vjetra, kurse tani e kemi një ligj të ri dhe ne si Grup Parlamentar e mbështesim dhe propozojmë që të aprovohet si projektligj. Dhe, po ashtu, themi se Qeveria me vendosjen e prioriteteve për të hartuar këto projektligje do të ishte që ne si deputetë të vendosim për projektligjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik t'u japim një hapësirë shumë më të theksuar. Prandaj, ne parim ne mbështesim që të aprovohet një projektligj i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bahri Hyseni është paraqitur për fjalë.

BAHRI HYSENI: Faleminderit zoti kryesues!

Është një procedurë që e kemi për herë të parë, sepse Ligji ndryshon diku mbi 60 apo 70%. Do ta kemi rastin edhe për një ligj që e presim së shpejti në Kuvend për të drejtën sendore, nuk e kemi tabelën krahasuese, nuk kemi çka të ndalemi dhe unë kisha propozuar që komplet ta votojmë tekstin e projektligjit, sepse s'kemi krahasim, s'mund të bëjmë krahasim. Prandaj, meqë s'mund të bëjmë krahasim, nuk mund të bëjmë as amendamente. Prandaj, është mirë që, meqë kanë shkuar në këtë procedurë, të votojmë komplet. Se, përndryshe, nuk kemi çka të krahasojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur, të gjithë deputetëve, së pari të dëgjohemi ose, nëse doni, të marrim pauzë.

E dyta, ju kisha lutur që deputetët, të paktën edhe mysafirët tani prej sallës këndeje të mos flasin dhe mysafirët, i kisha lutur kur janë në sallë le të dëgjojnë dhe të mos bëjnë muhabet me njëri-tjetrin. Në asnjë vend, në asnjë parlament në botë nuk lejohet që në sallë mysafirët të bëjnë muhabet edhe me deputetë, edhe me njëri-tjetrin.

(Ndërhyrje)

Jo! Tjetër herë, i qes jashtë! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Qeveritarë dhe deputetë të respektuar!

Unë këtë dokument e kam lexuar me kujdes. Vlerësoj se ky dokument është shumë i rëndësishëm. Ndoshta ndokush e merr se nuk është i rëndësishëm, se prona është një institut juridik civil tepër relevant, e këtu është fjala për shpronësimin, për eksproprijimin. Dhe, kam vërejtur dhe kam analizuar, kam ardhur deri në konkluzione të padiskutueshme se ka shumë gabime juridike materiale.

Bie fjala, që toleron edhe pa u verifikua interesi i përgjithshëm shoqëror, të bëhet edhe pa planin urbanistik detal, të bëhet eksproprijimi. Dhe, pastaj, jep mundësi që hipoteka, servituti që janë jus in ire, alineja – e drejta pronësore me sendet e huaja, që nëse do të bëhej shpronësimi, ato do të humbeshin, që janë në kolizion me rregullat e përgjithshme, kështu, juridike civile dhe ndërkombëtarisht valide.

Te instituti i sendit ka shumë mangësi dhe ka kontraverza. Ose do të duhej të riformuloheshin në konformitet me institutin e përgjegjësisë objektive e subjektive ose të lireshin dhe të adresoheshin në Ligjin për detyrimet.

Me këtë dokument jepet hapësirë që kompensimi të bëhet sipas vlerës së tregut që do të ishte në rregull, por lë përjashtim edhe nën çmim. Do të thotë, të bëjë vlerësimin nën çmimin e tregut, në qoftë se vlerësohet se do të ishte interesi i përgjithshëm, e do të ishte dëmtim flagrant i interesit të pronarit. Domethënë, le që i merret prona ose i jepet baza juridike që të caktohet çmim nën çmimin e tregut. Domethënë, është fjala për disa vërejtje, që nuk ishte dashur ky dokument të kalojë kështu. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe njëherë deputetja Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Rasti i këtij ligji është shumë specifik, në rend të parë se ka ardhur dhe është ligj që nuk është nënshkruar nga PSSP-ja dhe dëshiroj që ky ligj të shkojë në votim komplet, kështu si është. Është rast specifik, ju lutem! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Rexhepi!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit zoti kryesues! Po tash po ndajmë mendime për disa gjëra që janë të rregulluara, kujtoj, me Rregulloren e Parlamentit. Komisioni e ka ofruar draftin me amendamente. Gjithsej janë 13 amendamente.

Nuk e di pse duhet ne të mos e respektojmë procedurën. Nuk e di pse? Krejt janë 13. Me votim të vendosen 13 amendamente dhe në fund të aprovohet projektligji si në tërësi, dhe e përfundojmë këtë rend dite. Unë kujtoj kështu duhet të shkohet dhe nuk kemi nevojë për procedura të tjera. Komisioni e ka përfunduar punën e vet.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhepi! Është paraqitur për fjalë zonja Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit zoti kryesues!

Meqë ligji nuk është shpallur nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar, kjo do të thotë se ligji kurrnjëherë nuk ka hy në fuqi dhe sikur të kishte qenë ai ligj që ndonjëherë të kishte hyrë në fuqi, atëherë do të bëhej fjalë për rishqyrtim. Tani kemi një ligj, duhet të kuptojmë se kemi një ligj plotësisht të ri, me këto amendamente që janë dhe duhet të shkohet me procedurë të rregullt, të votohen amendamentet një nga një e më pastaj ligji në tërësi. Sikur të kishte ardhur ligji çfarë ka qenë pa asnjë ndryshim, atëherë është çështje tjetër. Tani, në rrugë e sipër, ky ligj ka pësuar ndryshime që do të thotë është plotësuar dhe ndryshuar në ecje e sipër dhe tani duhet të votohen amendamentet e pastaj ligji në tërësi.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Çeku.

ETHEM ÇEKU: Unë, edhe një herë dua të ngrejë çështjen se sa i përket çështjes së shpronësimit, kush e ka të drejtën. Qeveria me vendim të veçantë shpall një hapësirë të caktuar zonë të interesit dhe me vlerësim të zonës së interesit pastaj fillojnë procedura tjetër. Të gjitha këto nuk mund të jenë... të veçanta, sepse ka të bëjë me atë që e tha deputeti Riza, sepse mund të bëjmë edhe forma të tjera të shpronësimit. Qeveria dhe komuna, në dy nivele, në bazë të planeve të përcaktuara mund të shpallin zonë me interes të veçantë dhe të fillojë procedura mbi shpronësimin. Do të thotë, leja për shpronësim është një leje e veçantë, e cila pastaj është e përcaktuar se si fillon faza e shpronësimit të një pjese të caktuar të një vendbanimi apo të një sipërfaqeje të caktuar pronësore.

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Hydajet Hyseni-Kaloshi!

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është një situatë vërtet krejt e pazakonshme dhe ka arsye të pazakonshme. Mënyra si është kontestuar ligji, pa dhënë pastaj edhe propozime adekuate, ka krijuar këtë gjendje dhe ne e kemi edhe për çështje tjera.

Mendoj që duhet të shikojmë cili mund të jetë eventualisht gabimi më i vogël, por pa gabime s'mund të dalim. Të miratojmë an-blok, siç po propozohet, një numër aq të madh ndryshimesh në ligj, mendoj se instalojmë një precedent të rrezikshëm.

Të shkojmë amendament për amendament, nuk e kemi edhe mundësinë për të bërë qarqe krahasuese dhe, mendoj, përsëri bëjmë gabim.

Konsideroj se zgjidhja mund të jetë një praktikë e re që këtë propozim me aq shumë ndryshime, është ndryshuar substancialisht teksti i përparshëm, ta konsiderojmë lexim të parë – shqyrtim të parë. Do të thotë, ta miratojmë në parim.

Komisionet të punojnë pastaj për amendamente dhe në këtë mënyrë, eventualisht, të organizohen edhe dëgjime publike, e tjera çka duhet dhe me procedurë të rregullt të bëjmë shqyrtimin e dytë më vonë. Ky është edhe propozimi im, zoti kryesues. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të gjithë deputetët e kanë përpara tekstin e ligjit. Në anën e majtë e kanë propozimin e mëhershëm dhe në anën e djathtë është propozimi i ri. Ne e kemi shkurtuar procedurën në saje të angazhimit që kanë bërë edhe komisionet dhe administrata, prandaj po i votojmë 13 amendamentet që i kemi me radhë dhe nëse ka pastaj ndokush që të kërkojë procedura tjera, mundësitë janë. Atëherë, vazhdojmë me votimin.

E votojmë amendamentin 1.

Regjia gati, votojmë tani:

54 vota me kartelë. A ka pa kartelë? 6 pa kartelë. Domethënë janë 60 vota “për”, 2 abstenime dhe miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

51 vota me kartelë, plus 6 pa kartelë – 57 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

49 vota me kartelë, 6 pa kartelë - bëjnë 55 vota “për”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

50 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 56 “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

51 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 57 “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

51 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 57 “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

49 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 55 “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

52 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 58 vota “për”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

46 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 52 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

53 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 59 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

55 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 61 vota “për”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

55 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 61 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti i fundit 13.

Votojmë tani:

57 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 63 vota “për”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Votojmë tani:

57 vota me kartelë, 6 pa kartelë – 63 vota “për”, 3 abstenime. Konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i vërejtjeve të Presidentit në Ligjin për tubimet publike

Ligji për tubimet publike është miratuar në seancën plenare, të mbajtur më

4 dhjetor 2008 dhe i është proceduar për shpallje Presidentit të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 84 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti e ka kthyer për rishqyrtim Ligjin për tubimet publike.

Komisioni funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri i ka shqyrtuar vërejtjet e Presidentit në Ligjin për tubimet publike dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Komisioni në fakt i ka miratuar vërejtjet e Presidentit.

Në bazë të nenit 80 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, numri i vlefshëm 61 vota “për”, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti dhe Ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e amendamentit të propozuar nga komisioni funksional të paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tani:

Amendamenti 1, dhe i vetmi.

(Ndërhyrje)

Po, unë nuk mund të bëj rregulla të reja personalisht as për hatër tëndin, as s'di të kujt.

(Ndërhyrje)

Për këtë nuk ka deklaram. Kështu kemi bërë edhe herën e parë.

Votojmë amendamentin 1, që është i vetmi amendament.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 47 vota “për” nuk miratohet amendamenti sipas rregullave të votimit.

Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së radhës të rendit të ditës:

- Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i LDK-së ka vendosur që anëtar i Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport, në vend të deputetes Fatmire Berisha, të emërohet deputeti Arsim Rexhepi. Faleminderit!

Me kaq, konstatohet se seanca e sotme përfundoi.

Mirë u pafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve